

# Dituri natyre 4

## Planifikimi vjetor dhe modele ditaresh

BOTIME



## BOTIME



Redaktor letrar: Arlon LIKO  
Paraqitja grafike: Lindita PRELA  
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, prill 2018

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

---

**Botime Pegi:** tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;  
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al  
**Shtypshkronja Pegi:** cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;  
**e-mail:** marketing@botimepegi.al  
**Shtypshkronja Pegi:** cel: +355/ 069 40 075 01;  
**e-mail:** shtypshkronjapegi@yahoo.com

---

**PLANIFIKIMI VJETOR**  
**FUSHA: SHKENCAT NATYRORE**  
**LËNDA: DITURI NATYRE**

TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT PËR KLASËN E KATËRT

Tematikat	Përmbajtja sipas tematikave	Orët mësimore për tematikë
	<p><b>Sistemet te kafshët</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbështetja dhe lëvizja</li> <li>- Kockat e skeletit</li> <li>- Muskujt</li> </ul> <p><b>Ilacet</b></p>	<b>10 orë</b>
<b>SISTEMET</b>	<p><b>Elektriciteti dhe magnetizmi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qarku elektrik</li> <li>- Elementët përbërës të qarkut të thjeshtë elektrik</li> <li>- Qarqet me shumë elementë</li> <li>- Elektriciteti dhe përdorimet e tij</li> <li>- Magnetet dhe polet magnetike</li> <li>- Vetitë magnetike të metaleve</li> </ul>	<b>18 orë</b>
<b>ENERGJIA</b>	<p><b>Tingulli</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Burimet e tingullit</li> <li>- Përhapja e tingullit</li> <li>- Karakteristikat e tingullit</li> </ul>	<b>17 orë</b>
<b>NDËRVEPRIMET</b>	<p><b>Qëniet e gjalla në mjediset e tyre</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshatjet në mjedis</li> <li>- Çelësat e përcaktimit</li> </ul> <p><b>Ndikimi i njeriut në mjedis</b></p>	<b>15 orë</b>
<b>DIVERSITETI</b>	<p><b>Gjendjet e lëndës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndët dhe vetitë e tyre</li> <li>- Përzierjet e lëndëve</li> <li>- Procesi i tretjes</li> </ul>	<b>5 orë</b>
<b>CIKLET</b>	<p><b>Ndryshimet e gjendjes së lëndëve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndryshimet e lëndëve gjatë ngrohjes dhe ftohjes</li> <li>- Proceset e shkrirjes, ngrirjes, avullimit dhe kondensimit</li> </ul>	<b>5 orë</b>
<b>Totali</b>		<b>70 orë</b>

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

### Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Nxënësi:

1. Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
2. Shkruan një tekst rreth një faqe (rreth 100 fjalë) për një temë të caktuar.
3. Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në një kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un.

### Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

1. Identifikon tiparet e përbashkëta dhe të veçanta të objekteve, qënieve të gjalla, dukurive ose ngjarjeve të dhëna në detyrë dhe i paraqet ato përmes njëres prej formave shprehëse.
2. Identifikon për një temë/ngjarje, çështjet kryesore të marra nga burime të ndryshme informacioni (tekstë mësimor, gazeta, internet, apo burime të tjera).
3. Paraqet argumente pro dhe kundër për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4. Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë në gjuhë, matematikë, shkenca natyrore dhe shoqërore, duke dhënë shembuj nga jeta e përditshme për situata të ngjashme.
5. Ndërton tekste, objekte dhe animacione sipas imagjinatës, duke përdorur udhëzimet dhe materialet e dhëna.
6. Përkrahuan nëpërmjet njëres prej formave shprehëse, dukurinë e caktuar duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
7. Paraqet dhe argumenton mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar në një kohëzgjatje prej 6-10 minutash.
8. Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave përkatëse si: përbërjes, vetive, shndërtimeve apo vendndodhjes në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimit të tyre.

## 6 Kompetenca e të nxënit

### Nxënësi

1. Parashtron pyetje që nxisin debat për temën, problemin e dhënë dhe u jep pergjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes.
2. Shfrytëzon burime të ndryshme informacioni për përgatitjen e një teme të dhënë.
3. Identifikon dhe krahason informacionet e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh duke i shënuar me shenja të ndryshme).
4. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo burime të tjera për të realizuar një veprimtari apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij.
5. Krahason përpunimin e tij, me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një veprimtari të caktuar.
6. Përdor portofolin personal si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara duke hartuar një plan pune me hapa konkretë për përmirësim.
7. Identifikon cilësitë që zotëron dhe ato që duhen zhvilluar për të nxënë gjatë zhvillimit të një detyre apo veprimtari të caktuar duke bashkëpunuar me të tjerët.
8. Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën, që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/veprimtari individuale apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
9. Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informacionin/njohuritë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar, përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo burimeve të tjera.
10. Prezanton për 6-10 minuta përvojën e vet.

## Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

### Nxënësi:

1. Përgatit një plan pune një javor dhe specifikon veprimtaritë parësore duke argumentuar përzgjedhjen e tyre.
2. Përgatit një projekt të vogël duke theksuar veprimtaritë kryesore për një çështje që e shqetëson në shkollë ose komunitet dhe përcakton kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për zbatimin e tij.
3. Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për veprimtaritë e mundshme, për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

4. Paraqet në formë tabelare, grafike, vizatimi apo formë tjetër, veprimtaritë e përkujdesjes për qeniet e gjalla, të cilat mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij.

### **Kompetenca personale**

#### Nxënësi

1. Përgatit një listë me ushqime që i shfrytëzon familja dhe i radhit ato sipas kalorive dhe vlerave ushqyese, duke i klasifikuar në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.
2. Lexon të dhënat në paketimet e ushqimit dhe i diskuton në grup ato (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj).
3. Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata rreziku të shëndetit fizik dhe mendor.
4. Bashkëpunon në mënyrë aktive me gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).
5. Përkujdeset për një mjedis të shëndetshëm gjatë realizimit të një veprimtarie të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve kushte të përshatshme pune (ajrosje, ndriçim, shfrytëzim maksimal të hapësirës, pastërti dhe rregull).

### **Kompetenca qytetare**

#### Nxënësi:

1. Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
2. Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve, përbërjen dhe rolin e tyre në aktivitete të ndryshme mësimore, këshilla të klasës/shkollës etj.
3. Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, rregullores së klasës dhe argumenton rëndësinë e respektimit të rregullave të propozuara, nëpërmjet formave të ndryshme shprehëse, duke parashikuar pasojat e moszbatimit.
4. Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

## ∞ **Kompetenca digjitale**

Nxënësi:

1. Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar.
2. Organizon dhe komunikon informacionin, duke përdorur mjetet e duhura të komunikimit teknologjik për të mbledhur informacion dhe për të komunikuar me të tjerët (p.sh. e-mail, internet, video-konferencë, postera mbi një temë të caktuar) angazhuar me nxënësit e kulturave të tjera nëpërmjet komunikimeve online.
3. Organizon, mbledh dhe shfaq të dhënat e gjetura nga burimet e informacionit elektronik.
4. Identifikon dhe përdor bazën e të dhënave të sigurta dhe të përshtatura për moshën e tij, nëpërmjet burimeve elektronike apo të shtypit.
5. Jep shembuj të punës me teknologjitë, të zgjidhjeve që ato na ofrojnë në jetën e përditshme, në bazë të të cilave ne marrim vendimet tona.
6. Demonstron sjellje pozitive dhe etike kur përdor teknologjinë si një mjet komunikimi ose shërbimi apo krijimi të një produkti.



## Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave të fushës

### TEMATIKA: SISTEMET

#### Përshkrimi i tematikës:

Një sistem përfaqëson një tërësi pjesësh të cilat punojnë së bashku për të kryer një funksion të caktuar.

Ka sisteme në natyrë, si dhe sisteme të ndërtuara nga njeriu. Shembuj të sistemeve në natyrë janë sistemet e trupit të njeriut. Shembuj të sistemeve të ndërtuara nga njeriu janë sistemet elektrike. Njohja e sistemeve e lejon njeriun të kuptojë si funksionon secila pjesë e sistemit dhe si ndërveprojnë me njëra-tjetrën për të kryer një funksion të caktuar.

Kjo temë përqendrohet tek studimi i sistemit të bimëve dhe kafshëve, sistemit elektrik, sistemeve të matjes.

#### Rezultatet e të nxënimit

#### Sistemet te bimët dhe njeriu

##### *Shkathësitë dhe procedurat*

Nxënësi:

1. Krahason skeletin e trupit të njeriut me atë të kafshëve të tjera.
2. Tregon se skeleti ndërtohet nga kocka të cilat te njeriu dhe disa kafshë rriten brenda trupit.
3. Kryen hetime që provojnë fortësinë e kockave dhe thyeshmërinë e tyre.
4. Përshkruan se si kockat e skeletit rriten, mbështesin dhe mbrojnë trupin.
5. Formulon pyetje dhe heton përgjigjet për rritjen dhe skeletin;
6. Emërton kockat kryesore në trupin e njeriut;
7. Tregon:
  - se kafshët me skelet kanë muskuj që lidhen me kockat;
  - se një muskul duhet të tkurret që të shkaktojë lëvizjen e kockës;
  - se muskujt punojnë në çifte.
8. Shpjegon rolin e drogave si ilaçe.

## ***Qëndrimet dhe vlerat***

Nxënësi:

Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfuara nga vëzhgimet individuale.

Demonstron ndjeshmëri dhe përkujdesje për fëmijë me probleme shëndetësore si astmatikët, diabetikët, epileptikëve etj. në klasë/shkollë.

## **Elektriciteti dhe magnetizmi**

### ***Shkathësitë dhe procedurat***

Nxënësi:

1. Shpjegon se elektriciteti rrjedh në qarqet elektrike.
2. Shpjegon se elektriciteti prodhohet nga pila/burimi ose bateritë.
3. Paraqet përmes një vizatimi të thjeshtë lëvizjen e orientuar të thërmijave në qarkun elektrik.
4. Tregon se rryma elektrike është lëvizja e thërmijave nga poli pozitiv i burimit në polin negativ.
5. Identifikon pajisjet e thjeshta elektrike që punojnë me elektricitet ( rrymë).
6. Përshkruan elementët përbërës të një qarku të thjeshtë elektrik (pilë/burim, fije përcjellëse, llamba elektrike) dhe rolin e secilit prej tyre.
7. Shpjegon se llamba ndriçon ose jo, kur hapim apo mbyllim çelësin.
8. Shpjegon se një pajisje elektrike nuk punon në qoftë se ka shkëputje në qark.
9. Shpjegon se ndriçimi i llambave në qark zvogëlohet , kur shtojmë numrin e llambave në të dhe anasjelltas.
10. Shpjegon se kur numri i pilave në qark është shumë i madh, llambat digjen.
11. Shpjegon se llambat dhe zilet e lidhura në qark punojnë brenda një vliere të përcaktuar rryme.
12. Tregon se burimi duhet të ketë një tension të mjaftueshëm që të gjitha elementët e qarkut të punojnë.
13. Krahason qarkun e thjeshtë elektrik me qarkun më shumë elementë.
14. Ndërton skemën e një qarku të thjeshtë elektrik në seri, me (pilë/burim, tela lidhës dhe llambë).
15. Ndërton skemën e një qarku elektrik të përbërë nga ( çelësa, bateri, tela lidhës dhe llamba).
16. Ndërton skemën e një qarku me zile elektrike.
17. Dallon përcjellësit nga jopërcjellësit.

### ***Qëndrimet dhe vlerat***

Nxënësi:

1. Vlerëson rëndësinë e përdorimit të elektricitetit në jetën e përditshme.
2. Tregon si zbatohen rregullat e sigurisë gjatë punës me pajisjet elektrike për t'u mbrojtur nga rreziqet e mundshme.
3. Punon në grup për krijimin e një posteri që përmban rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitet dhe e prezanton atë.
4. Punon në grup projektin me temë: "Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre".
5. Ndërton një qark të thjeshtë elektrik të lidhjes në seri.
6. Përdor elementët bazë të një qarku elektrik për të ndërtuar pajisje të thjeshta elektrike.

## TEMATIKA: ENERGJIA

### Përshkrimi i tematikës:

Energjia bën të mundur ndryshimet dhe lëvizjen në natyrë. Njeriu përdor forma të ndryshme energjie për qëllime të ndryshme. Të gjitha qëniet e gjalla, përfshirë dhe njeriun, kanë nevojë për energji që të kryejnë proceset jetësore. Kjo tematikë i ndihmon nxënësit të vlerësojnë rëndësinë dhe përdorimet e energjisë, si dhe nevojën për ta ruajtur atë.

Kjo tematikë studion burimet dhe përdorimet e energjisë, shndërrimet e saj nga një formë në tjetren, dritën, zërin, elektricitetin dhe magnetizmin. Ajo trajton mënyrat e shfrytëzimit të energjisë dhe u krijon mundësi nxënësve për të identifikuar rastet e keqpërdorimit dhe për pasojë, të ruajtjes dhe kursimit të saj.

### Tingulli

#### Rezultatet e të nxënit

#### *Shkathësitë dhe proceset.*

Nxënësi:

Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme;

Hulumton se tingulli :

- a) përhapet nga një burim dhe dëgjohet kur arrin në veshin tonë
- b) përhapet përmes një mjedisi lëndor
- c) përhapet përmes materialeve të ndryshme lëndore (trupa të ngurtë, lëngje dhe gaze)
- d) përhapet më mirë përmes trupave të ngurtë
- e) dëgjohet kur arrin në veshin tonë
- f) dobësohet kur largohemi nga burimi që e prodhon atë

Shpjegon se tingulli prodhohet kur trupat dridhen në mjedis dhe shkakton ngjeshjen apo rallimin e shtresave të mjedisit.

Shpjegon se tingulli dëgjohet kur dridhjet arrijnë në veshin tonë;

Tregon se disa materiale nuk e lejojnë kalimin e tingullit përmes tyre;

Dallon tingujt e lartë nga tingujt e ulët;

Dallon tingujt e fortë nga tingujt e butë;

Shpjegon se dridhjet e vogla prodhojnë tinguj të butë.

Shpjegon se dridhjet e forta prodhojnë tinguj të fortë.

Krahason nivelin e tingullit me karakteristikat e trupit që e shkakton atë.

Krahason volumin e një tingulli me forcën e tingullit që e shkakton atë.

Tregon se volumi i tingullit lidhet me fortësinë dhe butësinë e tingullit.

Tregon se sa më të shpejta janë dridhjet aq më i lartë është tingulli.

Shpjegon si ndryshon lartësia e tingullit kur ndryshon:

- a) gjatësia e telit
- b) trashësia e telit
- c) tendosja e telit në instrument

Shpjegon si ndryshon lartësia e tingullit në instrumentet me goditje (daullja).

Tregon si prodhohen tingujt nga instrumentet frymorë.

Tregon se sa më e gjatë është kolona e ajrit aq më e ulët është lartësia e tingullit.

Mat nivelin e tingullit me njësinë matëse decibel (db).

**Qëndrimet dhe vlerat.**

Nxënësi:

Planifikon në grup veprimtari për të shpjeguar prodhimin dhe përhapjen e tingujve nga burime të ndryshme.

Tregon përgjegjësi dhe kujdes për të ruajtur shqisën e dëgjimit nga tingujt e fortë dhe të lartë.

Diskuton me shokët dhe shoqet e klasës si përhapen tingujt në mjediset të ndryshme (trupa të ngurtë, lëngje, gaze) apo në hapësirën kozmike.

Realizon një projekt me temë: “Si prodhohen tingujt nga instrumentet muzikore me tela dhe frymorë”.

Realizon një diskutim me temë: “Përdorimi i kufjeve në jetën e përditshme”.

Realizon një projekt me temë: “Studimi i nivelit të ndotjes akustike në mjediset ku jetojmë dhe mënyrat e zvogëlimit të saj deri në kufijtë e lejuar për veshin e njeriut”.

**TEMATIKA: NDËRVEPRIMET****Përshkrimi i tematikës:**

Studimi i ndërveprimit midis dhe brenda sistemeve zhvillon të kuptuarit e mjedisit dhe rolit e njeriut në të. Ndërveprimet ndodhin brenda një organizmi, midis organizmave si dhe midis organizmave dhe mjedisit. Ndërveprimi i njeriut me mjedisin drejton zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë. Në të njëjtën kohë shkencë dhe teknologjia ndikojnë në mënyrën si njeriu ndërvepron me mjedisin. Të kuptuarit e këtij ndërveprimi e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë pasojat pozitive dhe negative të veprimeve të tij dhe të jetë përgjegjës për to.

Tematika fokusohet te ndërveprimi brenda dhe ndërmjet bimëve, kafshëve, njeriut, mjedisit, mikroorganizmave, atmosferës, sistemit diellor dhe Tokës, forcave, shkencës dhe teknologjisë.

**Rezultatet e të nxënimit*****Shkathësitë dhe proceset.***

Nxënësi:

Kryen kërkime për bimë dhe kafshë që jetojnë në habitate të ndryshme dhe diskuton për tipare me të cilat ata përshatzen me mjedisin ku jetojnë.

Demonstron përdorimin e një çelësi të thjeshtë përcaktimi p.sh. për të identifikuar një specie të panjohur të gjetur në mjedisin përreth.

Diskuton mënyrat me të cilat veprimtaria e njeriut ndikon në habitate lokale.

***Qëndrimet dhe vlerat.***

Nxënësi:

Vlerëson burimet e ndryshme të informacionit (enciklopedi, ilustrime, website etj.) që mbështesin kërkimin e tij/saj në habitate lokale.

Demonstron kuriozitet në eksplorimin e mjedisit natyror dhe të mjedisit të ndërtuar nga njeriu.

**TEMATIKA: DIVERSITETI****Përshkrimi i tematikës:**

Kjo tematikë nënvizon rëndësinë e ruajtjes së shumëllojshmërisë në natyrë. Për të kuptuar më mirë botën në të cilën jetojmë, njeriu përpiqet të organizojë botën e gjallë dhe jo të gjallë. Ka disa tipare të përbashkëta që lidhin të gjitha qëniet e gjalla dhe faktorë unikë në botën jo të gjallë që e ndihmojnë njeriun t'i klasifikojë ato. Ruajtja e shumëllojshmërisë siguron mbijetesën dhe vazhdimësinë e jetës.

Në fokus të kësaj tematike është diversiteti i kafshëve, bimëve, mikroorganizmave, mjedisit natyror, lëndëve dhe vetive e karakteristikave të tyre.

**Diversiteti i lëndëve**  
**Rezultatet e të nxënës**  
***Shkathësitë dhe proceset.***

Nxënësi:

Identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta.

Vëzhgon dhe krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre.

Heton dhe përshkruan përzierjen e lëndëve të ndryshme dhe ndarjen e tyre.

Heton dhe shpjegon tretjen e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në tretje.

***Qëndrimet dhe vlerat.***

Nxënësi:

Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e lëndëve.

Demonstron bashkëpunim gjatë punës në grup.



## TEMATIKA: CIKLET

### Përshkrimi i tematikës:

Në natyrë ka ndryshime që përsëriten në mënyrë ciklike. Shëmbuj të tyre janë ciklet jetësore të qënieve të gjalla, cikli i ujit etj. Të kuptuarit e këtyre cikleve e ndihmon njeriun të parashikojë ngjarjet dhe proceset dhe të vleresojë Tokën si një sistem të vetëqëndrueshëm.

Kjo tematike përqëndrohet në ciklet e proceseve jetësore te bimët, kafshët, njeriu, moti, atmosfera, sistemi diellor dhe Toka, përzierjet dhe ndryshimet e lëndëve, nxehtëja dhe ftohja.

### Rezultatet e të nxënit

#### *Shkathësitë dhe proceset.*

Nxënësi:

Hulumton dhe përshkruan mënyrën se lëndët ndryshojnë kur nxehen dhe kur ftohen.

Heton dhe përshkruan shndërrimin e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në to.

Heton dhe vëzhgon proceset e shkrijës dhe ngurtësimit.

Heton dhe vëzhgon proceset e vlimit, avullimit dhe kondensimit të ujit.

Qëndrimet dhe vlerat.

Demonstron bashkëpunim gjatë punës në grup.

Vlerëson burimet e ndryshme të informacionit (enciklopedi, ilustrime, website etj) që mbështesin kërkimin e tij.

Tematika/Shkalla 2	Sistemet	Energjia	Ndërveprimet	Diversiteti	Ciklet	Gjithsej:
Klasa e katërt	28	17	15	5	5	70 orë

## SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS

SHËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE			
Tematika	Periudha 1 24 orë Temat mësimore	Periudha 2 26 orë Temat mësimore	Periudha 3 20 orë Temat mësimore
Sistemet	<p><b>Nerëzit dhe kafshët</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Skeletet.</li> <li>2. Skeleti i njeriut.</li> <li>3. Përse na nevojitet skeleti?</li> <li>4. Përse na nevojitet skeleti?</li> <li>5. Skeleti dhe lëvizja.</li> <li>6. Drogat dhe ilaçet.</li> <li>7. Si funksionojnë ilaçet?</li> <li>8. Projekt "Ilaçet dhe kujdesi për përdorimin e tyre".</li> <li>9. Projekt "Ilaçet dhe kujdesi për përdorimin e tyre".</li> <li>10. Kontrolloni përparimin tuaj</li> </ol>		<p><b>Elektriciteti dhe magnetizmi</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Elektriciteti rrjedh në qarqe.</li> <li>2. Elektriciteti rrjedh në qarqe.</li> <li>3. Elementët e qarqut elektrik të thjeshtë.</li> <li>4. Çelësat</li> <li>5. Qarqet elektrik me shumë elementë.</li> <li>6. Qarqet me sinjalizues</li> <li>7. Qarqet me sinjalizues</li> <li>8. Elektriciteti i rrjetit</li> <li>9. Projekt "Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre".</li> <li>10. Projekt "Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre".</li> <li>11. Posteri "Rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitet".</li> <li>12. Ekspozitë "Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe siguria".</li> <li>13. Përdorimi i magnetëve në jetën e përditshme</li> <li>14. Polet magnetike.</li> <li>15. Polet magnetike.</li> <li>16. Fuqia e magnetëve</li> <li>17. Fuqia e magnetëve</li> <li>18. Cilat metale janë magnetike?</li> <li>19. Kontrolloni përparimin tuaj</li> <li>20. Kontrolloni përparimin tuaj / Ttest/ Detyrë përmbledhëse</li> </ol>

<p><b>Ndërveprimet</b></p>	<p><b>Gjallesat dhe mjedisi</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>21. Shpendë interesantë.</li> <li>22. Shpendë interesantë.</li> <li>23. Një habitat për kërmijtë.</li> <li>24. Një habitat për kërmijtë.</li> <li>25. Kafshët në habitatet e tyre.</li> <li>26. Kafshët në habitatet e tyre.</li> <li>27. Çelësi i përcaktimit</li> <li>28. Identifikimi i jorruazorëve.</li> <li>29. Identifikimi i jorruazorëve.</li> <li>30. Si ndikojmë në mjedis.</li> <li>31. Rëndësia e ujit për jetën</li> <li>32. Riciklimi mund të shpëtojë Tokën.</li> <li>33. Kontrolloni përparimin tuaj</li> <li>34. Kontrolloni përparimin tuaj / Ttest/ Detyrë përmbledhëse</li> </ol>		
<p><b>Diversiteti</b></p>		<p><b>Trupat e ngrurtë lëngjet dhe gazet</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Lënda</li> <li>2. Lënda përbëhet nga grimca.</li> <li>3. Lënda përbëhet nga grimca.</li> <li>4. Si sillen trupat e ngrurtë, lëngjet dhe gazet?</li> <li>5. Si sillen trupat e ngrurtë, lëngjet dhe gazet?</li> </ol>	

<p><b>Ciklet</b></p>		<p><b>Trupat e ngurtë, lëngjet dhe gazet</b>          6. Shkrija, ngrija dhe vlimi          7. Shkrija e lëndëve të ndryshme          8. Pika e shkrijes dhe pika e vlimit.          9. Tretja e lëndëve          10. Përzierja e lëndëve dhe ndarja e tyre          11. Kontrolloni përparimin tuaj</p>	
<p><b>Energjia</b></p>		<p><b>Tingulli</b>          12. Përhapja e tingullit nëpërmjet materialeve të ndryshme.          13. Tingulli përhapet përmes materialeve të ndryshme.          14. Si përhapet tingulli.          15. Si përhapet tingulli.          16. Tingujt e fortë dhe tingujt e dobët.          17. Tingujt e fortë dhe tingujt e dobët.          18. Volumi i tingullit.          19. Dobësimi i tingujve.          20. Tingujt të lartë dhe tingujt të ulët          21. Tingujt të lartë dhe tingujt të ulët.          22. Lartësia e tingullit në instrument          23. Argëtim me instrumentet frymorë.          24. Projekt “Tingujt e fortë dhe të lartë”.          25. Kontrolloni përparimin tuaj          26. Kontrolloni përparimin tuaj / Test/          Detyrë përmbledhëse</p>	

**Planifikimi**  
**Periudha e parë**  
**Fusha: Shkencat Natyrore**  
**LËNDA: DITURI NATYRE**

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
1		1	Skeletet.	Zbulojmë kockat e trupit tonë	Përvijim i të menduarit Diskutim	Vlerësim i përgjigjeve me gojë. Vlerësim mes nxënësish	Programi lëndor Teksti shkollor		
2			Skeleti i njeriut.	Modelojmë skeletin e njeriut	Rishikim në dyshe Veprimtari	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klasë	fletorja e punës, Libri i mësuesit, enciklopedi,		
3	<b>Sistemet</b>	2	Përse na nevojitet skeleti?	Kockat e kujt janë më të gjata	Diskutim Veprimtari kërkimore	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit si:	plastelinë		
4			Përse na nevojitet skeleti?						
5	Skeletet dhe muskujt	3	Skeleti dhe lëvizja.	Si punojnë muskujt?	Veprimtari Lojë	matjet krahasime dhe përfundime.	fleta me ngjyra vizore metër		
6			Drogat dhe ilaçet.					grafi	
7		4	Si funksionojnë ilaçet?	Përdorimi i ilaçeve	Harta e mendjes Shpjegim i përparuar Vija e vlerës	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klasë	paketime ilaçesh të ndryshme		
8			Projekt “Ilaçet dhe kujdesi për përdorimin e tyre”.	Si përdoren ilaçet	Diskutim Punim projekti Prezantim i projektit	Vlerësim i intervistës bazuar në treguesit e përdorur	recetë mjekësore		

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
9			Projekt "Ilaçet dhe kujdesi për përdorimin e tyre".						
10		5	Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di.	Diskutim Lojë	Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim.	materiale të ndryshme		
11	Ndërveprimet Qeniet e gjalla në mjediset e tyre		Shpendë interesantë.	Duke vëzhguar zogjtë	Shikim dokumentari Diskutim	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit	enciklopedi, filmim dokumentari		
12		6	Shpendë interesantë.		Kërkim shkencor	Vlerësim mes nxënësish	pamje me shpendë të nryshëm		
13			Një habitat për kërmijtë.	Çfarë habitati përlejnë kërmijtë?	Diskutim Kërkim shkencor	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit	ushqim për zogjtë		
14		7	Një habitat për kërmijtë.			Vlerësim mes nxënësish	letër laps zmadhues		

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
15		8	Kafshët në habitatet e tyre.	Vëzhgojmë kafshët	Shpjegim i përparuar Hetim shkencor	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit si: matjet krahasime dhe përfundime	foto të dnryshme kafshës		
16			Kafshët në habitatet e tyre.						
17		9	Çelësi i përcaktimit	Gjej cila kafshë është	Lojë Hedhje e strukturuar e të dhënave	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klasë	ngjyra, lapsa, video-projektor		
18			Identifikimi i jorruazorëve.	Identifikimi i jorruazorëve.	Vëzhgojmë jorruazorët	Braingstorming Veprimtari kërkimore	Vlerësim i veprimtarisë kërkimore bazuar në treguesit e përdorur	foto të aktiviteteve mjedisore të klasës për pastrimin e ambienteve.	
19		10	Identifikimi i jorruazorëve.						
20			Si ndikojmë në mjedis.	Si mund ta mbrojmë mjedisin	Harta semantike Ditari dypjesësh	Vlerësim i përgjigjeve me gojë.	doreza plastike,		
21		11	Rëndësia e ujit për jetën	Rrugëtimi i lumit	Parashikim me terma paraprakë Harta e mendimit	Vlerësim i përgjigjeve me gojë dhe veprimtaritë kërkimore	kërcej bimësh të ndryshme, bërthama vazozelqi		
22			Riciklimi mund të shpëtojë Tokën.	Riciklimi mund të shpëtojë riciklim.	Pyetje përgjigje Veprimtari kërkimore	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klauë			

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
23			Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di.	Prezantim Punim i detyrës përmbledhëse Diskutim	Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim. Vetëvlerësim i nxënësve.	fleta e detyrës përmbledhëse, lapsa		
24			Kontrolloni përparimin tuaj / Test/ Detyrë përmbledhëse						



**Planifikimi**  
**Periudha e dytë**  
**Fusha: Shkencat Natyrore**  
**LËNDA: DITURI NATYRE**

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënimit	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita	
25	<b>Diversiteti Gjendjet e lëndëve</b>	1	Lënda	Çfarë është lënda?	Harta e mendjes Lojë	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klasë	Programi lëndor. Teksti shkollor fletorja e punës,			
26			Lënda përbëhet nga grimca.	Loja me grimca	Di, Dua të di , Mësova		Magnetë të llojeve të ndryshëm			
27		2	Lënda përbëhet nga grimca.				Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit	objekte të vogla magnetike dhe jo magnetike,		
28			Si sillen trupat e ngurtë, lëngjet dhe gazet?	Çfarë ndodh me formën e lëndës?	Diskutim Hetim			kapëse letrash çeliku		
29		3	Si sillen trupat e ngurtë, lëngjet dhe gazet?			Vetëvlerësim i nxënësve.				
30	<b>Ciklet</b> Ndryshimet e gjendjes së lëndëve		Shkrimja, ngrirja dhe vlimi	Çfarë ndodh?	Imaginatë e drejtuar Mbajtja e strukturuar e shënimeve					
31		4	Shkrimja e lëndëve të ndryshme	Cila nga lëndët do të shkrijë e para?	Braingstorming Hetim	Vlerësim me prezantime me gojë ose me shkrim.				

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
32			Pika e shkrires dhe pika e vlimit.	Sa është temperatura?	Përvijim i të menduarit Kërkim shkencor	Vlerësim i përgjigjeve me gojë.	enciklopedi  ujë  enë që durojnë nxehtësinë		
33		5	Tretja e lëndëve	Përftojmë tretësirë	Diskutim Prova, eksperimente	Vlerësim mes nxënësish Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit si: matjet krahasime dhe përfundime.	Vizore		
34			Përzjerja e lëndëve dhe ndarja e tyre				Termometër		
35		6	Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di.	Lojë Shkrim i shpejtë	Vlerësim me prezantime me gojë e me shkrim.	lapsa me ngjyrë për hartimin e grafikëve me shtylla		
36			Përhapja e tingullit nëpërmjet materialeve të ndryshme.	Çfarë dëgjon	Vëprimtari kërkimore	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit Vlerësim mes nxënësish	Vizore dhe lapsa me ngjyrë për hartimin e grafikëve me shtylla,		

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e nxënit	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
37		7	Tingulli përhapet përmes materialeve të ndryshme.	Kërcimi i orizit	Diskutim për njohuritë paraprake Veprimtari kërkimore	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klaë	enciklopedi, spango kuti metalike		
38			Si përhapet tingulli.				material të ndryshme për të provuar		
39		8	Si përhapet tingulli.			Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit si: matjet krahasime dhe përfundime	përhapjen e tingullit burime tongujsh të ndryshëm apparat matës të tingullit		
40	<b>Energjia Tingulli</b>		Tingujt e fortë dhe tingujt e dobët.	Tingujt që dëgjojmë	Lojë Hulumtim Diskutim		figura të ndryshme		
41		9	Tingujt e fortë dhe tingujt e dobët.			Vlerësim i bazuaraatjeve bazuar në treguesit e përdorur	material të ndryshme për ndërtimin e instrumenteve muzikore		
42			Volumi i tingullit.	Si e matim tingullin	Ditar dypjesësh			instrumente muzikore me tela	
43		10	Dobësimi i tingujve.	Në kërkim të materialeve për dobësimin e tingujve	Diskutim Kërkim shkencor	Vlerësim mes nxënësish Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit si: matjet krahasime dhe përfundime.			
44			Tinguj të lartë dhe tinguj të ulët.						

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
45		11	Tinguj të lartë dhe tinguj të ulët	Ndërtojmë instrumenta	Dëgjim muzikor Veprimtari	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit Vlerësim mes nxënësish	instrumente muzikore me goditje		
46			Lartësia e tingullit në instrument						
47		12	Argëtim me instrumentet frymore.	Prodhohjmë tinguj nëpërmjet fryrjes	Dëgjim muzikor Veprimtari	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klauë			
48			Projekt “Tingujt e fortë dhe të lartë” .	Po më tej çfarë?	Projekt Reflektime		fleta e testit/ detyrës përmbledhëse, lapsa, ngjyra		
49		13	Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di.	Prezantim Punim i detyrës përmbledhëse Diskutim	Vetëvlerësim i nxënësve.			
50			Kontrolloni përparimin tuaj / Test/ Detyrë përmbledhëse			Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim.			

**Planifikimi**  
**Periudha e tretë**  
**Fusha: Shkencat Natyrore**  
**LËNDA: DITURI NATYRE**

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
51	<b>Sistemet Elektriciteti dhe magnetizmi</b>	1	Elektriciteti rrjedh në qarqe.	Ryma elektrike dhe karamelat	Diskutim Lojë	Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klauë	Programi lëndor. Teksti shkollor Fletorja e punës, bateri, llambë, tel përcjellës, çelës pineska, kapëse letrash, top enciklopedi, mjete për punimin e projektit		
52			Elektriciteti rrjedh në qarqe.						
53		2	Elementët e qarqut elektrik të thjeshtë. Çelësat	Ndërtimi i një qarqut elektrik Si të bëjmë një çelës	Braingstorming veprimtari Lojë veprimtari	Vlerësim mes nxënësish Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë veprimtarive			
54									
55		3	Qarqet elektrik me shumë elementë. Qarqet me sinjalizues	Ndërtimi i një qarqut me shumë elementë Ndërtimi i një qarqut me sinjalizues	Veprimtari prezantim Shënime të strukturuar veprimtari	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit Vlerësim mes nxënësish			
56									
57		4	Qarqet me sinjalizues			Vlerësim i aktivitetit dhe veprimtarive të nxënësve në klauë			

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
58			Elektriciteti i rrjetit	Elektriciteti: i nevojshëm, i rrezikshëm	Imagjinatë e drejtuar Lexim rishikim në dyshe				
59		5	Projekt “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre”.	Pajisjet elektrike	Projekt	Vlerësim mes nxënësish Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hetimit si: matjet krahasime dhe përfundime.	lapsa, ngjyra,  fleta e testit/ detyrës përmbledhës,  materialet për prezantim		
60			Projekt “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre”.						
61		6	Poster “Rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitet”	Kujdes!	Poster	Vlerësim mbi përfshirjen në projekt dhe prezantim			
62			Ekspozitë “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe siguria”	Pajisjet elektrike	Turi i galerisë				
63		7	Përdorimi i magnetëve në jetën e përditshme	Kush është magnetike?	Harta semantike Demonstrim	Vlerësim i intervistës bazuar në treguesit e përdorur			

Nr	Tematikat	Java	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialet didaktike	Data	Dita
64			Polet magnetike.	Çfarë poli është?	Braingstorming Pohim- mbështetje	Vlerësim mes nxënësish Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë hefimit si: matjet krahasime dhe përfundime.			
65		8	Polet magnetike.						
66			Fuqia e magneteve	Magnetet	Lojë Veprimtari	Vlerësim mbi përfshirjen në proceset gjatë orës mësimore.			
67		9	Fuqia e magneteve		Prezantim diskutim	Vlerësim mes nxënësish			
68			Cilat metale janë magnetike?						
69		10	Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di.	Prezantim Punim i detyrës përmbledhëse Diskutim	Vetëvlerësim i nxënësve. Vlerësim me detyrë përmbledhëse dhe prezantime me gojë ose me shkrim.			
70			Kontrolloni përparimin tuaj/ Test/ Detyrë përmbledhëse						

# KAPITULLI 1

## Njerëzit dhe kafshët

### Ora 1

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Skeletet		<b>Situata e të nxënit:</b> Zbulojmë kockat e trupit tonë.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Kupton se njerëzit dhe një pjesë e kafshëve kanë skelet kockor të brendshëm. Krahason skeletin e trupit të njeriut me atë të kafshëve të tjera. Tregon se skeleti ndërtohet nga kocka të cilat te njeriu dhe disa kafshë rriten brenda trupit.		<b>Fjalë kyçe:</b> skelet, strukturë, kockë, kafkë, rruazë, shtyllë kurrizore	
<b>Burimet e mjete:</b> foto, filmime pamjesh të shkarkuara nga interneti		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Edukim fizik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <p><b>Përvijim i të menduarit:</b> Tregohet para klasës konturi i trupit të një nxënësi të klasës së katërt të vizatuar në përmasa reale. Drejtohet pyetja: <i>Cilat janë pjesët e trupit të dukshme në këtë vizatim?</i> Ftohen të mendojnë dhe propozojnë pjesën e tjera të trupit që mund t'i shtohen konturit si dhe vendin ku duhen vendosur ato. Nxiten nxënësit të vazhdojnë gjetjet e tyre derisa të përmendin kockat dhe nevojën e një skeleti. Drejtohen pyetjet: <i>A keni pasur mundësi të shihni skelete p.sh. nëpër muze të ndryshme apo nëpër programet televizive?</i> Prezantohen figurat e paraqitura në fq.6 të librit. Sqarohen nxënësit se figura e parë është e një kafshe që ka jetuar shumë vjet më parë, ndërsa për tjetrën nxiten nxënësit vetë të tregojnë se ai është skeleti i njeriut. Për çfarë na nevojitet një skelet? Pasi nxënësit japin mendime, ngrihet lart skica e letrës dhe drejtohen pyetjet: <i>Çfarë do të ndodhte po të mos kishim skelet? A do të mundeshim të qëndronim vetë?</i> Shpjegohet se po të mos ishte skeleti, trupi ynë do të ishte i përkulshëm si ai në letër. Jepen shembuj të ndërtesave të mbuluara me skela, ose ndërtesa me konstruksione mbajtëse.</p> <p><b>Shpjegim i përparuar:</b> Shpjegohet se ashtu si struktura e ndërtesave (kolonat në figura), skeleti është një strukturë e fortë e cila mban e trupin dhe i jep formë atij. Krahasohen nga pamja skeletet e dhëna në figurën e librit dhe dallimi nga forma I tyre në lidhje me kujt i përkasin. Tregohen skelete kafshësh për t'u vërtetuar atyre se disa lloje kafshësh kanë gjithashtu skelet kockor. Duke i demonstruar tregohet se skeletet përbëhen nga kockat. <i>Duke parë skeletin ç'mund të thoni për kockat?</i> Nxiten nxënësit të tregojnë për ngjyrën, format dhe fortësinë e tyre.</p> <p><b>Veprimtari:</b> Secili nxënës do të rreshqasë gishtat në qendër të kurrizit. <i>Çfarë ndjetë?</i> Ato janë 26 kocka që quhen rruaza ose vertebra dhe formojnë shtyllën kurrizore. Kur ne përkulemi, vertebrat i përshtaten lëvizjes sonë. Krahasohet shtylla kurrizore e njeriut me një fill me rruaza. Ashtu sikurse filli me rruaza është elastik dhe mund të përkulet, edhe shtylla jonë kurrizore është e tillë. Nëse shtylla jonë kurrizore do të përbëhej nga një kockë e vetme, ne nuk do të mund të përkulehim ose të rrotulloheshim. Nxënësit nën drejtimin dhe demonstrimin e mësueses ndjekin hapat e veprimtarisë 1.1 për të zbuluar kockat në trupin e tyre. Nxënësit do të gjejnë kockat nën lëkurën e njërës prej duarve të tyre, dhe do të përpiqen të marrin me mend formën që mund të kenë kockat aty. Ju kërkohet nxënësve të japin idetë e tyre në lidhje me atë çka dine ose mendojnë se dinë për kockat.</p>			



**Diskutim:** Pasi pamë skeletet dhe zbuluam kockat në trupin tonë, çfarë mund të thoni për to? Përse shërben skeleti? Pse duhet të jetë i fortë? Nga se përbëhet skeleti? Si janë format dhe përmasat e kockave? Kockat nuk janë shumë të rënda. Si mendoni, a i ndihmon kafshët kjo gjë? A kanë të gjithë skeletet kocka? Jo të gjitha skeletet përbëhen nga kockat. Disa lloje kafshësh, siç janë peshkaqenët ose raxhat kanë skelet kërcor, lëndë e cila është më e butë dhe më elastike se kocka. Sqaroni faktin se pjesët fundore të kockave tona, si dhe pjesa e jashtme e veshëve dhe e hundës përbëhet gjithashtu nga kërcat.

Ftohen nxënësit të bëjnë një vizatim se si e përfytyrojnë një trup pa skelet. Me dëshirë nxënësit tregojnë vizatimet e tyre.

Vlerësimi: Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë dhe diskutimeve.

Detyra: Punimi i fq. 9 në Fletore pune

Refleksion: Si mund të kujdesem për kockat e skeletit tim?

**Shënim:** Në fillim të orës së mësimi mund të realizohet me anë të vizatimit një kontur i trupit të një nxënësi i cili mund të shtrihet ose mbështetet tek muri mbi një letër dhe mësuesja të vizatojë me laps konturin e tij. *Kujdes* pasi mund të ketë fëmijë të ndjeshëm ndaj këtij veprimi.

Gjatë kryerjes së veprimtarisë tregohet kujdes ndaj nxënësve mbipeshë, të cilët mund të kenë vështirësi në dallimin e kockave. Për ta do të jetë më e vështirë gjetja e kockave me anë të gishtave, në krahasim me nxënësit e tjerë më të dobët. Do të ishte më e lehtë për ta nëse do të ngrinin lart njërin krah dhe me dorën tjetër të ndjenin kockat në anën e tendosur të trupit. Këshillohen nxënësit të shtypin fort me gishta mbi trup derisa të arrijnë të ndjejnë brinjët.

## Ora 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Skeleti i njeriut		Situata e të nxëniti: Modelojmë skeletin e njeriut.	
<b>Rezultatet e të nxëniti sipas temës:</b> Kupton se njerëzit dhe një pjesë e kafshëve kanë skelet kockor të brendshëm. Emërton kockat kryesore në trupin e njeriut. Kupton se kockat kanë forma dhe përmasa të ndryshme. Kupton se kockat bashkohen me njëra-tjetrën për të formuar skeletet. Lidh provat me njohuritë dhe kuptimin shkencor në situata të ndryshme.		<b>Fjalë kyçe:</b> i parregullt, i hollë	
<b>Burimet e mjete:</b> plastelinë e bardhë ose brumë, fletë letre e zezë, ngjitës		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutohet me gjithë klasën plotësimi i ushtrimeve të fq.6 në Fletoren e punës. Rikujtohen përfundimet se skeletet formohen nga një numër kockash me forma dhe përmasa të ndryshme. Drejtohet pyetja: <i>Si mendoni ju, cilat janë kockat më të mëdha dhe më të vogla të trupit. Sa mund të jetë numri i kockave në trupin e njeriut?</i> <b>Shpjegim i përparuar:</b> Tregohet për numrin e kockave që gjenden në trupin tonë. Tek skeleti i të rriturve ndodhen 206 kocka, ndërkohë që tek skeleti i të porsalindurve ky numër është 275. Gjatë rritjes, disa nga kockat e trupit të bebeve shkrihen (bashkohen) me njëra tjetrën. Për shembull, gjatë rritjes disa kocka të kafkës bashkohen duke ulur kështu numrin e përgjithshëm të kockave.			

Ftohen nxënësit të shohin skeletin e një njeriu me përmasa reale figurën e paraqitur në fq. 9 të Librit. Sqarohen nxënësit se në gjymtyrët e poshtme të këmbëve dhe krahëve kockat janë dyshe? Numërohen së bashku brinjët që shihen në figurë (duhet të jenë 12 çifte). Drejtohet pyetja: A kanë kockat të njëjtën formë dhe madhësi, apo kanë formë dhe përmasa të ndryshme? Udhëzohen nxënësit të vëzhgojnë se të gjitha kockat e skeletit janë të lidhura në një fare mënyrë me shtyllën kurrizore. Theksohet se kockat lidhen me njëra-tjetrën duke formuar skeletin. Sqarohen nxënësit se kafshët me trup të madh kanë më shumë kocka se kafshët e vogla. Por ajo që ndryshon në këtë rast janë përmasat e kockave, ndërsa numri i tyre është gati i barabartë. P.sh. pothuajse të gjithë gjitarët kanë të njëjtin numër kockash, pavarësisht nga madhësia e tyre.

**Veprimtari:** Duke ndjekur hapat e përshkruar në libër dhe demonstrimin e mësueses, nxënësit në dyshe do të ndërtojnë skeletin e njeriut duke përdorur format e ndryshme të makaronave që kanë në duar. Nuk është e domosdoshme që ai të jetë i rregullt, por është e rëndësishme që tek ai të dallohen format kryesore të trupit me kafkën, shtyllën kurrizore, kraharorin, krahët, këmbët dhe legenit. Për t'u orientuar mund të vëzhgojnë skeletin e paraqitur në figurën e fq.9 në libër.

**Përmbledhje dhe rishikim në dyshe:** Nxënësit që kanë mbaruar më parë të orientuar nga figura e librit, mund të emërtojnë në fletë pjesët e skeletit. Gjithashtu plotësohet fleta e aktivitetit.

**Pyetje përgjigje:** Diskutohen me gjithë klasën pyetjet e librit si dhe rubrika “Diskutojmë”. Sqarohet se kafka përbëhet nga disa kocka të bashkuara, ajo mbron trurin dhe shqisat e ndijimit (sytë, veshët, gjuhën).

Kocka më e madhe e trupit është kocka e legenit. Ajo mban të gjithë peshën e pjesës së sipërme të trupit. Kurse kocka më e vogël është kockat e veshit. Brinjët (kraharori) mbulojnë zemrën dhe mushkëritë duke i mbrojtur ato. Për pyetjen e 6 sqarohen nxënësit se : Gratë lindin fëmijë, legenit i tyre është më i gjerë që foshnja të mund të rritet brenda trupit të nënës dhe të mund të dalë prej andej.

Gjithashtu diskutohet mbi informacionin e dhënë mbi gjirafat duke plotësuar se gjirafat kanë shtatë rruaza qafe, të cilat janë shumë më të mëdha se rruazat e qafës së njeriut. *Çfarë mendoni ju për këtë?*

Përmbledhjen së bashku njohuritë me rubrikën “Mësuam se”

Nxënësit kryejnë në dyshe prezantimin e punimeve të skeleteve në letër dhe gjithë klasa plotëson dhe emërton e pjesëve të skeletit në fletën e aktivitetit.

**Vlerësimi:** Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë dhe diskutimeve.

Nxënësit do të kontrollojnë përgjigjet e njëri-tjetrit për fletën e aktivitetit për të parë nëse kanë arritur të përvetësojnë konceptin sipas të cilit kockat lidhen me njëra-tjetrën duke formuar një skelet.

Detyra: Punimi i fq. 10 të Fletore Pune

Refleksion: *A kanë fëmijët të njëjtin numër kockash me të rriturit?*

*Shënim:* Për nxënësit që kanë vështirësi fleta e aktivitetit mund të jepet për plotësim në shtëpi.

## Ora 3

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Përse na nevojitet skeleti?		<b>Situata e të nxënimit:</b> Kockat e kujt janë më të gjata?	
<p><b>Rezultatet e të nxënimit sipas temës:</b></p> <p>Tregon se skeleti ndërtohet nga kocka të cilat te njeriu dhe disa kafshë rriten brenda trupit.</p> <p>Emërton kockat kryesore në trupin e njeriut.</p> <p>Përshkruan se si kockat e skeletit rriten, mbështesin dhe mbrojnë trupin.</p> <p>Formulon pyetje dhe heton përgjigjet për rritjen dhe skeletin.</p> <p>Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.</p> <p>Mbledh dhe të paraqet të dhënat.</p> <p>Nxjerr përfundime në bazë të të dhënave.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> gjatësia e kockave</p>	
<b>Burimet e mjete:</b> Metër shirit, vizore, lapsa		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte, Matematikë, Edukim Fizik	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><b>Diskutim:</b> Cila është arsyeja që fëmijët janë të vegjël dhe të rriturit të mëdhenj? Kërkohe mendimi i nxënësve në lidhje me faktin se me rritjen e trupit ne plakemi. Sqarohen nxënësit se ne rritemi por dhe skeleti ynë rritet. Kur bëhemi të mëdhenj rritja e skeletit ndalon, pra nuk rritet më.</p> <p><b>Veprimtari:</b> krahasim i përmasave të kockave. Ju jepen udhëzime nxënësve në lidhje me matjen e gjatësisë së krahut, parakrahut dhe kockës së kërcirit. Me ndihmën e një nxënësi duke e demonstruar para klasës mësuesja bën matjen e gjatësisë së krahut, parakrahut dhe kërcirit të saj. Këto përfundime i shënon në dërrasë. Nxënësit kopjojnë në fletore tabelën si ajo e fq. 10 në libër dhe më pas hedhin vlerat e matjeve të kryera. Për kryerjen e matjeve nxënësit punojnë në dyshe duke ndihmuar njëri-tjetrin.</p> <p>Drejtohet pyetja: <i>Kockat e kujt janë më të gjata, tuajat apo të mësueses? Si mund t'i tregojmë në një formë tjetër të dhënat e mbledhura nga matjet?</i> Nëse nxënësit nuk e japin si mendim sugjerohet nga mësuesja ndërtimi i një grafiku me shtylla. Në dërrasë jepen udhëzimet e nevojshme për ndërtimin e grafikut dhe mënyrën e paraqitjes së gjatësive nëpërmjet shtyllave për çdo matje. Nxënësit ndërtojnë në fletore grafikët dhe krahasojnë përfundimet e tyre.</p> <p>Në vazhdim të veprimtarisë nxënësit ndahen në grupe dhe bëjnë matje për të plotësuar fletën e aktivitetit 1.3b ose të ndërtojnë një tabelë të ngjashme me të parën për të hedhur matjet e gjatësive të kockave të pjesëtarëve të grupit dhe prezantimin e tyre në grafik me shtylla.</p> <p><b>Përmbledhje:</b> Grupet prezantojnë se në çfarë përfundimi dolën. Demonstronjë përfundimet nëpërmjet të dyja formave (tabelë, grafik me shtylla). Tregojnë se kockat e kujt ishin më të gjata. Ftohen nxënësit të bëjnë një parashikim: <i>Sa mund të jetë gjatësia e kockës së krahut të një adoleshenti? Pse mendoni kështu?</i></p> <p>Kockat e mësueses janë më të gjata. Kockat e një adoleshenti do të jenë më të gjata se kockat e një fëmije vjeç, por më të shkurtra se ato të një të rrituri. Skeleti i adoleshentëve është ende në rritje por jo plotësisht i rritur.</p>			

<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve. Vlerësohen për aftësitë e nxënësve në ndërtimin e grafikëve
<b>Detyra:</b> Punë kërkimore: <i>Cili pjesëtar i familjes ka kockat më të gjatë?</i>
<b>Shënim:</b> Për detyrën e shtëpisë udhëzohen nxënësit se do të vepronjë si në klasë. Fillimisht do të përcaktojnë personat tek të cilët do të bëhen matjet. Më pas për secilin prej tyre do të përcaktohen parashikimet. Do të kryhen matjet dhe hedhja e të dhënave në tabelë dhe grafik me shtylla. Më pas do të kryhet krahasim i të dhënave për të dalë në përfundime. Këto përfundime do të krahasohen me parashikimet e bëra nga vetë ata.

## Ora 4

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 4</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Përse na nevojitet skeleti?		<b>Situata e të nxënët:</b> Kockat e kujt janë më të gjata?	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b> Tregon se skeleti ndërtohet nga kocka të cilat te njeriu dhe disa kafshë rriten brenda trupit. Kryen hetime që provojnë fortësinë e kockave dhe thyeshmërinë e tyre. Emërton kockat kryesore në trupin e njeriut. Përshkruan se si kockat e skeletit rriten, mbështesin dhe mbrojnë trupin. Formulon pyetje dhe heton përgjigjet për rritjen dhe skeletin. Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale. Mbledh dhe të paraqet të dhënat. Nxjerr përfundime në bazë të të dhënave.		<b>Fjalë kyçe:</b> frakturë (thyerje), rreze X, jorruazorë (jovertebrorë)	
<b>Burimet e mjete:</b> Metër shirit, vizore, lapsa		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Prezantim i veprimtarisë kërkimore:</b> Nxënësit paraqesin përfundimet e dala gjatë kërkimit të kryer me familjarët e tyre rreth: <i>Cili prej pjesëtarëve të familjes kishte kockat më të gjatë?</i> Për prezantimin nxënësit orientohen të tregojnë parashikimet e tyre, veprimtaritë që kryen, tabelën e të dhënave dhe grafikun me shtylla. Paraqitja e përfundimeve dhe krahasimi me parashikimet. <b>Bisedë:</b> <i>Përse njerëzit kur lëvizin me motor ose biçikletë duhet të përdorin kaskë? Përse shërben ajo? Çfarë rreziku ka nëse nuk përdoret?</i> Sqarohen nxënësit se ashtu si kaska edhe kafa e kokës ka rol mbrojtës, ajo mbron trurin. Drejtohet pyetja: <i>Cilat organe të shqisave mbron kafa?</i> Sqarohet se kafa mbron trurin i cili komandon shqisat. Së bashku me gjithë klasën përsëriten shqisat. Rishikohet figura e skeletit të njeriut. <i>Nxënësit diskutojnë për të gjetur se cilat kocka të tjera (pjesë e skeletit) mbron organet e trupit? Çfarë mund të thoni për kafazin e kraharorit? Si i mbron ai zemrën dhe mushkëritë tona?</i>			

<p><b>Lexim i drejtuar:</b> Para se të lexohet paragrafi i parë i fq. 11 të librit drejtohen pyetjet për të marrë një mendim paraprak të nxënësve: <i>Çfarë mendoni se ndodh kur një kockë thyhet? Si e kuptohet kjo? A mund të rregullohet përsëri një kockë e thyer?</i> Lexohet paragrafi dhe rijepen përgjigjet e pyetjeve të bëra më parë, tashmë bazuar në informacionin e marrë në libër. Demonstrohen pamje të kockave në foto me rreze X (grafi e kockave). Drejtohen pyetjet për paragrafët në vazhdim: <i>Përse shërben skeleti? A kanë të gjitha kafshët skelet?</i> Pas përgjigjeve paraprake lexohen paragrafët në vazhdim dhe diskutohet rreth informacionit në to. Rikujtohen nxënësit se skeleti na nevojitet për të mbajtur trupin. Ftohen nxënësit të shikojnë figurën e krimbave në fq. 11 të librit. Diskutohet për mënyrën se si disa jorruazorë, si krimbat ose gjarpërinjtë, arrijnë të mbajnë trupin e tyre.</p> <p><b>Diskutim në dyshe:</b> <i>Çfarë mund t'i ndodhë një fëmije nëse skeleti i tij nuk rritet? Pse kockat e thyera ngjiten përsëri? Pse kocka e një fëmije ngjitet më shpejt sesa ajo e një të rrituri?</i> Përgjigjet e dysheve informacioni i dhënë tek “<i>Mësuam se</i>” diskutohen me të gjithë klasën.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 11-12 të Fletore pune</p>	<p><b>Refleksion:</b> Si kujdesesh për kockat e trupit tënd?</p>
<p><i>Shënim:</i></p>	

## Ora 5

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<p><b>Tema mësimore:</b> Skeleti dhe lëvizja</p>		<p><b>Situata e të nxënësve:</b> Si punojnë muskujt?</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas temës: Tregon se kafshët me skelet kanë muskuj që lidhen me kockat. Tregon se një muskul duhet të tkurret që të shkaktojë lëvizjen e kockës. Njeh disa grupe muskujsh dhe funksionet e tyre. Tregon se muskujt punojnë në çifte ata tkurren dhe lëshohen duke krijuar lëvizje. Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> muskuj, mblidhet, lëshohet</p>	
<p><b>Burime dhe mjete:</b> dy llastiqe të holla, 5 pineska, dy shirita kartoni</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art, Matematikë, Edukim Fizik</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Lojë:</b> Të drejtuar nga mësuesja nxënësit do të zhvillojnë manipulim lëvizjesh të krahëve, trupit, këmbëve. Disa nga lëvizjet e sugjeruara janë: të përkulen, të rrotullojnë trupin, të ecin, të kapin lapsin etj. Drejtohet pyetja: <i>Përse na nevojiten muskujt?</i> Nxiten nxënësit të japin mendimet e tyre. <b>Shpjegim i përparuar:</b> Shpjegohet se muskujt punojnë sa herë që ne lëvizim. Ftohen nxënësit të vërejnë me kujdes se çfarë ndodh me krahun e sipërm kur mbledhim krahët nga anash drejt gjoksit; muskujt fryhen dhe bëhen me gunga. Kur ne ngremë krahun lart, bicepsët (muskujt dykrerësh që ndodhen në pjesën e përparme të krahut) tkurren, ndërkohë që muskuli në anën e pasme të krahut, tricepsi (muskuli trikrerësh) lëshohet. Pra, dy muskujt punojnë së bashku për të kontrolluar lëvizjen e krahut. Kur ulim krahun ndodh e kundërta, bicepsi lëshohet, ndërsa tricepsi tkurret.</p>			

<p>Theksohet se muskujt punojnë në çift, por vetëm në tërheqje. Muskujt nuk mund të shtyjnë. Shpesh, për të krijuar një lëvizje të vetme duhet të punojnë disa muskuj së bashku. P. sh. për të qeshur nevojiten 17 muskuj, dhe për të rrudhur vetullat nevojiten 43 të tillë.</p> <p><b>Lojë:</b> Gjeni çfarë tregon. Një nxënës del para klasës dhe më vete i tregohet lloji i mimikës që duhet të bëjë. Nxënësit e tjerë gjejnë çfarë tregon ajo mimikë. Pas gjetjes të gjithë nxënësit i japin fytyrës atë mimikë. Kërkohej që për çdo shprehje të ndiejnë lëvizjet e fytyrës. <i>Cilët janë muskujt e sforcuar (tkurrur) dhe cilët janë ata që zbuten (lëshohen)?</i> Drejtohen nxënësve të bëjnë mimika që paraqesin gjendje të ndryshme emocionale si: nervozizëm, trishtim, habi, lumturi, etj.</p> <p>Ftohen nxënësit të studiojnë së bashku dhe të zbulojnë se si na ndihmojnë muskujt për të lëvizur dhe nëpërmjet figurave të fq.12 të librit dhe se si punojnë muskujt.</p> <p><b>Veprimtari:</b> Ndiqen hapat e ndërimit të një krahu me parakrahun me ndihmën e dy llastiqeve të holla, 5 pineskave dhe dy shiritave kartoni. Nxënësit do të organizohen në dyshe. Gjatë punës udhëzohen dhe ndihmohen. Në fund secila dyshe paraqet modelin e muskujve të krahut dhe provojnë të bëjnë të njëjtat lëvizje dhe me krahun e tyre. Në dërrasë janë shkruar pyetjet për të cilat përgatisin përgjigjet dyshet: <i>Me çfarë ju ngjajnë dy llastiqet rreth pineskave? Cili është llastiku më i gjatë? Po më i shkurtër? Çfarë ndodh me krahun prej kartoni kur tërheqim llastikun e gjatë? Çfarë ndodh me krahun prej kartoni kur tërheqim llastikun e shkurtër? Çfarë ndodh në të njëjtën kohë me të dy llastiqet kur krahu lëviz?</i></p> <p>Theksohet se: Muskujt nuk mund të shtyjnë. Ata vetëm tërheqin kockat duke mundësuar lëvizjen. Kjo është arsyeja pse muskujt veprojnë dyshe. Njëri nga muskujt e tërheq kockën në një drejtim ndërsa tjetri e të tërheq atë në drejtim të kundërt.</p> <p><i>Ç'mund të thoni për zemrën si një muskul që nuk çlodhet asnjëherë? Ç'do të thotë nuk çlodhet? Si mendoni, pse zemra nuk çlodhet asnjëherë?</i></p> <p>Zemra nuk përfshihet në lëvizjet e trupit. Për këtë arsye nuk është e nevojshme që ajo të jetë e lidhur me skeletin. Lexohen së bashku përfundimet në rubrikën “Mësuam se”.</p> <p><i>Shkrim i shpejtë:</i> Nxënësit nëpërmjet shkrimit të shpejtë do të shpjegojnë se si dy llastiqet veprojnë në mënyrë të ngjashme me muskujt për të ngritur dhe ulur krahun.</p> <p><b>Lojë:</b> Nxënësit në dyshe provojnë forcën e muskujve të tyre të krahut.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësimi kryhet nëpërmjet shkrimit të shpejtë ( përshtkrimi i funksionimit të muskujve të krahut) si dhe nëpërmjet medimeve që japin gjatë diskutimeve në klasë.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 13 të Fletores së punës</p>	<p><b>Refleksion:</b> Kujto disa veprime që bën dhe gjej muskujt që përdor.</p>
<p><i>Shënim:</i> Në varësi të kohës loja “Provojmë forcën e muskujve” mund të kryhet dhe gjatë një ore të Edukimit fizik.</p>	

## Ora 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Drogat dhe ilaçet		<b>Situata e të nxënit:</b> Përdorimi i ilaçeve	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas temës:            Shpjegon rolin e drogave si ilaçe.            Kupton se barnat parandalojnë, kurojnë ose lehtësojnë simptomat e sëmundjeve.            Zbulon mënyrat se si përdoren medikamentet.            Planifikon një hulumtim dhe të gjejnë një mënyrë për mbledhjen e provave.            Propozon disa forma për të paraqitur rezultatet.            Dallon prirjet apo modelet e thjeshta tek rezultatet si dhe i shpjegon ato.</p>		<p>Fjalë kyçe: ilaç, parandalim, injeksion</p>	
<b>Burime dhe mjete:</b> paketime të ndryshme ilaçesh ose foto të tyre, foto të cilat tregojnë mënyra të marrjes së ilaçeve		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe)	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>Bisedë:</b> Pyeten nxënësit se çfarë dinë për drogat? A do t'i përdornin ato? Nëse jo, cila është arsyeja? Më pas pyeten nëse ka nxënës që përdorin ndonjë lloj medikamenti/ilaçi.  <b>Shpjegim i përparuar:</b> Shpjegohet dallimi midis drogës dhe ilaçeve. Drogat ndahen në ilaçe që ndihmojnë në përmirësimin e shëndetit dhe në droga të tjera, të cilat dëmtojnë trupin e njeriut. P.sh. duhani është një drogë në formën e cigares i cili e dëmton shëndetin. Kështu, cigaret përbëhen nga duhani, i cili është një lloj droge. Kur thithet duhani digjet, duke çliruar kështu tym që përmban kimikate të dëmshme. Këto substanca mund të dëmtojnë mushkëritë dhe vështirësuar kështu frymëmarrjen. Njerëzit që pijnë duhan preken më shpesh nga sëmundjet e krahavorit, siç është bronkiti. Substancat kimike të pranishme në tymin e duhanit shkaktojnë gjithashtu sëmundje të rënda.            Tregohen disa lloje ilaçesh. Sqarohen nxënësit se ato mund të jenë të formave të ndryshme, si përzierje, tableta, pluhuri, kremi ose aparaturë avulli. Theksohet se ato përdoren për përmirësimin e shëndetit. Ftohen nxënësit të shohin në fq. 14 të librit figurat ku tregohen mënyra të ndryshme të përdorimit të ilaçeve dhe diskutohet në lidhje me to: <i>Çfarë lloj ilaçesh përdorin nxënësit? Pse u nevojiten atyre ato? Në çfarë mënyrash po i marrin?</i> Sqarohet se aparatet e avullit shërbejnë për të spërkatur një medikament në rrugët e frymëmarrjes për t'i liruar ato, në mënyrë që mushkëritë të mbushen me sa më shumë ajër. Gjatë diskutimit, nxënësit mund të japin dhe shembuj personalë mbi mjekimet që marrin, mënyrat si i marrin dhe se si ndikojnë ato në shëndetin e tyre.            Gjithashtu diskutohet mbi mënyrën se si na ndihmojnë ilaçet e ndryshme dhe format si përdoren ato.</p>			

<p><b>Organizimi i projektit:</b> I bëhet e ditur nxënësve se do të zhvillojnë një projekt në lidhje ilaçet dhe kujdesin për përdorimin e tyre. Fillimisht ata duhet të mendojnë për mbledhjen e provave dhe mënyrën e paraqitjes së tyre. Shpjegohet se një mënyrë për të mbledhur të dhëna nga njerëzit është duke kryer anketime, ku të përdorim pyetje në lidhje me atë çka duan të mësojnë. Për të kryer këtë hulumtim nxënësve mund t’u nevojitet afërsisht një javë.</p> <p><b>Harta e mendjes:</b> Në tabak letre shkruhet “<i>Ilaçet dhe kujdesi për përdorimin e tyre</i>”. Ftohen nxënësit të tregojnë se çfarë dinë për temën. Gjatë shkrimit, mendimet e nxënësve klasifikohen duke formuar “hartën e mendjes”. Bazuar në mendimet e dhëna nga gjithë nxënësit fillimisht hartohen pyetje të cilat mund të shërbejnë për intervistat dhe anketimin që do të zhvillojnë në projekt. Ndahen nxënësit në grupe dhe diskutojnë për anketimin që do të organizojnë, pyetjet që duhet të bëjnë në lidhje me të dhe personat që do jenë pjesë e anketimit.</p> <p><b>Pyetje-përgjigje:</b> Ftohen nxënësit të zbulojnë përgjigjet e pyetjeve të dhëna në rubrikën “<i>Pyetje</i>”. Më pas pyetje përgjigje diskutohet me gjithë klasën.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Gjatë diskutimit të pyetjeve 1 dhe 3 nxënësit do të bëjnë një vetëvlerësim duke kontrolluar përgjigjet e veta të dhëna më parë.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq.14 të Fletore Pune</p>	<p><b>Refleksion:</b> Kur je sëmurur, përdorimi i cilit ilaç të ka lënë më shumë mbresë?</p>
<p><b>Shënim:</b> Gjatë trajtimit të kësaj teme tregohet kujdes ndaj nxënësve që mund të kenë një ndjeshmëri të veçantë ndaj temës për arsye të problemeve të tyre të mundshme shëndetësore. - Punimi i projektit të nisur këtë orë do të vazhdojë në orët në vijim.</p>	

## Ora 7

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Si funksionojnë ilaçet		<b>Situata e të nxënësve:</b> Përdorimi i ilaçeve	
<p><b>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</b> Shpjegon rolin e drogave si ilaçe. Kupton se ilaçet veprojnë duke vrarë mikrobet ose zëvendësuar substancat që mungojnë në trup. Zbulon dhe të shkruan për metodat e përdorimit të sigurt të ilaçeve. Bën një parashikim lidhur me përdorimin e ilaçeve..</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> simptomë, temperaturë, mikrob, kurohem, recetë</p>	
<p><b>Burime dhe mjete:</b> paketime të ndryshme ilaçesh, recetë e shkruar nga mjeku</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Brainstorming:</b> <i>Si e kuptoni kur jeni sëmurë?</i> Shkruhen në dërrasë simptomat që do të përmendin nxënësit dhe më pas shpjegohet se simptomat janë shenja të një sëmundje. <i>Cilat janë arsyet që ne sëmurim?</i> Më pas mund të diskutohet për rolin e mikrobeve tek sëmundjet. Sqarohet se jo të gjitha sëmundjet shkaktohen nga mikrobet. Kur dikush ka diabet, trupi nuk arrin të prodhojë sasi të mjaftueshme të një substance të quajtur insulinë. Trupi ka nevojë për insulinë për të qenë i shëndetshëm. Ilaçet mund të zëvendësojnë substancat që mungojnë, si insulina.</p>			



**Lexim, rishikim në dyshe:** Ftohen nxënësit të lexojnë informacionin e dhënë në fq. 16 të librit. Për qartësi të mendimeve diskutimi i informacionit dhe figurave ribëhet me të gjithë klasën. Kështu është e rëndësishme të sqarohen nxënësit se shumë njerëz besojnë se antibiotikët, si penicilina, mund të kurojnë çdo infeksion. *Antibiotikët kurojnë vetëm infeksionet bakteriale dhe jo infeksionet virale (nga viruset) si: sekrecionet e hundëve, të ftohtin apo gripin, shumicën e koll, bronshitin apo fytin e pezmatuar, që nuk shkaktohen nga bakteri i Streptokokut. Marrja e antibiotikëve për sëmundjet virale nuk do ta kurojë infeksionin, të parandalojë përhapjen e tij tek të tjerët apo të na ndihmojë të ndihemi më mirë.*

*Njerëzit mendojnë se ndërprerja e mjekimit me antibiotik sapo dikush fillon të ndihet më mirë është diçka e drejtë. Kjo mund të jetë e rrezikshme sepse organizmat shkaktare të sëmundjes nuk janë eliminuar plotësisht. Mikrobet bëhen edhe më të fuqishëm ndaj ilaçit, që do të thotë se ai nuk do të ketë më efekt.*

*Një tjetër besim i përhapur është se barnat natyrale apo bimore janë më të sigurta se ilaçet e rekomanduara. Barnat natyrale dhe bimore nuk janë të provuara klinikisht, sikurse janë ilaçet e tjera. Shumë prej këtyre barnave mund të shkaktojnë efekte të padëshiruara në rast se merren njëkohësisht me mjekime të tjera. Nëse merrni ilaçe të përshkruara, ju duhet gjithnjë të flisni me mjekun tuaj para se të merrni një mjekim tjetër.*

**Lojë në role:** Në veprimtarinë e paraqitur fëmijët japin mendime rreth kujdesit për marrjen e ilaçeve. I jepet katër nxënësve secili rol dhe ata lexojnë mendimet e personazheve në libër.

**Vija e vlerës:** Cili prej mendimeve të fëmijëve ishte i drejtë, cili i gabuar? Nxënësit organizojnë mendimet dhe përcaktojnë qëndrimet e tyre duke i argumentuar ato.

*Udhëzohen nxënësit se pjesë e projektit të filluar një orë më parë “Ilaçet dhe kujdesit për përdorimin e tyre” do të vazhdojë të plotësohet dhe me udhëzime për marrjen e ilaçeve në mënyrë të sigurt.*

**Vlerësimi:** Gjatë diskutimit të pyetjeve 1 dhe 3 nxënësit do të bëjnë një vetëvlerësim duke kontrolluar përgjigjet e veta të dhëna më parë.

**Detyra:** Punimi i fq.15 të Fletore Pune

Refleksion: Kur je sëmurë, cili është personi që të rekomandon ilaçet?

**Shënim:** Në varësi të kohës dhe dëshirës së nxënësve “Loja në role” nëpërmjet leximit mund të përsëritet dhe nga grupe katërshe nxënësish të tjerë.

-Porositen nxënësit për marrjen e mjeteve të nevojshme për vazhdimin e punimit të projektit në klasë

-Për zhvillimin e këtyre temave mund të ftohet një mjek i cili t’u flasë nxënësve për sëmundjet dhe rëndësinë e përdorimit të kujdesshëm të ilaçeve.

## Ora 8

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Projekti “Ilaçet dhe kujdesit për përdorimin e tyre”		<b>Situata e të nxënit:</b> Si përdoren ilaçet.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Shpjegon rolin e drogave si ilaçe. Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfuara nga vëzhgimet individuale.		<b>Fjalë kyçe:</b> ilaç, parandalim, simptomë, temperaturë, mikrob, kurohem, recetë	
<b>Burime dhe mjete:</b> etiketa barnash, pompa për astmatikë, aparat matës i glukozës në gjak		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Diskutim:</b> Ftohen nxënësit që në dyshe të prezantojnë përfundimet e punimeve të fq.14-15 të fletores së punës. Më pas me gjithë klasën prezantohen me dëshirë nga nxënësit përfundimet e ushtrimit 1 fq. 14 dhe ushtrimit 2 fq. 15. <b>Projekt:</b> Zhvillohet bisedë me nxënësit për të prezantuar qëllimin dhe pritshmëritë e projektit. Ju bëhet e ditur se nëpërmjet këtij projekti ata do të tregojnë mbi njohuritë e marra mbi kujdesin ndaj përdorimit të ilaçeve si dhe mbi aftësitë për të mbledhur, analizuar dhe përpunuar informacionin e marrë në mënyrë që të mbajnë qëndrime dhe t’i prezantojnë ato. Të organizuar në grupe nxënësit udhëzohen mbi mënyrën e organizimit të punës. Kështu udhëzohen të rishikojnë llojet e pyetjeve që do të përdorin për të intervistuar të afërmit në lidhje me përdorimin e ilaçeve. Sugjerohet që ata të përqendrohen në llojin e ilaçit, mënyrën e përdorimit, arsyen shëndetësore që i çon në përdorimin e ilaçit dhe kush ia ka sugjeruar përdorimin e këtij ilaçi. Përcaktimi i organizuesve grafikë me anë të të cilëve do të prezantojnë të dhënat e pyetësorit. Rikujtohet se pjesë e projektit gjithashtu do të jetë dhe prezantimi i udhëzimeve për marrjen e ilaçeve në mënyrë të sigurt. Kështu nxënësit duhet të përmbledhin dhe shprehin në forma të ndryshme (me shkrim dhe me vizatim) udhëzimet që kanë përzgjedhur. <b>Punë individuale dhe në grup</b> për punimin e projektit. Gjatë punës së grupeve mësuesja mbështet dhe sugjeron punën e tyre.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen përgjigjet individuale në lidhje me plotësimin e ushtrimeve dhe mendimet që japin gjatë diskutimeve në punën në grup.			
<b>Detyra:</b> Punimi i detyrave si pjesëtar i grupit në projekt.			
<b>Shënim:</b> Puna me projektin dhe prezantimin e tij do të vazhdojë dhe në orën tjetër.			

## Ora 9

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Projekti “Ilaçet dhe kujdesit për përdorimin e tyre”		<b>Situata e të nxënit:</b> Si përdoren ilaçet.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Shpjegon rolin e drogave si ilaçe. Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfuara nga vëzhgimet individuale. Mban qëndrime ndaj përfundimeve të dala nga vëzhgimet e kryera		<b>Fjalë kyçe:</b> ilaç, parandalim, simptomë, temperaturë, mikrob, kurohem, recetë etj.	
<b>Burime dhe mjete:</b> etiketa barnash, pompa për astmatikë, aparat matës i glukozës në gjak.		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Bisedë:</b> Rikujtohen qëllimi dhe pritshmëritë e projektit. Nëpërmjet këtij projekti ata do të tregojnë njohuritë e marra mbi kujdesin ndaj përdorimit të ilaçeve si dhe aftësitë për të mbledhur, analizuar dhe përpunuar informacionin e marrë në mënyrë që të mbajnë qëndrime dhe t’i prezantojnë ato. Këshillohen nxënësit të grupojnë dhe selekcionojnë informacionin e marrë nga intervistat, orientuar në këto të dhëna: Numri i të intervistuarve; Numri i personave që përdorin gjatë kësaj kohe ilaçe; Llojet e ilaçeve që përdoren dhe mënyrat se si merren ato; Numri i personave që marrin ilaçet si rrjedhim i këshillës së mjekut; Përfundime në lidhje me to p.sh. duke i dhënë përgjigje pyetjeve: A është i nevojshëm përdorimi i ilaçeve? Kush duhet të këshillojë marrjen e ilaçeve? Cilat janë mënyrat më të sigurta për marrjen e tyre? <b>Projekt:</b> Vazhdimi i punimeve të projektit në grupe. Jepen udhëzime mbi përgatitjen e grupeve për të bërë prezantimet e projektit. <b>Prezantime:</b> Secili grup me radhë do të përfaqësohet me: - Një përmbledhje përfundimtare të intervistave - Gjetjet dhe përfundimet e dala - Këshilla për marrjen e sigurt të ilaçeve. <b>Pyetje - përgjigje diskutime e vlerësime</b> në lidhje me prezantimet e projekteve dhe kontributin e pjesëtarëve të grupit.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësim i projektit dhe kontributit në realizimin e tij.			
Detyra:		<b>Refleksion:</b> Si u ndjeve gjatë zhvillimit të intervistave?	
<b>Shënim:</b> Në varësi të kohës prezantimi i projekteve mund të vazhdojë dhe një pjesë të orës në vijim.			

## Ora 10

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj.		<b>Situata e të nxënit:</b> Unë di.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Rishikon përmbajtjen e të gjitha mësimeve dhe veprimtarive të punuara. Prezanton me forma të ndryshme njohuritë e marra dhe aftësitë e qëndrimet e fituara.		<b>Fjalë kyçe:</b> skelet, kockë, kafkë, brinjë, rruazë, kockat e legenit, kockat e kafkës, kockat e kërcirit, muskuj, ilaçe etj.	
<b>Burime dhe mjete:</b> enciklopedi, fleta aktiviteti		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i><b>Parashikim me terma paraprakë:</b></i> Duke përdorur këto fjalë: skelet, çifte muskujsh, lëviz, mbështet, rriten; nxënësit do të bëjnë një përshkrim të shkurtër mbi njohuritë e marra gjatë këtyre temave. Lexim me dëshirë i shkrimeve të nxënësve. <i><b>Punë e pavarur:</b></i> Plotësim i rubrikave të dhëna në fq. 18-19 në libër. Krahasim dhe diskutim në dyshe për plotësimin e tyre. Përfaqësues të grupeve dyshe prezantojnë përfundimet për secilën rubrikë. Plotësim në dyshe i fletës së aktivitetit ku analizohen të dhënat mbi duhanpirjen. <i><b>Prezantime:</b></i> Me dëshirë, dyshet prezantojnë përfundimet e analizës dhe japin argumentet e tyre përse duhani si drogë mund t'i dëmtojë njerëzit. Diskutohen propozimet mbi metodat që mund të përdorë shteti por edhe metoda që mund të përdoren brenda në familje për të ulur numrin e duhanpirësve.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësimi në punimin e rubrikave të librit, argumentimin e mendimeve dhe qëndrimeve që mbajnë.			
<b>Detyra:</b> Punimi i fq.16 të Fletore Pune		<b>Refleksion:</b> Trego si u ndjeve gjatë rikujtimit dhe diskutimit të këtyre temave.	
Shënim:			

## KAPITULLI 2

### Gjallesat dhe mjedisi

#### Ora 1

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Shpendë interesantë		<b>Situata e të nxënit:</b> Duke vëzhguar zogjtë.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas temës:            Hulumton se si kafshë të ndryshme jetojnë në habitate të ndryshme, dhe se si ato u janë përshtatur kushteve ku jetojnë.            Mbledh prova në rrethana të ndryshme.            Kryen vëzhgimet dhe krahasimet e duhura në rrethana të ndryshme.            Kryen kërkime për bimë dhe kafshë që jetojnë në habitate të ndryshme.            Diskuton për tipare me të cilat ato përshtaten me mjedisin ku jetojnë.</p>		Fjalë kyçe: përshtatet, habitat (vendbanim)	
<b>Burimet e mjetet:</b> laps, letër		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Gjeografi, Edukim fizik	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>Harta e mendimit:</b> Drejtohet pyetja: <b>Për çfarë kanë nevojë kafshët që të jetojnë?</b>            Nëpërmjet përgjigjeve të nxënësve ndërtohet harta e mendimit, ku përcaktohen nevojat për ujë, ajër, ushqim, ngrohtësi dhe një vend për të jetuar.  <b>Shikim i një dokumentari për zogj:</b> Orientohen nxënësit që gjatë shikimit të dokumentarit të dallojnë varësinë e gjallesave ndaj habitatit të tyre. Pas shikimit të dokumentarit biseda e drejtuar nga mësuesja përqendrohet në nxitjen e nxënësve të dallojnë se si shpendët arrijnë të sigurojnë ujin, ajrin, ushqimin, ngrohtësinë në vendbanimet e tyre.  <b>Ditari tripjesësh:</b> Ftohen nxënësit të studiojnë karakteristikat trupore të disa kafshëve dhe përshtatjen e këtyre karakteristikave me nevojat për të jetuar në habitatet. (Shpendët përshkruan në fq. 20 të librit). Të dhënat që nxënësit nxjerrin do t'i organizojnë në një ditar tripjesësh:</p>			
<b>Emri i shpendit</b>	<b>Karakteristikat trupore</b>	<b>Karakteristikat e vendbanimit/habitatit</b>	

<p>Nxënësit i diskutojnë në dyshe përfundimet e dala nga organizimi në ditarin tripjesësh.</p> <p><b>Diskutim:</b> Bazuar në analizën e të dhënave të bëra nëpërmjet ditarit tripjesësh, zhvillohet diskutim me gjithë klasën se si zogjtë i janë përshtatur habitatit ku jetojnë. Kështu, fajkonjtë kanë shikim shumë të mprehtë, që do të thotë se ata arrijnë ta shohin prenë e tyre në tokë edhe kur janë në fluturim. Ata kanë gjithashtu kthetra të fuqishme për ta kapur prenë dhe arrijnë të fluturojnë aq shpejt sa mund ta arrijnë lehtësisht shpejtësinë e presë së tyre në tokë. Rosat dhe shpendët e tjerë të ujit kanë këmbë me membrana që u mundësojnë atyre të notojnë në ujë. Zogjtë kanë gjithashtu sqepa me forma të ndryshme, që u përshtaten llojeve të ushqimit që ata hanë.</p> <p>Drejtohen pyetjet: <i>Pse shpendët kanë nevojë për habitatin e tyre? A është e nevojshme përshtatja me habitatin?</i></p> <p>Nxënësit mund të tregojnë për përvojat e tyre me kur kanë pasur raste të vëzhgojnë shpendë të ndryshëm.</p>
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë dhe diskutimeve.</p>
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 17 të Fletores së punës</p> <p>Gjatë ditëve në vazhdim nxënësit do të vrojtojnë rreth shkollës për të gjetur vende ku mbledhen zogjtë.</p>

## Ora 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Shpendë interesantë		<b>Situata e të nxënit:</b> Duke vëzhguar zogjtë.	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <p>Kryen kërkime për bimë dhe kafshë që jetojnë në habitate të ndryshme.</p> <p>Hulumton se si kafshë të ndryshme jetojnë në habitate të ndryshme, dhe se si ato u janë përshtatur kushteve ku jetojnë.</p> <p>Mbledh prova në rrethana të ndryshme.</p> <p>Kryen vëzhgimet dhe krahasimet e duhura në rrethana të ndryshme.</p> <p>Diskuton për tipare me të cilat ato përshtaten me mjedisin ku jetojnë.</p> <p>Vlerëson burime të ndryshme informacioni që mbështesin kërkimin e tij/saj në habitate lokale.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> zogj, habitat (vendbanim), tipare</p>	
<p><b>Burimet e mjetet:</b> laps, letër, pak ujë dhe ushqim për të afruar zogjtë</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Gjeografi, Edukim fizik</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><b>Bisedë:</b> Pyeten nxënësit nëse gjatë ditëve të javës kanë pasur mundësi të gjejnë vende rreth shkollës ku grumbullohen zogj. U bëhet e ditur nxënësve se do të dalin të vëzhgojnë zogjtë pranë shkollës. Diskutohet rreth pyetjeve përgatitore: <i>Ku do ta bëni vëzhgimin? Çfarë mund t'ju duhet me vete? A do të jetë e nevojshme t'i afroni zogjtë në vendin e vëzhgimit? Si mund ta realizoni këtë? Sa kohë mund t'ju duhet?</i></p>			

**Kërkim shkencor:** Vëzhgimi i zogjve. Të organizuar në grupe nxënësit do të shkojnë në vendin ku mbledhen zogjtë. Udhëzohen të ruajnë qetësinë për të mos i trembur zogjtë. Nxënësit do të hedhin në heshtje të dhënat e vëzhgimit në fletën e aktivitetit 2.1 ose në fletore. Të dhënat do të përqendrohen në përcaktimin e vendit ku bëhet vëzhgimi dhe përshkrimi i tipareve të zogjve që vijnë në të. Këto tipare mund të jenë: ngjyra, përmasa, forma, mënyra e jetesës, ushqimi etj. elementët të cilët i tërheqin vëmendjen nxënësve në lidhje me zogjtë dhe vendin ku po studiohen. Pas mbledhjes së të dhënave në letër nxënësit i diskutojnë në grup për të dalë në përfundime rreth lidhjes së habitatit dhe përshtatjes së zogjve me habitatin e tyre.

**Përfundime:** Drejtohet pyetja: *Si i janë përshtatur zogjtë habitatit të tyre?*

Me radhë, secili përfaqësues grupi prezanton të dhënat e mbledhura dhe përfundimet e dala.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit gjatë procesit të kërkimit: A mund të flasim nxënësit për zogjtë dhe mjediset ku ata jetojnë? A arrijnë ata të dallojnë format në të cilat këta zogj u përshtatur kushteve të mjedisit ku jetojnë? Vlerësoni aftësitë e nxënësve në kërkimin shkencor me anë të tabelës së mëposhtme:

A mbledhin prova nxënësit?

A kryejnë ata vëzhgimet e duhura?

A kryejnë ata krahasimet e duhura?

**Detyra:** Punimi i fletës së aktivitetit 2.1 b

**Refleksion:** Si u ndjeve gjatë kryerjes së kërkimit shkencor?

**Shënim:** Në varësi të kohës, për të bërë të mundur realizimin e kërkimit shkencor, kjo orë mund të bashkohet dhe me orë të kurrikulës me zgjedhje.

### Ora 3

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Një habitat për kërmijtë		<b>Situata e të nxënësve:</b> Çfarë habitatit pëlqejnë kërmijtë?	
<p><b>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</b> Kryen kërkime për bimë dhe kafshë që jetojnë në habitate të ndryshme. Diskuton për tipare me të cilat ato përshtaten me mjedisin ku jetojnë. Vlerëson burime të ndryshme informacioni që mbështesin kërkimin e tij/saj në habitate lokale.</p>		<b>Fjalë kyçe:</b> tentakulë, mjedisi përreth	
<b>Burimet e mjetet:</b> letër kalk, kërmill, foto kërmijsh në habitatin e tyre		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe)	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>			
<b>Brainstorming:</b> <i>A keni parë ndonjëherë kërmij? Ku i keni parë? Si janë ata? Ç'pjesë e trupit të tyre ju ka bërë përshtypje? Me çfarë ushqehen ata?</i>			

<p>Pas bisedës me nxënësit ku ata kanë mundësi të tregojnë rreth situatave nga jeta kur kanë parë kërmij, ofrohet shikimi fotove dhe pjesëve filmike që tregojnë për kërmijtë.</p> <p><b>Vëzhgim:</b> Të organizuar në grupe ftohen nxënësit të shohin kërmijtë e sjellë në klasë. Gjatë vëzhgimit të kërmijve nxënësit udhëzohen të dallojnë sytë, lëkurën, guaskën dhe bishtin e kërmillit. Të dallojnë antenat me të cilat kërmijtë edhe mund të nuhasin. Vendoset kërmilli në një letër kalku dhe vëzhgohet si lëviz për të dalluar këmbët e kërmillit. Ftohen nxënësit të përshkruajnë veprimet e muskujve të këmbëve që e vënë në lëvizje kërmillin.</p> <p><b>Lexim i drejtuar:</b> Njëpërmjet leximit të drejtuar punohet informacioni i dhënë në fq. 22 të librit. Analizohen pjesët e trupit të kërmillit të përshkruara në informacion, duke i krahasuar me ato që panë në realitet tek kërmilli. <i>Diskutohet se me se ushqehen kërmijtë? Si arrijnë ata të ushqehen kur nuk kanë dhëmbë? Përse e kanë lëkurën e lagësht? Si e ruajnë veten kërmijtë në një ambient të thatë? Si e ndjejnë rrezikun?</i> Sqarohen nxënësit se kërmijtë janë shumë të ndjeshëm ndaj dridhjeve, kanë shikim të mprehtë dhe sapo ndjejnë rrezikun ata futen në guaskë. <i>Kush ushqehet me kërmijtë? Si mbrohen ata nga rreziqet? Cilat janë karakteristikat e shpendëve që përdorin si ushqim kërmijtë?</i> Sugjerohet të mendojnë rreth formës së sqepit që kanë shpendët grabitqar në këtë rast.</p> <p><b>Diskutim:</b> <i>Çfarë bëjnë kërmijtë për t'u mbrojtur në një mjedis shumë të thatë? Si i është përshtatur kërmilli vendit ku jeton një zog që ushqehet me të? Nëse kërmijtë largohen nga habitati i tyre, çfarë do të ndodhte me zogjtë që ushqehen me ta?</i></p>
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet gjatë diskutimeve.</p>
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 18 të Fletores punës. Gjatë ditëve në vazhdim nxënësit do të vrojtojnë rreth shkollës ose shtëpisë së tyre, për të gjetur vende ku mund të ketë kërmij.</p>
<p><i>Shënim:</i> Në faqen <a href="http://www.snail-world.com/">http://www.snail-world.com/</a> do të gjeni një mori faktesh dhe informacionesh në lidhje me kërmijtë.</p>

## Ora 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Një habitat për kërmijtë		<b>Situata e të nxënit:</b> Çfarë habitati pëlqejnë kërmijtë?	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>                      Hulumton se si kafshë të ndryshme jetojnë në habitate të ndryshme, dhe se si ato u janë përshtatur kushteve ku jetojnë.                      Mbledh prova në rrethana të ndryshme.                      Kryen vëzhgimet dhe krahasimet e duhura në rrethana të ndryshme.                      Kryen kërkime për bimë dhe kafshë që jetojnë në habitate të ndryshme.                      Diskuton për tipare me të cilat ato përshtaten me mjedisin ku jetojnë.                      Vlerëson burime të ndryshme informacioni që mbështesin kërkimin e tij/saj në habitate lokale.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> mjedisi përreth, ndryshore, prirje, përsërit</p>	



<b>Burime e mjete:</b> një arkë, gjethe, gurë të thatë, rërë, shkopinj të vegjël, kërmij, letër laps	<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>	
<b>Diskutim për njohuritë paraprake:</b> në dyshe dhe më pas me të gjithë klasën prezantohen gjetjet e rubrikës së faqes 18 të Fletores së punës.	
<b>Kërkim shkencor:</b> <i>Vëzhgimi i kërmijve.</i> Demonstrohen para nxënësve habitatet e krijuara si në figurën e faqes 23 të librit. Udhëzohen nxënësit për procesin e vëzhgimit dhe mbledhjen e të dhënave. Diskutohet pyetja: <i>Si duhet të veprohet që provat të jenë të rregullta? Parashikoni çfarë vende do të pëlqejnë kërmijtë, vende të thata apo të lagështa?</i>	
Nxënësit duhet të parashikojnë se si të ndërtojnë një eksperiment të drejtë, si të kryejnë vëzhgime dhe t'i ruajnë ato, si dhe mënyrën si të paraqesin rezultatet. Ata mund t'i paraqesin rezultatet e tyre nëpër tabela. Nxënësit duhet gjithashtu t'i lidhin rezultatet e tyre me parashikimet dhe njohuritë e mëparshme për kërmijtë. Mund të nevojitet që nxënësit ta përsëritin eksperimentin deri në tri herë.	
Eksperimenti duhet përsëritur me disa kërmij, për arsye se jo gjithmonë në fillim kërmijtë bëjnë atë që ne e quajmë 'zgjedhje të drejtë'. Pyeten nxënësit: <i>Cila është arsyeja që jo gjithmonë në fillim kërmijtë bëjnë zgjedhjen e drejtë? A ndodh kjo për arsye të shikimit të kufizuar, apo sepse kërmijve u pëlqen të kërkohen/eksplorojnë për të gjetur ushqim? A ka ndonjë arsye tjetër?</i>	
Udhëzohen nxënësit se duhet të ndjekin çdo dy minuta vendndodhjen e kërmillit, dhe më pas t'i shënojnë rezultatet për të kuptuar parapëlqimin e kërmillit për njërin vend ose tjetrin. Nëse kërmijtë prirën të shpenzojnë më tepër kohë në një vend të caktuar, kjo do të jetë dhe prirja që dallohet tek rezultatet.	
Pas marrjes së rezultateve në dyshe nxënësit, për të prezantuar rezultatet dhe prirjet e zgjedhjeve të kërmijve, do të ndërtojnë tabela dhe grafikë me shtylla. Në boshtin X të paraqiten alternativat e vendeve të mundshme, dhe në boshtin Y të paraqitet sa herë është parë kërmilli në secilin vend.	
<b>Diskutim:</b> <i>Ku shkuan më shumë kërmij? Pse? Ku shkuan më pak kërmij? Pse?</i>	
Kërmijtë kanë guaskë me ngjyrë kafe ose të zezë. <i>Për çfarë i shërben ngjyra e guaskës kërmijve?</i>	
Jepni mendimin tuaj: Si të gjitha kafshët, edhe kërmijtë përshtaten në mënyra të ndryshme me vendin ku jetojnë. Kur kushtet e mjedisit ndryshojnë, kafshët mund të ndryshojnë mënyrën e jetesës.	
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë dhe diskutimeve.	
<b>Detyra:</b> Me dëshirë nxënësit do të hedhin të dhënat në fletën e aktivitetit 2.2 në rastin e gjetjes së një habitati kërmijsh.	<b>Refleksion:</b> Njihni kafshë të tjera që kanë ndryshuar mënyrën e jetesës kur kushtet e mjedisit ku jetonin ndryshuan?
<i>Shënim:</i>	

## Ora 5 dhe 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Kafshët në habitatet e tyre (2 orë)		<b>Situata e të nxënët:</b> Vëzhgojmë kafshët	
<p>Rezultatet e të nxënët sipas temës:  Hulumton se si kafshë të ndryshme jetojnë në habitate të ndryshme, dhe se si ato u janë përshtatur kushteve ku jetojnë.  mbledh prova në rrethana të ndryshme.  Kryen vëzhgimet dhe krahasimet e duhura në rrethana të ndryshme.  Kryen kërkime për bimë dhe kafshë që jetojnë në habitate të ndryshme.  Diskuton për tipare me të cilat ato përshtaten me mjedisin ku jetojnë.</p>		<b>Fjalë kyçe:</b> pyjor	
<b>Burimet e mjetet:</b> laps, letër, xham zmadhues		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Gjeografi, Edukim fizik, Art	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>Bisedë:</b> Nxënësit me dëshirë tregojnë gjetjet e tyre në lidhje me habitatet e kërmijve.  <b>Kllaster:</b> Shkruhet në dërrasë fjala “habitat” dhe ftohen nxënësit të tregojnë çfarë dinë për të. Theksohet se termi “habitat” nënkupton vendin ku kafsha jeton dhe gjen gjithçka i nevojitet. Për shembull, habitatit i një bletë mund të jetë një qoshe e vogël në kopsht, habitatit i një miu mund të jetë godina e shkollës dhe oborri i saj, habitatit i një bretkose mund të jetë një pellg, dhe ai i një shqiponje mund të jetë një hapësirë e gjerë prej mijëra kilometrash. Tërhiqet vëmendja në rastet kur mund të ngatërrojnë termin “habitat” me termin ‘shtëpi’. Shpesh fjala ‘shtëpi’ përdoret në vend të fjalës ‘habitat’, ndërsa në raste të tjera ajo i referohet strolullës apo folesë ku kafsha fle.  <b>Shpjegim i përparuar:</b> Paraqitet figura e faqes 24 të librit dhe bëhet e ditur se ai është një habitat pyjor. Diskutohet mbi çfarë paraqitet në të. Nxiten nxënësit të tregojnë tri kafshë të paraqitura në figurë të cilat ushqehen me bar dhe tri kafshë të cilat ushqehen me kafshë të tjera. Shpjegohet se si popullsitë e ndryshme brenda një habitatit kanë një ndikim të padiskutueshëm tek njëri-tjetri. Kjo ka të bëjë me idenë se kafshët janë të ndërvaruara midis tyre. Duke qenë se shumë zogj ushqehen me insekte, është e natyrshme të mendosh se sa më shumë insekte të ketë në kopsht aq më e madhe është dhe popullsia e zogjve përreth. Një tjetër shembull i vartësisë së ndërsjellë është dhe ai midis bretkosave dhe insekteve. Bretkosat kanë nevojë të ushqehen me insekte, por nga ana tjetër, insektet ndihmojnë në riciklimin e trupit të bretkosave të ngordhura.  Ka raste kur mund të mendohet se disa kafshë nuk kanë nevojë për një habitat të caktuar. P.sh. duket sikur pëllumbat mund të jetojnë gjithkund, prandaj dhe mendohet se atyre nuk u nevojitet një habitat i veçantë. Në të vërtetë, pëllumbat janë shpendë që përshtaten në mënyrë të përkryer në disa lloje habitatesh. Megjithatë, ata nuk mund të mbijetojnë në çdo lloj habitatit, siç mund të jenë shkretëtirat e ftohta apo mjediset nënujore.</p>			

U bëhet e ditur nxënësve se do të zhvillojnë një kërkim shkencor në lidhje me kafshët që jetojnë në vende të ndryshme të oborrit të shkollës. Nxënësit do të dalin jashtë dhe do të kërkojnë për shenja ose gjurmë kafshësh. Nxiten nxënësit të ngrenë pyetje të ndryshme lidhur me gjallesat dhe habitatet e tyre p.sh: *Cila është arsyeja që krimbat e tokës gjenden në këtë habitat? A gjejnë ushqim në këtë habitat? Me se ushqehen? Çfarë kafshësh të tjera jetojnë në po të njëjtin habitat? Si janë përshtatur ato?*

**Kërkim shkencor:** Të organizuar në grupe me nga katër, vetë nxënësit do të vëzhgojnë kafshët e zakonshme në vendin e tyre dhe habitatet ku ato jetojnë. Ata duhet të studiojnë me kujdes tokën dhe atë çfarë ka përmbi të, bimët e ndryshme ku bëjnë pjesë shkurret dhe pemët, për të kuptuar se çfarë habitatesh gjenden poshtë gjethëve, trungjeve, lëvoreve të pemëve apo poshtë gurëve. Nxënësit do të kryejnë kërkime në lidhje me ushqimin e kafshëve të ndryshme. Ata duhet të dinë se një ushqim i caktuar gjendet në një habitat të caktuar. Nxënësit do të studiojnë edhe kafshët e tjera që vërehen në habitatet në vend dhe të kuptojnë arsyen pse këto kafshë u janë përshtatur aq mirë këtyre habitateve. Nxënësit në këtë veprimtari krahasojnë tri habitate të ndryshme. Kjo është një mundësi për nxënësit që ata të mbledhin prova dhe të ngrenë hipoteza të cilat mund të vërtetohen. P.sh: *Ku ka më tepër krimba, poshtë një guri apo nën një trung peme?* Nxënësit do të kontrollojnë vëzhgimet dhe shënimet e tyre për të parë nëse ka ndonjë model të dukshëm.

*A është e vërtetë se në mjediset e freskëta dhe me shumë lagështirë ka më tepër gjallesa?* Nxënësit duhet t'i lidhin provat me njohuritë e tyre shkencore mbi nevojën e kafshëve për strehë dhe ushqim.

Gjatë kësaj veprimtarie nxënësit do t'i hedhin shënimet e tyre në fletën e aktivitetit 2.3, ku trajtohen krimbat e tokës. Për të plotësuar këtë fletë nxënësit do të mbledhin prova, të cilat mund t'u çojnë në hulumtime të mëtejshme në lidhje me nevojat e krimbave të tokës.

Gjatë kërkimit nxënësit diskutojnë në grupet e tyre dhe nxiten të ngrenë pyetje dhe t'u japin përgjigje nëpërmjet gjetjeve të tyre. Këto pyetje-përgjigje nxënësit brenda grupit do t'i mbajnë shënim dhe do të jenë pjesë e prezantimit të përfundimeve të kërkimit shkencor të grupit.

**Prezantim i përfundimeve:** Përfaqësues të grupit, duke u mbështetur në shënimet e mbledhura gjatë kërkimit, prezantojnë gjetjet e tyre. Tërhiqet vëmendja se është e rëndësishme të prezantohen pyetjet e ngritura dhe përgjigjet e gjetura nga kërkimi i kryer.

**Shkrim i shpejtë:** Nëpërmjet një shkrimi të shpejtë nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje mbi “Kafshët dhe habitatet e tyre”.

**Vlerësimi:** Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë kërkimore dhe diskutimeve.

Vlerësimi dhe vetëvlerësimi mund të përqendrohet në përgjigjet e këtyre pyetjeve: *A ishin pyetjet e duhura ato që nxënësit sugjerojnë në lidhje me kafshët? A i mbledhën ata provat e duhura? A u paraqitën rezultatet në mënyrën e duhur? Sa qartë i lidhën ata provat me njohuritë e tyre shkencore?*

Vlerësim individual mbi mendimet e dhëna në shkrimin e shpejtë.

**Detyra:** Punimi i faqes 19 të Fletores punës. Me dëshirë nxënësit mund të mbledhin të dhëna në enciklopedi, mbi kafshët e tyre të preferuara dhe habitatet e tyre.

**Refleksion:** Si do ta përmirësonit një habitat për kafshët që gjenden përreth?

**Shënim:** Grupet e nxënësve të cilët kanë vështirësi gjatë veprimtarisë së kërkimit shkencor, mund të shoqërohen dhe ndihmohen nga më të rritur.

## Ora 7

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Çelësi i përcaktimit		<b>Situata e të nxënët:</b> Gjej cila kafshë është!	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b> Përdor kode të thjeshta identifikimi. Kryen hulumtimet dhe krahasimet e duhura në rrethana të ndryshme. Bën lidhjen e provave me njohuritë dhe kuptimin shkencor në rrethana të ndryshme. Demonstron përdorimin e një çelësi të thjeshtë përcaktimi p.sh. për të identifikuar një specie të panjohur të gjetur në mjedisin përreth.			<b>Fjalë kyçe:</b> identifikoj, çelës përcaktimi
<b>Burimet e mjetet:</b> figura kafshësh			<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte, Matematikë
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <p><b>Lojë:</b> nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup ka disa figura me kafshë. Detyra e tyre është ti grupojnë kafshët duke zgjedhur një të përbashkët të tyre. Më pas secili grup tregon emrat e kafshëve që ka zgjedhur të fusë në një grup dhe karakteristikën/ tiparin e tyre të përbashkët. Nga grupet e kafshëve të formuara nxënësit mund të zgjedhin disa kafshë të cilat kanë dhe një të përbashkët tjetër dhe të formojnë një grup të ri. Përsëri grupet e nxënësve prezantojnë grupet e reja të kafshëve të formuara prej tyre dhe karakteristikën/tiparin e përbashkët.</p> <p><b>Lojë:</b> <i>Gjej se cila kafshë është.</i> Njihen nxënësit me lojën dhe rregullat e saj. Loja drejtohet nga mësuesja. Mësuesja shkruan në një fletë të cilën nuk e shohin të tjerët emrin e një kafshe, ose ndan më vete figurën e një kafshe. Nxënësit kanë të drejtë të drejtojnë me radhë pyetje të cilave mësuesja do t'u japë përgjigje për të gjetur emrin e kafshës.</p> <p><b>Shpjegim i përparuar:</b> Në botë ekzistojnë qindra mijërat e llojeve të ndryshme kafshësh. Shkencëtarëve ju duhet t'i identifikojnë ato. Për këtë arsye ata i klasifikojnë dhe i grupojnë të ngjashme siç vepruat ju më parë gjatë lojës. Shpjegohet se si mund t'i dallojmë në grupet e mëdha (si insektet) midis tyre. Brenda grupit të insekteve ka grupe akoma më të vogla. Kodet e identifikimit janë krijuar nga shkencëtarët pikërisht për këto grupe të vogla, sepse do të ishte shumë e vështirë dhe njëkohësisht e ngatërruar që secila prej kafshëve të kishte një kod të saj.</p> <p>Theksohet se kodet përdoren për të dalluar gjithashtu dhe bimë.</p> <p><b>Pyetje-përgjigje:</b> Ftohen nxënësit të marrin pjesë së bashku në ndërtimin e një çelësi përcaktimi. Udhëzohen të lexojnë pyetjet në fisha dhe emërtimin e kafshëve në figurën që përmban secila prej fishave. Në fisha janë gati pyetjet si në libër, gjithashtu mësuesja tregon dhe figurat e një zogu, një mace, një peshku, një gjarpri.</p> <p>Në dërrasë ngjitet fisha e parë me pyetjen: <i>A ka këmbë kafsha?</i> Prej së cilës dalin dy shigjetat që klasifikojnë kafshët që i përgjigjen pyetjeve PO; JO. Vazhdojnë së bashku me nxënët zgjedhjen e pyetjeve të rradhës të paraqitura në fisha për tu ngjitur poshtë përgjigjeve. Zgjidhen dhe ngjiten fishat me pyetjet: <i>“A ka dy këmbë?”</i> dhe <i>“A ka luspa?”</i></p>			

Tërhiqet vëmendja e nxënësve, nëse ndonjë kafshë në figurë e jep përgjigjen e pyetjes ngjitet figura (*e peshkut*). Vazhdohet me zgjedhjen dhe ngjitjen e pyetjeve të tjera në vazhdim: A ka pedë? A ka kater këmbë? A rrëshqet në tokë? Përsëri nxënësit gjejnë përgjigje tek figurat e kafshëve të paraqitura në fillim.

Ftohen nxënësit të shohin skemën e prezantuar në faqen 26 të librit dhe të rikujtojnë rrugën që ndoqën për ndërtimin e një çelësi përcaktimi.

**Veprimtari:** Në dyshe nxënësit do të ndërtojnë pyetje për ndërtimin e një çelësi përcaktimi nëpërmjet të cilit do të identifikojnë: një tigër, një peshkaqen, një rosë dhe një dhi. Pas ndërtimit, grupet dyshe dy e nga dy diskutojnë pyetjet e hartuara dhe çelësin e përcaktimit të ndërtuar prej tyre. Më pas nëpërmjet pyetjeve diskutohet me të gjithë klasën: *Për çfarë na shërben një çelës përcaktimi? Cilat mund të jenë dy përgjigjet që na ndihmojnë të bëjmë një pyetje?* Si do ta zgjeronit pjesën tjetër të çelësit për të përfshirë dhe lepurin? Gjeni emrat e disa prej grupeve të kafshëve. p.sh. : *Cili është emri i grupit ku përfshihen njerëzit dhe macet?*

**Lojë:** Në dyshe nxënësit ndërtojnë çelës përcaktimi për katër kafshë të zgjedhur nga ata sipas rubrikës “*A e gjeni dot?*” të dhënë në libër. Më pas dyshet tregojnë njëri tjetrit çelësat e ndërtuar. Disa prej tyre demonstrohen në klasë.

**Vlerësimi:** Nxënësit bëjnë një vetëvlerësim duke parë se sa e lehtë është për të tjerët që të dallojnë kafshën me anë të çelësit të tyre të përcaktimit.

**Detyra:** Punimi i faqes 20 të Fletores së punës

**Refleksion:** Vazhdojnë ende në ditët e sotme të zbulohen kafshë dhe bimë të reja të cilat u shtohen këtyre çelësve të përcaktimit?

Shënim:

## Ora 8 dhe 9

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Identifikimi i jorruazorëve (2 orë)		<b>Situata e të nxënit:</b> Vëzhgojmë jorruazorët.	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Hulumton se si kafshë të ndryshme jetojnë në habitate të ndryshme, dhe se si ato u janë përshtatur kushteve ku jetojnë. Kryen vëzhgimet dhe krahasimet e duhura në rrethana të ndryshme. Demonstron përdorimin e një çelësi të thjeshtë përcaktimi p.sh. për të identifikuar një specie të panjohur të gjetur në mjedisin përreth. Përdor kode të thjeshta identifikimi Kryen vëzhgimet dhe krahasimet e duhura në rrethana të ndryshme Lidh provat me njohuritë dhe kuptimin shkencor në disa rrethana.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> insekt, koloni, antenë</p>	
<p><b>Burimet e mjetet:</b> një tabaka, një gotë me dy pipëza, disa gjethe të lagura, xham zmadhues; gurë të vegjël, tulla, shkopinj, shufra plastike, copa dërrase, kompensata, kuti të vogla druri, karton, dhe.</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Gjeografi, Edukim fizik, Matematikë, Art</p>	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

*Diskutohen me gjithë klasën çelësat e përcaktimit të punuara në shtëpi.*

Demonstrohet një koleksion jo rruazorësh ose paraqiten foto të disa jorruazorëve. Drejtohet pyeta: *Çfarë kanë të përbashkët këto kafshë?* Tërhiqet vëmendja në mungesën e shtyllës kurrizore të të gjitha ato kafshë. Nxiten nxënësit që si shkencëtarë të vegjël t’i vëzhgojnë me vëmendje dhe t’i emërtojnë kafshët. Sqarohen se të gjitha kafshët e koleksionit/figurave janë insekte. Insektet janë jorruazorë.

Ftohen nxënësit të shohin faqen 28 të librit të nxënësit dhe të lexojnë karakteristikat për secilën kafshë në figurë. Bazuar në informacionin e dhënë në libër nxënësit i japin përgjigje pyetjeve: *Çfarë është një insekt? A ka më shumë se një mënyrë për t’i grupuar ato?* Nxënësit tregojnë tipare të përbashkëta të disa prej kafshëve në figurë dhe argumentojnë kështu mënyrat e tjera të grupimit të kafshëve.

Nxënësit në dyshe do të ndërtojnë një çelës identifikimi ke kafshët e figurave të faqes 28 të librit. Më pas me dëshirë grupet prezantojnë çelësat e identifikimit që kanë krijuar.

*Veprimtaria 1:* Vëzhgimi i jorruazorëve. Diskutohen dhe parashikohen vendet rreth shkollës nxënësit ku mund të gjejnë jorruazorë. Më pas, me anë të një gote me dy pipëza si në figurën e librit ata duhet të mbledhin disa jorruazorë prej secilit vend. Demonstronhet përdorimi i saj dhe ndihmohen nxënësit gjatë përdorimit.

Gjatë studimit të tipareve të trupit të tyre udhëzohen nxënësit të përqendrohen tek veçoritë kryesore të kafshëve si: pjesët e trupit, segmentet, këmbët, antenat, ngjyra etj. Udhëzohen nxënësit t’i ruajnë vëzhgimet e tyre me anë të skicave dhe shënimeve. Nxiten të propozojnë pyetje që do të donin të drejtonin në lidhje me kafshët. Në dyshe nxënësit bazuar në veçoritë e kafshëve që gjetën ndërtojnë çelës përcaktimi.

Udhëzohen nxënësit se në fund të mësimit dyshet gjatë prezantimit të gjetjeve do të bëjnë dhe prezantimin e çelësit të përcaktimit.

*Veprimtaria 2:* Ndërtoni një shtëpi për jo rruazorët. Prezantohet veprimtaria e dytë duke përshkruar se si do të veprojnë nxënësit gjatë saj. Diskutohet se si duhet të jetë ky habitat që do të ndërtohet. Çfarë karakteristikash duhet të ketë. Kush mund të jetojë atje. Cilat duhet të jenë mjetet që duhet të përdoren.

Të organizuar në grupe në oborrin e shkollës nxënësit do të grumbullojnë materiale të ndryshme. Në vende të ndryshme të oborrit do të ndërtojnë një habitate për jorruazorë.

*Përmbledhje:* Nxënësit prezantojnë gjetjet e kërkimit dhe dyshet prezantojnë çelësat e përcaktimit të ndërtuar prej tyre.

Vlerësimi: Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarive.

Nxënësit mund të vetvlerësojnë punën e tyre në përcaktimin dhe ndërtimin e një çelësi përcaktimi.

Detyra: Punimi i fq. 21 të Fletore Pune

Refleksion: Ashtu si njerëzit po kafshët a e dinë se pjesë e cilit grup janë?

Shënim:

## Ora 10

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
Tema mësimore: Si ndikojmë në mjedis		Situata e të nxënësve: Si mund ta mbrojmë mjedisin?	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</p> <p>Diskuton mënyrat me të cilat veprimtaria e njeriut ndikon në habitate lokale.</p> <p>Njeh ndikimin e njeriut në mjedis, si përshembull, ndotja e lumenjve, riciklimi i mbetjeve.</p> <p>Lidh provat me njohuritë dhe kuptimin shkencor në rrethana të ndryshme.</p> <p>Paraqet rezultatet me anë të skicave, grafikëve dhe tabelave</p>		Fjalë kyçe: energji, mbetje, fatkeqësi natyrore, dëm i shkaktuar nga njeriu, mbroj	
Burimet e mjetet: letër, stilolaps, letër me ngjyra, foto të aktivitetit të klasës për pastrimin e ambjentëve rreth shkollës.		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Harta semantike:</i> Shkruhet në qëndër të hartës "Toka dhe njeriu" më pas nxënësit nxiten të tregojnë rreth çfarë dinë ata në lidhje me: Si ndikon Toka te njeriu; Si ndikon njeriu te Toka. Gjatë plotësimit të hartës semantike bëhen dhe klasifikime për të bërë dallimin ndërmjet fatkeqësive natyrore si tërmetet, dhe fatkeqësive të shkaktuara nga dora e njeriut, si hedhja e mbeturinave në lumë.</p> <p>Prezantohen foto të bëra nga aktiviteti i mëparshëm mbi pastrimin e ambjentit të papastër rreth shkollës. Fotot paraqesin gjendjen para pastrimit dhe gjendjen pas pastrimit. Drejtohet pyetja: Vini re ndonjë ndryshim? Çfarë e ka sjellë këtë ndryshim? Si është më mirë?</p> <p><i>Lexim i drejtuar:</i> Lexohet informacioni i dhënë në fq.30 në libër. Drejtohen pyetje? Për çfarë kanë nevojë njerëzit? Po energjinë si e sigurojmë? Theksohet se energjinë për trupin e sigurojmë nëpërmjet ushqimeve që hamë. Pse prodhojmë mbetje? Gjatë mendimeve diskutimi lidhet me mbetjet e prodhuara dhe ambjentin e krijuar rreth shkollës, për të cilin para disa ditësh vetë fëmijët kishin marrë pjesë në pastrim.</p> <p>Komentohen figurat e paraqitura në libër. Diskutohet rreth shkaqeve dhe ndikimeve të tërmeteve. Sqarohen arsye tërmeti është një fatkeqësi natyrore. Po kështu diskutohet dhe rreth shkaqeve dhe ndikimeve të ndotjes së ujit. Përse në atë rast kemi të bëjmë me fatkeqësi të krijuar nga njerëzit. Tërhiqet vëmendja për rastet kur ka nxënës që mendojnë se shkaktarët e të gjitha problemeve janë të tjerët dhe jo vetë ata. Shembull i kësaj është televizioni. Në të vërtetë, aparati televiziv ka një ndikim të ndjeshëm në mjedis. Fabrikat e prodhimit të televizorëve shkaktojnë ndotje, po ashtu edhe kamionët e anijet që i transportojnë ato ndikojnë në ndotjen e ajrit dhe ujit të detit. Energjia elektrike që përdoret për të vënë në punë televizorin prodhohet nëpërmjet centrale elektrike, të cilët gjithashtu ndotin ajrin. Si zgjidhje mund të ofrohen kursime në përdorimin e energjisë, apo përdorime të tjera të mjeteve të transportit apo sigurim më i mirë i tyre, pakësimi i tymit të oxhaqeve, prerja e më pak pemëve, etj..</p>			

<p><i>Ditar dypjesësh:</i> Bazuar në veprimtarinë e dhënë në libër “Si mund ta mbrojmë mjedisin” nxënësit në dyshe do të listojnë në njërën kolonë të ditarit dypjesësh, shkaktarët që dëmtojnë mjedisin dhe në kolonën tjetër mënyrat se si mund ta mbrojmë mjedisin nga këta shkaktarë. Me dëshirë nxënësit mund ta shoqërojnë prezantimin e tyre me një vizatim në lidhje me temën</p> <p><i>Prezantimi i punimeve</i> të dysheve dhe diskutim mbi mesazet që përcjellin ato nëpërmjet ideve në lidhje me mënyrat e mbrojtjes së mjedisit.</p>	
<p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve.</p>	
<p>Detyra: Punimi i fq. 22 të Fletore Pune</p>	<p>Refleksion: Kam unë njohuri mbi format e ndikimit të njeriut në mjedis?</p>
<p>Shënim: Disa ditë para kësaj ore mësimore mund të zhvillohet një aktivitet për pastrimin e një mjedisi rreth shkollës nga nxënësit e klasës. Gjatë zhvillimit të aktivitetit bëhen foto të cilat përdoren si material për diskutim gjatë kësaj ore mësimore.</p>	

## Ora 11

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
Tema mësimore: Rëndësia e ujit për jetën		Situaata e të nxënësve: Rrugëtimi i një lumi	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</p> <p>Të njohim format e ndikimit të veprimtarisë njerëzore në mjedis: për shembull, ndotja e lumenjve, riciklimi i mbetjeve.</p> <p>Të lidhim provat me njohuritë shkencore në rrethana të ndryshme.</p> <p>Diskuton mënyrat me të cilat veprimtaria e njeriut ndikon në habitate lokale.</p>		Fjalë kyçe: ndot	
Burime dhe mjete: tabak letre, stilolaps, laps		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art, Gjeografi	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Parashikim me terma paraprakë:</i> Jepen fjalët ujë, jetë, ndotje, lumenj, ujë i kripur. Duke përdorur këto fjalë nxënësit do të shkruajnë një ngjarje të trilluar apo një informacion.</p> <p>Pas 5 minutash nxënësit me dëshirë lexojnë shkrimet e tyre.</p> <p><i>Harta e mendimit:</i> Duke përdorur shkrimet e nxënësve në dërrasë mund të hartohet një hartë mendimi ku të klasifikohen: Llojet e ujërave që ndodhen në natyrë; Ku ndodhen ujërat në Tokë; Përdorimet e ujit; Rrethimet e dëmtimit të ujit.</p> <p>Nëse gjatë përshkrimit nuk dalin këto tematika nxiten nxënësit me anë të pyetjeve të japin mendime rreth tyre.</p> <p>Ju kërkohet nxënësve të listojnë gjallesat që kanë nevojë për ujë të pastër. Dilet në përfundim se të gjitha gjallesat kanë nevojë për ujë të pastër. Çfarë ndodh me ujin e pisët (ujërat e zeza) në shtëpitë tona. Çfarë ndodh me ujërat e zeza të shkollës? Ftohen nxënësit të shohin fotot e paraqitura në fq.32 të librit dhe të reflektojnë mbi dobiet e ujit të pastër të lumenjve si dhe pasojat negative të njeriut mbi një lumë. Shembull i kësaj të fundit është ndotja e drejtpërdrejtë. Megjithatë, edhe pse shpesh mendohet se ndërtimi i digave mbi lumenj ka ndikim më të ulët, ndërtimi i tyre mund të shfarsosë një numër të madh bimësh dhe kafshësh.</p>			



*Veprimtaria 1:* Vizatimi i një lumi. Duke pasur parasysh udhëzimet e dhëna në libër nxënësit do të bëjnë një vizatim të një lumi duke treguar në vizatim rrugën që bën uji i lumit dhe ku kalon ai. Pas vizatimit nxënësit në dyshe ia tregojnë dhe përshkruajnë njëri tjetrit vizatimet dhe tërhiqet vëmendja për të treguar rreth çfarë ndodh me peshqit që jetojnë në këtë lumë. Disa prej prezantimeve kryhen para klasës.

*Veprimtaria 2:* Si të pastrojmë ujin. Në varësi të mundësive kjo veprimtari mund të kryhet në grupe të drejtuara nga mësuesja ose mund të demonstroet nga mësuesja dhe nxënësit të vëzhgojnë e mbajnë shënime.

Hapi i parë: Nxënësit shohin gotën me ujë të pastër dhe mbajnë shënim.

Hapi i dytë: në gotën me ujë hidhet rërë dh përzjehet. Ftohen nxënësit të shohin gotën dhe të japin mendime në lidhje me ujin: A u turbullua uji? Përsëri mbajnë shënime

Hapi i tretë: Nëpërmjet hinkës dhe letres filtruese kalojmë ujin në një gotë tjetër. Ftohen përsëri nxënësit të shohin ujin në gotë dhe të japin mendime mbi pamjen e tij.

Diskutohet mbi ndryshimet e ndodhura. Theksohet se shpesh papastërtitë mund të jenë të padukshme, për këtë arsye në ujin e pijshëm që vjen në rrjetet e ujësjellësit në shtëpitë tona uji jo vetëm kalon në disa filtrime por edhe disinfektohet. Shumë fëmijë dhe të rritur e cilësojnë higjienën dhe ujin e pastër si diçka të padiskutueshme. Nxirrni në pah se një në tetë njerëz në botë nuk pijnë ujë të sigurt. Për shkak të mungesës së ujit të pijshëm në botë në çdo 17 sekonda vdes një fëmijë. Prej diresë së shkaktuar nga konsumimi i ujit të ndotur në ditë vdesin rreth 4000 fëmijë.

*Përfundime:* Nxënësit japi mendime rreth pyetjeve: Cilat janë efektet e konsumimit të ujit të ndotur? ( për kafshët; për njerëzit) Cila do të ishte e ardhmja për një numër njerëzish në një vend të tillë?

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve.

Detyra: Punimi i fq. 23 të Fletore Pune

Refleksion: Po unë a kujdesem sa duhet për ujin?

Shënim: Ne faqen <http://video.nationalgeographic.co.uk/video/environment/environmentalthreats-environment/water-pollution>ka një video të shkurtër në lidhje ujin e ndotur, të titulluar ‘Pse duhet të kujdesemi për ujin?’.

## Ora12

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituria Natyre	Klasa 4	Data
Tema mësimore: Riciklimi mund të shpëtojë Tokën		Situata e të nxënit: Reduktim, ripërdorim, riciklim.	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Të njohim format e ndikimit të veprimtarisë njerëzore në mjedis: për shembull, ndotja e lumenjve, riciklimi i mbetjeve. Të lidhim provat me njohuritë shkencore në rrethana të ndryshme. Diskuton mënyrat me të cilat veprimtaria e njeriut ndikon në habitate lokale.			Fjalë kyçe: ripërdor, ujëra nëntokësore, ricikloj, mikroorganizëm, kalbje
Burime dhe mjete: doreza plastike, kërcëj bimësh të ndryshme, bërthama molle, bukë, vazo qelqi			Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Biologji, Edukim Shëndetsor

<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><i>Braingstorming:</i> Udhëzohen nxënësit të vizatojnë një shtëpi, dhe me anë të shigjetave të drejtuara nga brenda të emërtojnë gjërat që ne përdorim në përditshmërinë tonë si uji, energjia, ushqimi, pëhurat, rrobat, letrat, etj. Ndërsa me anë të shigjetave të drejtuara nga jashtë nxënësit duhet të tregojnë mbetjet e prodhuara si, nxehtësia, drita, mbetjet ushqimore, ujërat e zeza, mbetjet njerëzore, etj.</p> <p><i>Pyetje-Përgjigje:</i> Drejtohen pyetje për të cilat nxënësit japin përgjigje bazuar në përditshmërinë e tyre: Çfarë ndodh me rrobat që nuk përdorim më? Po me letrat? A mendoni se ka ndonjë mënyrë për të mos i hedhur menjëherë? Bisedohet në lidhje me ripërdorimin e letrave të përdorura nga njëra anë apo të rrobave të cilat mund të përdoren nga diskutimet tjetër apo të përdoren për një funksion tjetër. Theksohet ideja e ripërdorimit.</p> <p>Po me ujin, energjinë elektrike që përdorim në shtëpi çfarë ndodh? Theksohet se është më mirë të reduktojmë përdorimin e tyre në rastet e nevojshme dhe të mos shpërdorjmë. Çfarë ndodh me mbetjet? Pas mendimeve të nxënësve sqarohet se mbetjet digjen dhe djegia e tyre shkakton ndotje të ajrit dhe ndotje të tokës e ujërave nëntokësore. Shpjegohet kuptimi i ujërave nëntokësore dhe fakti se ky ujë konsumohet nga ne dhe kafshët, me të cilat ne më pas ushqehemi. Theksohet se mënyra më e mirë është riciklimi.</p> <p>Ftohen nxënësit të shohin dhe japin mendime rreth figurave mbi ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve të ndryshme. Për secilin rast nxiten nxënësit çfarë materiali është dhe çfarë mund të prodhohet nga riciklimi i tyre. Ftohen nxënësit të tregojnë për raste riciklimi, ose ripërdorimi apo reduktimi të materialeve që përdoren në shkollë.</p> <p>Pyeten nxënësit: A keni dëgjuar ndonjëherë të përdoret fjala pleh? Kur dhe në çfarë situatë? Çfarë është plehu? Sqarohen nxënësit duke komentuar mbi shëmbullin e fermerit të dhënë dhe në libër. dhe</p> <p><i>Veprimtari kërkimore:</i> Përzbejmë mbetje bimësh. Bazuar në udhëzimet e veprimtarisë në libër në një kavanoz hidhen mbetje bimësh dhe pak ujë. Këto mbetje të mbyllura në kavanoz do të shihen çdo ditë dhe në fletore do të mbahet shënim ose do të vizatohen ndryshimet që ndodhin në materialet brenda në kavanoz. Sqarohen nxënësit se kjo është një formë riciklimi është dhe prodhimi i plehut nga mbetjet e lëndëve bimë. Flitet për rolin e mikroorganizmave dhe se si ato riciklojnë lëndët e bimëve dhe kafshëve të ngordhura.</p> <p>Po kështu përgatitet pleh dhe në një formë tjetër: Në një enë të tejdukshme futet brenda një sasi buke. Ena mbyllet mirë. Nga ena do të vëzhgohet me kujdes se si buka do të myket. Kujdes, theksohet se buka nuk duhet nxjerrë nga ena.</p> <p><i>Përmbledhje:</i> Udhëzohen mulliri i brumit, tek shtypshkronja, tek shkolla, tek riciklimi në mullirin e brumit dhe kështu me rradhë. Ftohen nxënësit të shpjegojnë se si në këtë mënyrë kursejmë para dhe pemë.</p>	
<p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve.</p>	
<p>Detyra: Punimi i fq. 24 të Fletore Pune</p> <p>-Vëzhgimi dhe mbledhja e të dhënave gjatë gjithë javës me përgatitjen e plehut në kavanoz.</p> <p>-Mbledhja e të dhënave mbi riciklimin e mbetjeve plastike sipas veprimtarisë “Mbetjet plastike rezikojnë jetën e gjallesave të detit”</p>	<p>Refleksion: Po tani, çfarë mendon se do të bësh ndryshe në të mirë të mjedisit?</p>
<p>Shënim: Në faqen <a href="http://www.sciencekids.co.nz/recycling.html">http://www.sciencekids.co.nz/recycling.html</a> do të gjeni një lojë të gjallë riciklimi.</p> <p>Ne faqen <a href="http://www.oillierecycles.com/uk/html/recycle.html">http://www.oillierecycles.com/uk/html/recycle.html</a> do të gjeni një numër informacionesh për materiale të veçanta riciklimi si dhe një këngë dhe një film i shkurtër për riciklimin.</p>	

## Ora 13

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj (ora 1)		Situata e të nxënit: Unë di...	
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara. Prezanton me forma të ndryshme njohuritë e marra dhe aftësitë e qëndrimet e fituara.		Fjalë kyçe: gjallesa, habitat, çelës përcaktimi, riciklim	
Burime dhe mjete: enciklopedi, tabak letre, lapsa, ngjyra		Lidhja me fushat e tjera: Shkencat (Kimi Biologji) Art	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Prezantim i kërkimit:</i> Nxënësit do të prezantojnë informacionet e mbledhura mbi veprimtarinë “Mbetjet plastike rezikojnë jetën e gjallesave të detit”. Drejtohet pyetja: Po tani si mendoni të reagoni në raste situatash të ngjashme? A ka ndryshuar qëndrimi juaj në mbështetje të mjedisit? Ftohen nxënësit në dhënien e mendimeve. <i>Punë e pavarur:</i> Ftohen nxënësit të punojnë individualisht Fletoren e punës në fq. 25 <i>Prezantim dhe diskutim:</i> me gjithë klasën mbi përfundimet e vëzhgimeve në lidhje me veprimtarinë “Përzejmë mbetje bimësh”			
Vlerësimi: Vlerësohen për përfundimet e nxjerra në ushtrimet e librit. Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve duke përdorur fjalorin e përshtashëm. Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre.			
Detyra: Pyetja e refleksionit mund të punohet me dëshirë në shtëpi.		Refleksion: Mendo dy gjëra që të pëlqyen nga puna e kryer gjatë këtyre temave dhe diçka që mendon se mund ta bëjë më mirë.	
Shënim: Në lidhje me detyrën e shtëpisë nxënësit sqarohen se zgjedhja e mënyrës së prezantimit mund të jetë sipas dëshirës.			

**Ora 14**

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj (ora 2)		Situata e të nxënit: Unë di...	
Detyrë përmblendhëse / Test			
Rezultatet e të nxënit sipas temës: Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara.		Fjalë kyçe: skelet, kockë, muskuj, ilaçe gjallesa, habitat, çelës përcaktimi, riciklim	
Burime dhe mjete: enciklopedi, fleta e detyrës përmblendhëse, lapsa, ngjyra		Lidhja me fushat e tjera: Shkencat (Kimi Biologji) Art	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Nxënësit <i>prezantojnë</i> mbresat e tyre të punuara në detyrat e shtëpisë. <i>Punë e e pavarur:</i> Plotësimi i detyrave përmblendhëse. <i>Dy të vërteta një gënjeshtër:</i> Nxënësit shkruajnë në fletore dy gjëra të vërteta/sakta dhe një gënjeshtër/të gabuar (nga mësimet e trajtuara). Shoku tjetër do të gjejë të vërtetat/saktat dhe gënjeshtren/ gabimin. Më pas këmbëjnë rolet			
Vlerësimi: Vlerësohen për punimin e Detyrës përmblendhëse / Testit.			
Detyra:		Refleksion:	
Shënim: Kjo orë mund të shfrytëzohet si tesim ose di detyrë përmblendhëse e periudhës së parë. -Ora e mësimimit mund të fillojë me zhvillimin e testit/detyrës përmblendhëse dhe më pas me prezantimet dhe lojën.			

**Periudha e parë****Njohuritë/konceptet****Sistemet te kafshët****Mbështetja dhe lëvizja**

- Kockat e skeletit
- Muskujt

**Ilaçet****Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës :**

- Krahason skeletin e trupit të njeriut me atë të kafshëve të tjera.
- Emërton kockat kryesore në trupin e njeriut.
- Përshkruan se si kockat e skeletit rriten, mbështesin dhe mbrojnë trupin.
- Formulon pyetje dhe heton përgjigjet për rritjen dhe skeletin.
- Tregon se kafshët me skelet kanë muskuj që lidhen me kockat.
- Tregon se një muskul duhet të tkurret që të shkaktojë lëvizjen e kockës.
- Tregon se muskujt punojnë në çifte ata tkurren dhe lëshohen duke krijuar lëvizje.
- Shpjegon rolin e drogave si ilaçe.

**Njohuritë/konceptet****Qëniet e gjalla në mjediset e tyre**

- Përshtatjet në mjedis
- Çelësat e përcaktimit

**Ndikimi i njeriut në mjedis****Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës :**

- Kryen kërkime për bimë dhe kafshë që jetojnë në habitate të ndryshme.
- Diskuton për tipare me të cilat ato përshtaten me mjedisin ku jetojnë.
- Përdor çelësat e përcaktimit për të identifikuar bimët.

**Periudha e parë**

Emri \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

Klasa \_\_\_\_\_

**1. Lidh pjesët e fjalëve.**

5 ( pikë)

Skeleti	një kockë në shtyllën kurrizore
Kafka përbëhet nga	e mban dhe e mbron trupin
Rruaza është	kockat e kokës
Kafshët që kanë skelet	quhen jorruazorë
Kafshët që nuk kanë skelet	quhen rruazorë

**2. Përgjigju pyetjeve.**

3 ( pikë)

Cilën pjesë të trupit mbron kafka? \_\_\_\_\_

Cilat pjesë të trupit rrethohen nga brinjët? \_\_\_\_\_

**3. Qarko përgjigjen e saktë:**

5 ( pikë)

Muskujt ndodhen në të gjithë trupin.	Po	Jo
Kockat mund të lëvizin vetë.	Po	Jo
Ne rritemi sepse skeleti ynë rritet.	Po	Jo
Muskujt nuk janë të lidhura me kockat.	Po	Jo
Muskujt punojnë në dyshe.	Po	Jo

**4. Shkruaj tre këshilla për përdorimin e ilaçeve.**

3 ( pikë)

---



---



---



---

**5. Plotëso duke përdorur fjalët:**


5 ( pikë)

përshtat      ushqej      ndryshoj      mbijetoj      ushqim

Të gjitha kafshët \_\_\_\_\_ në mënyra të ndryshme me vendin ku jetojnë. Ato kanë nevojë për \_\_\_\_\_. Disa ushqehen me bimë dhe disa \_\_\_\_\_ me kafshë të tjera. Kur kushtet e mjedisit ndryshojnë, kafshët \_\_\_\_\_ mënyrën e jetesës. Për të \_\_\_\_\_ kafshët i janë përshtatur habitatit të tyre.

**6. Ndërtoni një çelës përcaktimi nëpërmjet të cilit të identifikoni një lepur, një rosë, një pulë, një peshk:**

4 ( pikë)



**7. Trego nga një shembull për:**

3 ( pikë)

Reduktimin \_\_\_\_\_  
 Ripërdorimi \_\_\_\_\_  
 Riciklimi \_\_\_\_\_

**1. Jep mendimin tënd:**

2 ( pikë)

Përse duhet të kujdesemi për mbajtjen pastër të mjedisit ku jetojmë?

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8- 11	12-15	16 -19	20- 23	24- 27	28- 30

**Suksese!**

## KAPITULLI 3

### Trupat e ngurtë, lëngjet dhe gazet

#### Ora 1

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Lënda		<b>Situata e të nxënës:</b> Çfarë është lënda?	
<p><b>Rezultatet e të nxënës sipas temës:</b>            Identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta.            Vëzhgon dhe krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre.            Heton dhe përshkruan përzierjen e lëndëve të ndryshme dhe ndarjen e tyre.            Mëson se lënda mund të jetë e ngurtë, e lëngët dhe e gaztë.            Zhvillon hulumtimet e nevojshme dhe të bëjmë krahasime.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> lëndë, trup i ngurtë, lëng, gaz, gjendja e lëndës</p>	
<p><b>Burimet e mjete:</b> uthull, sodë buke, (bikarboinat natriumi), shishe qelqi, doreza plastike, llastik</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Shkenca natyrore (Kimi), Edukim fizik, Art</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>            Ftohen nxënësit të vështrojnë përreth dhe të përmendin gjithçka që arrijnë të shohin. Në dërrasën e zezë ndërtohet një listë me emrat që përmendin nxënësit. Nëse pjesa më e madhe e tyre do të jenë trupa të ngurtë (karrige, tavolina, etj.), kërkohet nga nxënësit të japin shembuj lëngjesh, p.sh uji në shishe.            Drejtohet pyetja: <i>Çfarë thithim me hundë? Çfarë është ajri?</i> Shpjegohet se ajri është një përzierje gazesh.  <i>Nga se është e përbërë lënda?</i> Shpjegohet se gjithçka është e përbërë nga lënda, dhe ajo mund të jetë e ngurtë, e lëngët ose e gaztë.  <b>Harta e mendjes:</b> Në dërrasë ndërtohet harta e mendjes ku në qendër shkruhet fjala “Lëndë”, më pas tri gjendjet e lëndës. Klasifikuar si pjesë e gjendjes së duhur (e ngurtë, e lëngët, e gaztë) shkruhen emrat e përmendur dhe listuar më lart. Gjatë klasifikimit të secilës lëndë nxënësit do të flasin për pamjen që ka, çfarë ndjesie të krijon ose si “sillet” ai. Këto komente do të përdoren për të dalë në përfundime: se trupat e ngurtë nuk ndryshojnë formë, se lëngjet janë të rrjedhshëm dhe se gazet mund të marrin çdo lloj forme. Theksohet fakti se jo të gjithë gazet janë të padukshëm. Disa gaze kanë ngjyrë, p.sh, klori është i verdhë/i gjelbër dhe squfuri është i verdhë. Gjithashtu theksohet kujdesi se nuk duhen prekur të gjitha llojet e lëngjeve, si p.sh. acidet, të cilat mund të të djegin.            Ftohen nxënësit të shohin dhe komentojnë figurat me tri gjendjet e lëndës të paraqitura në faqen 38 të librit. Prezantohet situata e dhënë në libër dhe nxënësit në figurë do të identifikojnë dy lëndë në gjendje të ngurtë, dy në gjendje të gaztë dhe dy në gjendje të lëngët.  <b>Lexim i drejtuar:</b> Gjatë leximit, nëpërmjet pyetjeve diskutohet me gjithë klasën: <i>Ku ndodhet ajri? Nga se përbëhet ajri? A mund t’i dallojmë të gjithë llojet e gazeve? Përmendini disa lloje gazesh. Cili është gazi që thithim kur marrim frymë? Cili është gazi që del nga mushkëritë kur nxjerrim frymën? Pse vajza në figurë ka zënë hundën? Si mendoni se është era e gazit sulfoid të paraqitur në figurë?</i></p>			

<p><b>Veprimtari:</b> Përftimi i dioksidit të karbonit. Bazuar në përshkrimin e dhënë në libër, fillimisht demonstron eksperimentin nga mësuesja. Më pas të drejtuar në radhën e veprimeve nga mësuesja, nxënësit në grupe kryejnë eksperimentin dhe realizojnë përfkrimin e dioksidit të karbonit. Nxënësit do të vërejnë se sapo uthulla të përzihet me bikarbonatin e natriumit doreza do të fillojë të fryhet dhe të tundet porsit tullumbace. Shpjegohet se fluskat janë të mbushura me një lloj gazi të quajtur dioksid karboni. Ky gaz formohet si rezultat i përzierjes së këtyre dy përbërësve.</p> <p>Në fletore nxënësit do të vizatojnë se çfarë ndodhi kur uthulla u përzije me sodën e bukës. Theksohet që të emërtojnë lëngun dhe gazin që u formua.</p> <p><b>Lojë:</b> Lojë me dritat e semaforit. Secili prej nxënësve duhet të ketë tre kartonë: një të kuq për trupat e ngurtë, një të verdhë për lëngjet dhe një jeshil për gazet. Përmendni disa artikuj të zakonshëm, si druri, vizorja, soda e bukës, qumështi, uthulla, ajri, dioksidi i karbonit, oksigjeni etj. dhe kërkoni prej nxënësve të ngrenë kartonin e duhur që tregon gjendjen e artikullit (e ngurtë, e lëngët, e gaztë). Me kalimin e kohës mund të rritet shkalla e vështirësisë së materialeve për përcaktim.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë dhe diskutimeve.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i faqes 26 të Fletore së punës</p>	<p><b>Refleksion:</b></p>
<p><b>Shënim:</b> Në rast se nuk keni mjete të mjaftueshme për të gjithë nxënësit, këtë veprimtari mund ta zhvilloni në formën e një veprimtarie ilustruese nga mësuesja. Sigurohemi që të gjithë nxënësit të kenë mundësi t'i shohin fluskat.</p>	

## Ora 2 dhe 3

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<p><b>Tema mësimore:</b> Lënda përbëhet nga grimca ( 2 orë )</p>		<p><b>Situata e të nxënit:</b> Loja me grimca</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>                      Identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta.                      Demonstron bashkëpunim gjatë punës në grup.                      Kupton se lënda mund të gjendet në formë të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë.                      Kryen vëzhgime dhe bën krahasime.                      Mbledh prova dhe paraqet rezultatet e anë të vizatimeve.                      Dallon prirjet e mundshme dhe modelet e thjeshta tek rezultatet dhe të arrijmë ti argumentojmë ato.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> grimcë, model shkencor</p>	
<p><b>Burimet e mjete:</b> një kuti drejtkëndore ose një kuti këpucësh, një cope kartoni sa gjerësia e kutisë, për ta ndarë atë në pjesë, gjashtë topa plastikë.</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art, Edukim fizik</p>	



**D.D.M /Dua të di:** Në këtë rubrikë nxënësit në fletore do të shkruajnë pyetjet që i kanë dalë gjatë plotësimit të informacionit rreth lëndës dhe gjendjeve të saj. Lexohen me dëshirë pyetjet nga disa nxënës dhe një pjesë e tyre shkruhen në dërrasë.

Lexohet dhe diskutohet së bashku mbi informacionin që jepet në libër në lidhje me përbërjen e lëndës. Duke studiuar figurat e dhëna në faqen 40 në libër kërkohet përgjigja e pyetje se *pse ekzistojnë tri lloje të saj*. Për këtë përdoret si model vizatimi i sferave si grimcat që përbëjnë lëndën dhe gjendja e lëndës përcaktohet nga mënyra se si lëvizin grimcat brenda saj.

**Veprimtari:** Ndërtoni modelin e një grimce. Për këtë vjen në ndihmë fleta e aktivitetit 3.2. Ndahen nxënësit në grupe. Udhëzohen nxënësit për rregullat që duhet të ndjekin gjatë punës në grupe.

**Hapi 1.** Nxënësit do ta vendosin kutinë mbi tavolinë. Fillimisht nuk duhet ta vendosin ndarësen. Ata do t'i futin topat në kuti, pastaj do ta tundin kutinë në të gjitha drejtimet pa e shkëputur atë nga tavolina. Nxënësit duhet të vëzhgojnë lëvizjet e topave dhe hapësirat midis tyre. Në fund do të mbajnë shënime në fletore mbi madhësinë e hapësirës që kishin topat në kuti dhe lëvizjen e tyre.

**Hapi 2.** Kësaj radhe nxënësit do ta vendosin ndarësen në mes të kutisë, në mënyrë që të zvogëlojnë hapësirën ku qëndrojnë topat. Topat do të qëndrojnë brenda njërës prej dy hapësirave. Nxënësit do ta tundin sërish kutinë pa e ngritur atë nga tavolina.

Ata duhet të vëzhgojnë lëvizjet e topave dhe të dallojnë ndryshimet nga lëvizjet e topave në hapin e parë. Nxënësit duhet gjithashtu të vëzhgojnë hapësirat e lira midis topave dhe sa ndryshojnë këto hapësira nga ato të hapit të parë. Përsëri përfundimet e vëzhgimeve do të shkruhen në fletore.

**Hapi 3.** Tani nxënësit do ta vendosin ndarësen edhe më afër njërës anë të kutisë, duke e bërë hapësirën e topave edhe më të vogël. Kësaj radhe topat duhen vendosur sa më ngushtë të jetë e mundur. Nxënësit do ta tundin sërish kutinë në të gjitha drejtimet pa e ngritur atë nga tavolina.

Ata duhet të vëzhgojnë lëvizjet e topave dhe të dallojnë ndryshimet nga lëvizjet e topave në hapin e parë dhe të dytë. Nxënësit duhet gjithashtu të vëzhgojnë hapësirat e lira midis topave dhe sa ndryshojnë këto hapësira nga ato të hapit të parë dhe të dytë.

Pas përfundimit të provave nxënësit brenda grupit diskutojnë dhe dalin në përfundime të përbashkëta mbi: vendosjen e topave, hapësirën në kuti dhe lëvizjen e topave në të tri rastet.

Përfaqësuesi i secilit grup prezanton përfundimet e grupit duke i shoqëruar dhe me vizatim për secilin rast.

**Lojë:** Loja me grimca. Ndahen nxënësit në grupe me nga 10 ose 15 vetë. Sqarohen nxënësit se secili prej tyre do të përfaqësojë një grimcë. Një herë ata do të jenë grimcat e trupave të ngurtë, një herë të lëngjeve dhe në fund të gazeve. Do të ndiqen udhëzimet e mësueses.

Fillimisht nxënësit do të luajnë rolin e grimcave të trupave të ngurtë. Ata do të vendosen në rreshta dhe do të qëndrojnë pranë njëri-tjetrit duke u lidhur për krahu me grimcën fqinje. Ndërkohë, nxënësit që ndodhen në fund të rreshtave do të kapen fort pas shpatullës së nxënësit që kanë përpara.

<p>Tërhiqet vëmendja e nxënësve për të kërkuar që të lëkundën së bashku sa majtas-djathtas. <i>Çfarë vini re?</i> Më pas ftohen të afrohen ose largohen nga njëri-tjetri. <i>Çfarë vini re?</i> Dhe herën tjetër të përpiqen të ndryshojnë formën e grupit. <i>Çfarë vini re?</i> Pas kësaj loja vazhdon me riformimin e grupeve për “lëngjet” e më pas për “gazet”. Nxënësit do të luajnë rolin e grimcave të lëngjeve dhe për këtë fillimisht duhet t’i zgjidhin krahët. Ata do të largohen nga njëri-tjetri derisa të mund të kapen për dore. Më pas ata do të përpiqen të lëvizin sa të kenë mundësi, po pa i lëshuar duart e njëri-tjetrit. Në rolin e grimcave të gazit nxënësit nuk do të kapen më as për dore por do të vijjnë vërdallë sa të munden.</p> <p><b>Përfundime:</b> <i>Tregoni dhe shpjegoni se çfarë ndodhi kur provuat të lëkundeshit si të ishit një trup i ngurtë? Po kur ishit lëng apo gaz?</i></p> <p><i>Tregoni dhe shpjegoni se çfarë ndodhi kur u përpoqët të afroheshit me njëri tjetrin si të ishit një trup i ngurtë? Po kur ishit lëng apo gaz?</i></p> <p><i>Tregoni dhe shpjegoni se çfarë ndodhi kur provuat të ndryshonit formën e grupit si të ishit një trup i ngurtë? Po kur ishit lëng apo gaz?</i></p> <p>Secili prej nxënësve duhet të përfaqësojë një grimcë. Ata duhet të jenë në gjendje të thonë se kur ishin në rolin ‘trupit të ngurtë’ lëvizjet e tyre ishin tepër të kufizuara. Mund të dridheshin në vend por jo të lëviznin. Kjo pjesë e lojës tregon sjelljen e grimcave në trupat e ngurtë, ku ato mund të dridhen por jo të ndryshojnë formën e të tërës. Ndërsa kur nxënësit ishin në rolin e ‘lëngut’ ata mund të lëviznin në rresht por përsëri mbeteshin të lidhur. Kjo tregon sjelljen e grimcave të lëngjeve që rrëshqasin mbi njëra-tjetrën. Kur nxënësit ishin në rolin e ‘gazit’ ata mund të lëviznin ku dhe si të dëshironin. Kjo tregon sjelljen e grimcave tek gazet, ku ato mund të largohen nga njëra-tjetra dhe të lëvizin në çdo lloj drejtimi.</p> <p><b>D.D.M/Mësova:</b> Në rubrikën mësova nxënësit shkruajnë përfundimet e lojës duke i shoqëruar ato me anë të vizatimit të modelit të grimcave gjatë lojës. Gjithashtu studiohen pyetjet e ngritura prej tyre të cilat morën përgjigje gjatë kësaj kohe.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarisë dhe diskutimeve. Vëzhgohen me kujdes se cilët janë ata nxënës që ndjekin udhëzimet siç duhet dhe cilët janë ata që kanë nevojë për më tepër përqendrim.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i faqes 27 të Fletores së punës</p>	<p><b>Refleksion:</b> Si u ndjetë në rolin e grimcës?</p>
<p><b>Shënim:</b> Për arsye të shtrirjes kohore, veprimtaria “lojë” të zhvillohet në orën e dytë dhe për të zhvilluar do të nevojitet një hapësirë e madhe e zbrazur (oborri i shkollës ose fusha e volejbollit do të ishte një zgjidhje e mirë). Nëse jemi të detyruar që veprimtarinë ta zhvillojmë brenda godinës së shkollës, atëherë përdorni palestrën ose hollin e shkollës.</p>	

## Ora 4 dhe 5

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Si sillen trupat e ngurtë, lëngjet dhe gazet? ( 2 orë )		<b>Situata e të nxënimit:</b> Çfarë ndodh me formën e lëndës?	
<p><b>Rezultatet e të nxënimit sipas temës:</b>            Identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta.            Vëzhgon dhe krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre.            Demonstron bashkëpunim gjatë punës në grup.            Mëson se lënda mund të jetë në gjendje të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë.            Kryen vëzhgimet e duhura dhe të bëjmë krahasime.            Zgjedh mjetet e nevojshme dhe vendos çfarë do të mati.            Mbledh prova dh i lidh ato me njohuritë dhe kuptimin shkencor..            Shpjegon se çfarë tregojnë provat dhe nëse ato i vërtetojnë parashikimet.            Paraqet rezultatet nëpër tabela dhe vizatime.            Dallon prirjet dhe modelet e thjeshta tek rezultatet dhe të gjen shpjegimet e duhura për ato.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> derdhet, flluskë</p>	
<p><b>Burimet e mjete:</b> pak ujë, enë të formave të ndryshme, shiringë pa age, një ngrirës, lodër që bën flluska</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte, Matematikë, Edukim Fizik</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>Diskutim:</b> Disa prej nxënësve prezantojnë dhe argumentojnë përfundimet e detyrave të shtëpisë.            Nxënësit emërtojnë tri gjendjet e lëndës: e ngurtë, e lëngët, e gaztë.            Drejtohen pyetjet: <i>A mund ta ndryshojmë formën e një trupi të ngurtë?</i> Nxënësit japin mendimet e tyre. Më pas ftohen të provojnë të ngjeshin tavolinën, karrigen ose lapsin. Tregojnë nëse e ndryshuan dot formën e tyre. Rikujtohet me nxënësit forma e vendosjes së grimcave te trupat e ngurtë. Sqarohet se midis grimcave nuk ka hapësirë, ato nuk e ndryshojnë pozicionin kur trupi ngjishet. Për këtë arsye ai nuk e ndryshon formën.  <i>Çfarë do të ndodhë nëse hedhim pak ujë në një sipërfaqe të sheshtë?</i> Kryhet prova duke hedhur pak ujë në një pjatë të madhe ose tabaka. Më pas nxënësit do të tregojnë çfarë ndodhi. Prezantohet situata e dy personazheve në libër dhe drejtohet pyetja: <i>A mund ta ndryshojmë formën e lëngut?</i> Paraqiten disa enë bosh dhe një enë me ujë. <i>Çfarë do të ndodhë nëse ujin që është në enë e hedhim në këto dy enët e tjera?</i> Nxënësit japin paraprakisht mendime.  <b>Hetim:</b> U jepet nxënësve pak kohë për të diskutuar atë çka do të bëjnë. Ata mund të vendosin çfarë mjeteesh do të përdorin, si do ta realizojnë hulumtimin dhe mënyrën se si do t'ua shpjegojnë përfundimet e tyre shokëve të klasës. Nga secili grup zhvillohet prova. Pasi ta kenë derdhur ujin nëpër enët me forma të ndryshme ata duhet të jenë në gjendje të dalin në pohimin se uji merr formën e enës ku futet.  <i>A mund të ndryshojmë formën e gazit? Cila është mënyra?</i> Dëgjoen mendimet paraprake të nxënësve.</p>			

**Hetim:** Për këtë hetim nxënësit do të punojnë dhe me ushtrimin 3.3a. Nxënësit do ta tërheqin pistonin deri atje ku lexon 10ml. Në këtë mënyrë shiringa ka brenda 10ml ajër. Nxënësit do ta mbulojnë majën e hapur të shiringës me një gisht që e kanë të lirë dhe pastaj ta shtyjnë pistonin me sa fuqi të munden. Ata duhet të shohin nëse do të arrijnë ta shtyjnë pistonin poshtë shenjës 10ml për të ngjeshur ajrin.

Kjo veprimtari tregon qartë se gazet mund të shtypen/ngjishen shumë më lehtë se sa lëngjet, ndërsa trupat e ngurtë është pothuajse e pamundur që të ngjishen. Gjithashtu kjo është një mundësi shumë e mirë për të praktikuar leximin e shiringave.

Tani nxënësit duhet ta shtyjnë pistonin brenda shiringës deri në fund. Fundi i hapur i shiringës duhet vendosur brenda në ujë. Më pas ata do ta tërheqin pistonin derisa ta mbushin me 12 ml ujë. Ata do të vërejnë se së bashku me ujin kanë futur edhe pak ajër. Nxënësit do të zënë me gisht majën e hapur të shiringës dhe pastaj ta shtyjnë pistonin brenda me sa fuqi që kanë. Ata duhet të përpiqen ta ulin pistonin poshtë shenjës 10 ml dhe të thonë nëse kjo është më e lehtë apo më e vështirë se sa ngjeshja e ajrit.

Tani nxënësit do ta mbushin shiringën me ujë dhe ta futin atë në ngrirës për ta ngrirë ujin. Pasi uji të ketë ngrirë, ata duhet të përpiqen ta ngjeshin akullin duke shtyrë pistonin.

**Përfundime:** Duke bërë krahasimin midis ngjeshjes së lëngjeve dhe ngjeshjes së gazeve brenda një hapësire të kufizuar, rikujtohet vendosja e grimcave të lëngjet dhe të gazet për të dalë nxënësit në përfundime se gazi merr formën e enës ku futet dhe është me e lehtë të ngjeshësh gazin se sa lëngun.

U prezantohet nxënësve figura në faqen 43 të librit. Ftohen nxënësit të tregojnë se çfarë shohin në figurë. *Si mendoni ju, çfarë ka brenda fluskave? Çfarë del nga fluska kur ajo çahet?* Sqarohet se gazi ndodhet brenda fluskës dhe kur fluska çahet gazi përhapet.

**Lojë:** Luajmë me fluska. Nxënësit kanë nga një lodër që bën fluska dhe luajnë me njëri tjetrin duke i bërë dhe shpuar fluskat. Pasi lihen të luajnë për disa minuta nxënësve ju tërhiqet vëmendja dhe diskutohet duke iu drejtuar pyetje: Çfarë gazi kanë fluskat brenda? Çfarë ndodh me gazin kur fluskat çahen?

**Përfundime:** Në fletore nxënësit do t'u japin përgjigje pyetjeve të librit. Më pas diskutohen së bashku përgjigjet e dhëna.


Në lidhje me pyetjen: Pse disa trupa të ngurtë mund ta ndryshojnë formën me anë të ngjeshjes, nxënësve ju vihet në ndihmë duke marrë shembull plastelinën. Plastelina është përzierje lëndësh të ngurta dhe të lëngëta. Kjo është arsyeja që ato i zotërojnë vetitë e të dyjave. Një send tjetër që mund të marrë forma të ndryshme është edhe jastëku. Jastëku ka në përbërje një material të ngurtë dhe ajër. Kjo është dhe arsyeja që ai mund ta ndryshojë formën e tij.

**Detyra:** Punimi i faqes 28 të Fletores së punës.

**Shënim:** Loja me fluska për arsye hapësire dhe pastërtie mund të zhvillohet në oborrin e shkollës.


## Ora 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
Tema mësimore: Shkrija, ngrirja dhe vlimi		Situata e të nxënit: Çfarë ndodh?	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>  Hulumton ndryshimet që pësojnë materialet kur ngrohen dhe ftohen.  Mëson se shkrija është procesi i kalimit të lëndës nga gjendja e ngurtë në gjendje të lëngët dhe se kjo është e kundërta e ngrirjes.  Vëzhgon procesin e kalimit të ujit në avull kur ngrohet, dhe përsëri nga avulli në ujë kur ftohet.  Kryen vëzhgimet e duhura, mbledh prova dhe bën krahasime.  Identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta.  Vëzhgon dhe krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre.  Heton dhe shpjegon tretjen e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në tretje.  Demonstron bashkëpunim gjatë punës në grup.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> shkrija, ngrirje, avull, vloj, kondensohet</p>	
<p><b>Burimet e mjete:</b> kuba akulli, enë gatimi, pllakë gatimi, një enë me ujë që vlon, pasqyrë, enë plastike, ftohës etj.</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>Imagjinatë e drejtuar:</b> Lexohet përralla “Ariu me akullorë”. Diskutohet pyetja e ariut: <i>Kush e hëngri akulloren?</i> Nxënësit duhet të dalin në përfundim se akullorja shkriu nga ngrohtësia e diellit. Diskutohen rastet kur është shumë ftohtë dhe ka akull. <i>Çfarë ndodh kur del dielli dhe temperaturat ngrihen?</i>  <b>Mbajtja e strukturuar e shënimeve:</b> Gjatë zhvillimit të hetimeve në dërrasë dhe nxënësit në fletore do të shkruajnë në formë të strukturuar shndërrimet që do të vënë re.  <b>Hetim:</b> Në një enë janë vendosur disa copa akulli. <i>Drejtohet pyetja: Çfarë do të ndodhë me akullin nëse enën e vëmë mbi pllakën e gatimit?</i> Nxënësit japin mendime ndërkohë që ngrohet ena me copat e akullit brenda.  <b>Përfundime:</b> Pasi të jenë ngrohur kubat e akullit hiqet ena nga zjarri. Pyeten nxënësit se çfarë vunë re. Në dërrasë shkruhen përfundimet</p> <div style="text-align: center; margin: 10px 0;"> <pre> graph LR     A["akull (gjendje e ngurtë)"] -- ngrohet --&gt; B["ujë (gjendje e lëngët)"] </pre> </div> <p>Shpjegohet se në gjendjen e ngurtë grimcat e ujit janë të ngjeshura me njëra tjetrën. Gjatë ngrohjes ato marrin energji dhe kalojnë nga disa grimca të lidhura ngushtë dhe që dridhen në një pikë të caktuar në grimca pak më të lira që mund të rrëshqasin mbi njëra-tjetrën.  <b>Hetim:</b> Ngrohet uji derisa të vlojë. Kërkohet nga nxënësit të vëzhgojnë me kujdes ndryshimet tek uji. Vendoset pasqyra në mënyrë që nxënësit të mund ta shohin avullin kur prek në sipërfaqen me shkëlqim. Mbahet pasqyra mbi enën plastike që të kapni pikat e ujit.  <b>Përfundime:</b> Pyeten nxënësit se çfarë vunë re. Në dërrasë shkruhen përfundimet: avulli u kthye në lëng, kjo do të thotë se ai u kondesua.</p>			



Shpjegohet se në gjendjen e gaztë grimcat e ujit janë larg njëra tjetrës. Gjatë ftohjes ato humbasin energji dhe kalojnë nga disa grimca më të lira në grimca që mund të rrëshqasin mbi njëra-tjetrën.

**Hetim:** Demonstrrohet uji i futur në akull në frigorifer. Pyeten nxënësit se *çfarë vënë re*. Në dërrasë shkruhen përfundimet: uji u kthye në akull, kjo do të thotë se ai ngriu.



Shpjegohet se në gjendjen e lëngët grimcat e ujit mund të rrëshqasin mbi njëra-tjetrën. Gjatë ftohjes ato humbasin energji dhe kalojnë nga disa grimca që mund të rrëshqasin mbi njëra-tjetrën në grimca që dridhen në një pikë të caktuar.

Diskutohen së bashku përfundimet e dhëna në rubrikën “Mësuam se”

**Punë individuale:** Nxënësit duke u bazuar në përfundimet e nxjerra do të punojnë individualisht përgjigjet e pyetjeve të mësimi.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për mendimet e dhëna gjatë diskutimeve dhe për interpretimin e argumentimin e mendimit.

**Detyra:** Punimi i faqes 29 të Fletores së punës

**Refleksion:** Ushqimi yt i preferuar hahet i ngruhtë apo i ftohtë?

**Shënim:** Që në fillim të orës nxënësit shohin enën me ujë në gjendje të lëngët e cila do të futet në frigorifer për tu parë më vonë se çfarë ka ndodhur me ujin.

Tërhiqet vëmendja e nxënësve në kujdesin që duhet të kenë me nxehtësinë gjatë të gjitha rasteve të hetimit.

Një tjetër shembull që mund të përdoret për të treguar proceset e shkrirjes dhe ngrirje është dhe qiri. Demonstrimin e të cilit mund të kryhet në varësi të kushteve në klasë, pasi duhet ajrosur ambienti.

## Ora 7

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Shkrirja e lëndëve të ndryshme		<b>Situata e të nxënit:</b> Cila nga lëndët do të shkrijë e para?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Hulumton ndryshimet që pësojnë materialet kur ngrohen dhe ftohen. Mëson se shkrirja është procesi i kalimit të lëndës nga gjendja e ngurtë në gjendje të lëngët dhe se kjo është e kundërta e ngrirjes. Vëzhgon procesin e kalimit të ujit në avull kur ngrohet, dhe përsëri nga avulli në ujë kur ftohet. Kryen vëzhgimet e duhura, mbledh prova dhe bën krahasime. Identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta.			<b>Fjalë kyçe:</b> ar, material

<p>Vëzhgon dhe krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre. Heton dhe shpjegon tretjen e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në tretje. Demonstron bashkëpunim gjatë punës në grup.</p>	
<p><b>Burime dhe mjete:</b> një kub akulli, një copë çokollatë, një copë gjalpë, tre tiganë, tri pllaka gatimi, orë digjitale.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe)</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Prezantim dhe diskutim i përfundimeve të dala nga punimi i faes 29 të Fletores së punës. Theksohen shndërrimet dhe temperaturat në të cilat kanë ndodhur këto shndërrime.</p> <p><b>Brainstorming:</b> Përmendin disa lëndë të tjera të ngurta që keni në shtëpi dhe që mund të shkrijnë. Nëse nxënësit kanë vështirësi orientohen të mendojnë lëndë ushqimore si gjalpin, margarinën, akulloren ose sheqerin.</p> <p>Paraqiten para nxënësve: një kub akulli, një copë çokollatë, një copë gjalpë, tre tiganët, tri pllakat e gatimit dhe ora digjitale/kronometër.</p> <p><b>Përgatitje për zhvillimin e eksperimentit:</b> Drejtohet pyetja: <i>Si mendoni ju çfarë mund të bëjmë me to? Krahasoni tiganët, si janë ata? Krahasoni pllakat e gatimit, si janë ato?</i> (Sqarohen nxënësit se pllakat e gatimit japin të njëjtën nxehtësi) <i>Krahasoni copën e gjalpës me atë të çokollatës, ç'mund të thoni për to? Nëse ne i ngrohim, kush do të shkrijë më parë?</i> Nxënësit do të shkruajnë në fletore parashikimin se cila prej substancave do të shkrijë e para kur të bjerë në kontakt me nxehtësinë. Ritheksohet që për të kryer një hetim të drejtë duhet që gjalpi dhe margarina të kenë të njëjtën madhësi/sasi. Gjalpi dhe margarina duhet të kenë të dyja të njëjtën temperaturë kur të filloni, për shembull, duhet të kenë dalë të dyja prej ngrirësës. Duhet përdorur e njëjta pllakë sobe për të ngrohur gjalpin dhe margarinën. Tigani duhet të jetë i njëjtë dhe duhet të jetë i ftohtë në fillim për secilën nga substancat. Përdoret e njëjta orë ose kronometër për të matur kohën e shkrirjes për secilën.</p> <p><b>Hetim:</b> Secila nga substancat do të fillojë të ngrohet në të njëjtën kohë. Nxënësit do të shohin kronometrin dhe do të shënojnë orën e fillimit. Gjatë eksperimentit nxënësit do të mbledhin prova dhe do të kryejnë vëzhgime. Ata do të matin kohën, rezultatet e së cilës do të shkruhen në fletore.</p> <p>Me të dhënat e mbledhura nxënësit do të ndërtojnë një grafik me shtylla për të demonstruar dhe interpretuar nëpërmjet grafikut përfundimet. Për ndërtimin e grafikut nxënësit mund të punojnë në ushtrimin 3.5.</p> <p><b>Përfundime:</b> Nxënësit mund të interpretojnë në grupe dyshe grafikët e ndërtuar. Disa prej nxënësve do të bëjnë demonstrim dhe interpretim së bashku me gjithë klasën.</p> <p><b>Diskutim:</b> Drejtohet pyetja: <i>A shkrijnë metalet?</i> Nëpërmjet figurave të paraqitura në faqen 47 të librit sqarohen nxënësit se metalet në temperatura shumë të larta shkrihen dhe më pas ngurtësohen përsëri, i tillë është dhe shembulli i arit. Ftohen nxënësit të interpretojnë skemën e dhënë në libër mbi shndërrimet që ndodhin me arin. Pse koha e shkrirjes nuk është e njëjtë për çdo lëndë? Vihen nxënësit të mendojnë mbi faktin që ata tashmë e dinë se lënda përbëhet nga grimcat. <i>Por, a kanë të gjitha lëndët në përbërje të tyre të njëjtin lloj grimcash?</i> Nëse përgjigja e tyre është se lëndë të ndryshme përbëhen nga grimca të ndryshme, atëherë për ata nuk do të ishte e vështirë të kuptonin se grimcat e ndryshme reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj nxehtësisë, prandaj dhe koha që u nevojitet substancave për të shkrirë nuk është e njëjtë.</p>	

<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet e dhëna gjatë diskutimeve, për hedhjen dhe interpretimin e të dhënave në grafikë. Gjatë diskutimit në dyshe nxënësit do të vetëvlerësojnë punën e tyre.
Detyra: Punimi i faqes 30 të Fletores së punës.
<i>Shënim:</i> Në varësi të kohës së integruar me orën e Edukimit fizik nxënësit mund të luajnë lojën “Ngriva-shkriva”

## Ora 8

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Pika e shkrirjes dhe pika e vlimit		<b>Situata e të nxënët:</b> Sa është temperatura?	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b> Vëzhgon dhe krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre. Heton dhe përshkruan përzierjen e lëndëve të ndryshme dhe ndarjen e tyre. Heton dhe shpjegon tretjen e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në tretje. Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e lëndëve Demonstron bashkëpunim gjatë punës në grup.		<b>Fjalë kyçe:</b> pikë e shkrirjes, pikë e vlimit	
<b>Burime dhe mjete:</b> ujë, gotë, kupa akulli, enë, pllakë gatimi		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe)	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Përvijim i të menduarit:</b> Kërkohet nga nxënësit të tregojnë/emërtojnë objekte të ndryshme prej ari. Drejtohet pyetja: <i>Si arrihet të jepen këto forma?</i> Ftohen nxënësit të rishohin figurat në faqen 47 të librit. Shpjegohet se të gjitha metalet duhet të shkrihen para se të përdoren. Është e rëndësishme që përpunuesit e metaleve të njohin temperaturat e shkrirjes së çdo metali. Në një tabelë demonstrohen lloje të ndryshme metalesh dhe temperaturat e ndryshme. Sqarohen nxënësit se në përgjithësi çdo lëndë shkrin dhe vlon, por për lëndë të ndryshme nevojitet sasi nxehtësie e ndryshme. Temperatura e një lënde tregon se sa e nxehtë është ajo. Shkruhet në tabelën e fjalëve: pika e shkrirjes- temperatura në të cilën shkrin lënda; pika e vlimit- temperatura në të cilën vlon lënda. Ftohen nxënësit të tregojnë nëse i kanë dëgjuar më parë këto dy terma. Nëse po si mund t’i tregojnë me shembuj nga jeta e përditshme. <b>Hetim:</b> Matja e temperaturës së ujit. Fillimisht nxënësit do të udhëzohen dhe praktikohen në leximin e termometrit. Mësuesja udhëzon dhe demonstron dhe më pas ata do t’i tregojnë njëri tjetrit me termometër temperaturën që tregon termometri dhe si orientohet ai. <b>Hapi 1:</b> Hedhim pak ujë në gotë dhe me termometër matim temperaturën e tij. Temperatura do të shënohet në fletore e shoqëruar me njësinë e matjes °C (sqarohet për nxënësit njësia e matjes së temperaturës).			



<p>Shpjegohet se kjo temperaturë është temperatura e ujit në temperaturën e dhomës.</p> <p><u>Hapi 2:</u> Vendosen kuba akulli në një tigan dhe e ngrohim ngadalë atë. Sapo kubat të shkrijnë plotësisht matet temperatura e ujit dhe shënohet në fletore. Tërhiqet vëmendja që shënimi i temperaturës të shoqërohet dhe me njësinë matëse.</p> <p>Shpjegohet se kjo temperaturë është pika e shkrirjes.</p> <p><u>Hapi 3:</u> Uji në tigan vazhdon të nxehet deri sa të vlojë. Me kujdes matet temperatura e ujit. Shpjegohet se kjo është pika e vlimit. Temperatura e pikës së vlimit shënohet në fletore.</p> <p><b>Përfundime:</b> Njëpërmjet pyetjeve nxënësit do të përshkruajnë procesin dhe tregojnë përfundimet.</p> <p>Sa ishte temperatura e pikës së shkrirjes së akullit? Sa ishte temperatura e pikës së vlimit të ujit? Sa ishte temperatura e ujit në temperaturën e dhomës? Pika e shkrirjes së akullit është 0°C, kurse pika e vlimit të ujit është 100°C.</p> <p>Nxënësit do të paraqesin në grafik me shtylla temperaturat që matën. Bëhet krahasimi i temperaturave të matura me faktet se: Pika e shkrirjes së akullit është 0°C, kurse pika e vlimit të ujit është 100°C. Nëse nuk janë të njëjta diskutohet, pse nuk janë.</p> <p>Ftohen nxënësit të tregojnë me anë të vizatimit të modelit të grimcave, pikën e shkrirjes së ujit. Disa prej nxënësve demonstronë dhe shpjegojnë vizatimet e tyre.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësimi kryhet gjatë diskutimeve dhe nxënësit do të bëjnë një vetëvlerësim duke kontrolluar paraqitjen e përfundimeve në grafikë e vizatime.</p>	
Detyra: Punimi i faqes 31 të Fletores së punës.	Refleksion:
Shënim:	

## Ora 9

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Tretja e lëndëve		<b>Situata e të nxënësve:</b> Përftojme tretësirë.	
<p><b>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</b></p> <p>Identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta.</p> <p>Heton dhe përshkruan përzierjen e lëndëve të ndryshme dhe ndarjen e tyre.</p> <p>Heton dhe shpjegon tretjen e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në tretje.</p> <p>Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e lëndëve</p>		<b>Fjalë kyçe:</b> tretet, e patretshme, tretësirë, lëndë e tretshme, tretës, kristale	
<b>Burime dhe mjete:</b> enë qelqi, ujë, kristale sulfat bakri, pllakë gatimi.		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art,	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**Diskutim për njohuritë paraprake:** Ftohet një nxënës të marrë pjesë në demonstrim. Tregohet një gotë qelqi me ujë të pijshëm. Pyeten nxënësit çfarë dallojnë ata, se çfarë ka në gotë? Gota me ujë i jepet nxënësit të provojë dhe aprovojë çfarë është lëngu në gotë. Në gotën me ujë hedhim pak sheqer. Ftohen nxënësit të shohin dhe të përshkruajnë çfarë ndodh me sheqerin. *Si mendoni se do të jetë shija e ujit tani?* Pas mendimeve të dhëna, nxënësi që ndihmon në demonstrim provon ujin dhe tregon për shijen e tij. (i ëmbël)

**Shpjegim i përparuar:** Sqarohen nxënësit se disa lëndë mund të treten në ujë ose lëngje të tjera. Ajo që përftohet në këto raste nga tretja e një lënde quhet tretësirë. Në rastin tonë tretësira e formuar ishte uji i ëmbël me sheqer. Një tretësirë përbëhet nga: lënda e tretshme (sheqeri) dhe tretësi (uji).

**Hetim:** Demonstron veprimtaria para nxënësve dhe ata do të mbajnë shënim në fletore për çfarë do të ndodhë.

Në një enë, të mbushur deri në ¾ e saj me ujë, hedhim disa kristale të sulfatit të bakrit. Të orientuar nga pyetjet, nxënësit vizatojnë dhe emërtojnë vëzhgimet e tyre: *Çfarë vëreni rreth e përçark kristaleve të sulfatit të bakrit kur ato janë në ujë? A i shihni tani kristalet e sulfatit të bakrit në ujë? Cila është lënda e tretur dhe cili është tretësi?*

Në dyshe dhe më pas me gjithë klasën diskutohen përgjigjet e pyetjeve.

**Hetim:** Ndikimi i temperaturës në tretje. Merren dy gota qelqi me ujë. I tregohet nxënësve gota me temperaturë ambientit dhe gota me ujë të vakët. Udhëzohen të shohin dhe krahasojnë se çfarë ndodh në të dyja gotat, kur në to njëkohësisht hidhen kristale të sulfatit të bakrit. Përsëri nxënësit shënojnë në fletore vëzhgimet e tyre dhe i interpretojnë ato duke u dhënë përgjigje pyetjeve: *Në cilën enë treten më mirë kristalet? Pse? A mund të sugjeroni dy faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në shpejtësinë e tretjes?* Në raste pasigurie u rikujtohen nxënësve veprimet që kryejnë në jetën e përditshme si: përzierja me lugë për tretjen e sheqerit në çaj, apo shtimi i sasisë së çajit në gotë.

**Lojë:** Duke drejtuar deri në 5 pyetje do të gjejnë çfarë tretësire është. Njëri mendon dhe e shkruan tretësirën në një fletë, të tjerët drejtojnë me radhë pyetje mbi përbërësit e tretësirës dhe tretësit për ta gjetur tretësirën e përcaktuar më parë. Kujdes, në rastet kur lënda e tretshme nuk është e tretshme tek tretësira!

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për mendimet dhe argumentet e dhënë gjatë diskutimeve.

**Detyra:** A formohet tretësirë nëse hedhim sodë buke në ujë? Pse?

**Refleksion:** Kujto kur ke formuar një tretësirë së fundmi?

**Shënim:** Nxënësit me ndihmën e prindërve mund ta kryejnë në shtëpi provën e dhënë për detyrë.

## Ora 10

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Përzierja e lëndëve dhe ndarja e tyre		<b>Situata e të nxënit:</b> Si ndahet uji nga kripa e detit?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Vëzhgon dhe krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre. Heton dhe përshkruan përzierjen e lëndëve të ndryshme dhe ndarjen e tyre. Heton dhe shpjegon tretjen e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në tretje. Tregon objektivitet, kur kërkon informacion dhe të dhëna që i bëjnë të vlefshme vëzhgimet dhe shpjegimet për vetitë dhe përdorimet e lëndëve Demonstron bashkëpunim gjatë punës në grup.		<b>Fjalë kyçe:</b> përziehet, ndahet, sitje, filtrim, letër filtruese	
<b>Burime dhe mjete:</b> Sitë, rërë, zhavor, letër filtruese, hinkë, enë qelqi, ujë, pllakë gatimi		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Prezantime:</b> Disa nxënës me dëshirë prezantojnë hetimin e kryer prej tyre në shtëpi dhe përfundimet e arritura. Krahasohen përfundimet me nxënësit e tjerë. <b>Shpjegim i përparuar.</b> Në rastin kur kemi lëndë të ndryshme të cilat nuk treten me njëra tjetrën por mund të përzihen, si në rastin e përzierjes së miellit me kokrrat e grurit. Përzierje të ndryshme lëndësh kanë forma të ndryshme për t'u ndarë nga njëra tjetra. Kështu: <u>Prova 1:</u> Demonstrrohet sitja e zhavorit dhe ndarja e rërës prej tij. Nxënësit e paraqesin me anë të vizatimit në fletoren e tyre. Në vizatim duke prezantuar procesin e sitjes ata duhet të përcaktojnë dhe emërtimin e pjesëve përbërëse. <u>Prova 2:</u> Lëndët e ngurta që nuk treten në lëngje mund të ndahen me anë të filtrimit. Një përzierje e rërës me ujë do të kalojë nëpërmjet filtrit duke demonstruar ndarjen e ujit nga rëra. <i>Kush do të derdhet në enën e qelqit? Çfarë do të mbetet në filtër?</i> Dhe për këtë provë nxënësit mbajnë shënime në fletoret e tyre. <u>Prova 3:</u> Lëndët e ngurta të tretshme në ujë ndahen nga uji me anë të avullimit. Kujtohet së bashku se çfarë dimë për avullimin. Ftohen nxënësit të parashikojnë se <i>çfarë do të ndodhë kur të ngrohim tretësirën e ujit me kripë. Sa kohë mund të duhet?</i> Zhvillimi i provës me një tretësirë me ujë me kripë e cila ngrohet derisa të avullojë i gjithë uji. <i>Çfarë ndodhi? Çfarë mbeti në enë?</i> <b>Përfundime:</b> Të organizuar në grupe me nga katër vetë, nxënësit organizojnë dhënieje e përgjigjeve të pyetjeve të mësimin në formën e prezantimit të një projekti vëzhgimet e të cilit i kanë kryer. Diskutojnë së bashku dhe një nga përfaqësuesit e secilit grup jep përfundimet e grupit. Ftohen nxënësit të japin mendime duke i argumentuar se si mund të ndajnë nga njëri tjetri ujin me rërën dhe kripën nga uji.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mendimet dhe argumentet e dhënë gjatë diskutimeve.			
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 32 në Fletoren e punës			
<i>Shënim:</i>			

## Ora 11

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj.		<b>Situata e të nxënit:</b> Unë di.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimëve dhe veprimtarive të punuara. Prezanton me forma të ndryshme njohuritë e marra dhe aftësitë e qëndrimet e fituara.		<b>Fjalë kyçe:</b> lëng, formë, gjendje	
<b>Burime dhe mjete:</b> enciklopedi		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art, Edukim fizik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i><b>Lojë:</b> lëng, gaz, i ngurtë.</i> Në klasë tregohen tri hapësira të ndryshme larg njëra tjetrës. Secila prej hapësirave ka një përcaktim: hapësira për gjendjen e lëngët, hapësira për gjendjen e gaztë dhe hapësira për gjendjen e ngurtë. Secili nxënës do të shkruajë në një copë letër emrin e një lënde dhe do ta këmbëjë letrën me shokun. Ky i fundit do të lexojë llojin e lëndës së shkruar dhe do të shkojë në hapësirën përkatëse të klasës. Pasi formohen grupet në hapësira, përfaqësuesit lexojnë emërtimet e lëndëve që ju kishin rënë. Gjatë leximit nëse dikush ka gabuar hapësirë mund ta ndërrojë atë. Udhëzohen nxënësit se do të sillen si grimca në hapësira. Kështu, sapo mësuesja të thotë trup i ngurtë, nxënësit e kësaj hapësire do të vendosen ashtu si grimcat në këto raste. Po e njëjta gjë dhe me dy grupet e tjera. <i><b>Punë e pavarur:</b></i> Plotësim i rubrikave të dhëna në faqen 54-55 në libër. Krahasim dhe diskutim në dyshe të plotësimeve të tyre. Përfaqësues të dysheve prezantojnë përfundimet për secilën rubrikë. <i><b>Shkrim i shpejtë:</b></i> Nxënësit do të tregojnë situatën më interesante për ta në lidhje me këtë grup temash. Sipas dëshirës nxënësit i lexojnë për t'i ndarë me njëri tjetrin ato.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësimi në punimin e rubrikave të librit, argumentimin e mendimeve dhe qëndrimeve që mbajnë.			
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 33 të Fletores së punës.			
<i>Shënim:</i>			

# KAPITULLI 4

## Tingulli

### Ora 1

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Përhapja e tingullit përmes materialeve të ndryshme.		<b>Situata e të nxënit:</b> Çfarë dëgjon?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme. Hulumton se tingulli: a) përhapet nga një burim dhe dëgjohe kur arrin në veshin tonë. b) përhapet përmes një mjedisi lëndor. c) përhapet përmes materialeve të ndryshme lëndore. d) përhapet më mirë përmes trupave të ngurtë. e) dëgjohe kur arrin në veshin tonë. f) dobësohet kur largohemi nga burimi që e prodhon atë. Shpjegon se tingulli prodhohet kur trupat dridhen në mjedis dhe shkakton ngjeshjen apo rrallimin e shtresave të mjedisit. Shpjegon se tingulli dëgjohe kur dridhjet arrijnë në veshin tonë.		<b>Fjalë kyçe:</b> burim, përhapet	
<b>Burimet e mjete:</b> spango, dy kuti metalike		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art, Teknologji	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Brainstorming:</b> Përmendni disa burime tingujsh. Së bashku me nxënësit mund të krijoni vetë tinguj p.sh.: duke kënduar, duke përplasur duart etj. Drejtohet pyetja: <i>Çfarë ndodh kur tingulli largohet nga burimi i tij?</i> Për t'u orientuar nxënësit, tërhiqet vëmendja duke i vënë të mendojnë nëse tingulli është më i fortë pranë apo larg burimit. Përgjigja e duhur do të ishte që tingulli fillon të zbehet kur largohet nga burimi. Shpjegohet se zëri mund të udhëtojë përmes çdo lloj lënde, por jo në zbrazëtirë. Kjo është arsyeja që në hapësirë nuk ka tinguj. U rikujtohet nxënësve që tingulli udhëton nëpërmjet ajrit. Udhëzohen nxënësit të bazohen tek përvojat e tyre për të kuptuar se tingulli udhëton gjithashtu edhe përmes lëndëve të tjera të ndryshme nga ajri. Për ta vërtetuar këtë mjafton që ata të bëjnë disa prova në rrethana të ndryshme, si për shembull: duke mbështetur një gotë pas murit për të dëgjuar se ç'ndodh në klasën ngjitur, ose duke mbështetur veshin mbi bankë për të dëgjuar një trokitje të lehtë në anën e poshtme të saj. Ftohen të provojnë një telefon të ndërtuar nga vetë ata. <b>Veprimtari:</b> "Si të bëjmë një telefon me kuti metalike". Ftohen nxënësit të shohin figurat e faqes 56 në libër. Komentohen figurat e paraqitura për të bërë një përshkrim të veprimeve që do të kryejnë dhe mënyrës që do t'i kryejnë. Gjatë këtij përshkrimi mësuesja me ndihmën e një nxënësi mund ta shoqërojë me demonstrim. Në dyshe nxënësit sigurohen se i kanë të gjitha mjetet dhe punojnë për ndërtimin e telefonit. Gjatë kësaj kohe nxënësit ndihmohen për realizimin e telefonit dhe për kryerjen e provës.			

<p>Diskutohet dhe shpjegohet mënyra se si funksionon një telefon i ndërtuar me kënaçe bosh. Kur ju flisni në kënaçe, dridhjet e zërit kalojnë nga kënaçja tek teli. Kur teli tendoset, dridhjet e zërit udhëtojnë nëpërmjet telit të tendosur për tek kënaçja në krahun tjetër. Zëri mbërrin në veshin e personit që ndodhet në anën tjetër të telefonit, i cili ia dërgon më pas këtë informacion trurit. Gjatë shpjegimit në dërrasë vizatohet një skemë e thjeshtë rrjedhëse e lëvizjeve të tingullit në një telefon me kënaçe:</p> <p><u>burimi i tingullit</u>: zëri juaj → teli → veshi i shokut tuaj</p> <p><b>Pyetje-përgjigje:</b> Nxënësit japin mendimet e tyre lidhur me pyetjet: <i>Cili është burimi i tingullit në telefonin me kuti metalike? Përmes cilave materiale përhapet tingulli në këto telefona? Pse banorët e hershëm të Amerikës shtriheshin me veshin ngjitur pas tokës, për të dëgjuar ardhjen e armiqve apo të kafshëve që gjuanin? Si mendoni, pse në hapësirë është heshtje e plotë?</i></p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për përfshirjen dhe bashkëpunimin në realizimin e telefonit, si dhe mendimet e dhëna gjatë diskutimeve.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Plotësimi i faqes 34 të Fletore Pune Për nxënësit me arritje të larta sugjerohet punimi i ushtrimit 4.1</p>	<p><b>Refleksion:</b> Si u ndjetë kur dëgjuat zërin e shokut në telefonin që ndërtuat vetë?</p>
<p><i>Shënim:</i> Në ndërtimin e telefonit me kuti metalike, për çështje sigurie, mirë është që vrima tek kutia të jetë e hapur paraprakisht nga një i rritur.</p>	

## Ora 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<p><b>Tema mësimore:</b> Tingulli përhapet përmes materialeve të ndryshme.</p>		<p><b>Situata e të nxënit:</b> Si përhapet tingulli?</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme. Hulumton se tingulli: a) përhapet nga një burim dhe dëgjohe kur arrin në veshin tonë. b) përhapet përmes një mjedisi lëndor. c) përhapet përmes materialeve të ndryshme lëndore. d) përhapet më mirë përmes trupave të ngurtë. Tregon se disa materiale nuk e lejojnë kalimin e tingullit përmes tyre.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> tingull, material</p>	
<p><b>Burimet e mjete:</b> orë me tiktak, një tullumbace e mbushur me ujë, një pllakë druri ose derë druri.</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutohen me nxënësit përfundimet e rubrikës së dytë të fletores së punës. Prezantohen përfundimet e arritura nga ndërtimi dhe krahasimi i telefonave të ndërtuar me gota letre. <i>Çfarë ishte ndryshe në hulumtimin tuaj? A ishte i njëjtë tingulli që dëgjuat nëpërmjet telefonit me gota kartoni me atë me kuti metalike?</i> <b>Diskutim për njohuritë paraprake:</b> Pyeten nxënësit se si arrin tingulli i borive të makinave në rrugë të mbërrijë deri tek veshët tanë. <i>Nëpërmjet çfarë lëndësh apo sendesh duhet të kalojë tingulli? A ju ka ndodhur ndonjëherë që duke notuar në ujë të kenë dëgjuar ndonjë tingull? A ishin ata tingujt të fortë apo të butë?</i></p>			

**Kërkim:** Si përhapet tingulli përmes materialeve të ndryshme. Para se nxënësit në dyshe të zhvillojnë veprimtarinë kërkohet prej tyre të shtrojnë një pyetje të cilën mund ta hulumtojnë, për të zbuluar se cilat janë materialet që e përçojnë më mirë tingullin. Më pas ata do të parashikojnë materialet përmes të cilave mendojnë se zëri udhëton më mirë. Udhëzohen të mbajnë shënim parashikimet e tyre.

Gjatë kërkimit nxënësit do të dallojnë mënyrën se si përçohet tiktaku i orës (zëri) përmes materialeve të ndryshme: ajri, tullumbaces me ujë, jastëkut. Ata do të mbledhin prova, do të kryejnë vëzhgime dhe do të bëjnë krahasime midis aftësisë përcjellëse të tingullit tek këto materiale të ndryshme. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të dallojnë ndonjë model të mundshëm tek rezultatet, gjë e cila dëshmon se tingulli përcillet më mirë përmes lëndëve të ngurta, më pak përmes lëngjeve dhe shumë pak përmes ajrit. Ata mund t'i përforcojnë vëzhgimet e tyre dhe të vërtetojnë se e kanë kuptuar se si realizohet një eksperiment i drejtë duke iu përgjigjur pyetjeve. Gjatë kohës që zhvillohen provat nxënësit në dyshe ndihmohen në realizimin dhe hedhjen e të dhënave për të tria provat. Udhëzohen nxënësit në plotësimin e tabelës bazuar në përfundimet e provës.

**Diskutim i përfundimeve:** Përmes *cilit material u dëgjuan tingujt më mirë?* Krahasohen përfundimet. Nxiten nxënësit të rikujtojnë organizimin e grimcave në lëndë të ndryshme. Bazuar në to të argumentojnë se përse tingulli përhapet më mirë përmes trupave të ngurtë.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit gjatë procesit të kërkimit dhe argumentimit të përfundimeve

**Detyra:** Punimi i faqes 35 të Fletores së punës.  
Punimi i ushtrimit 4. 2

*Shënim:*

## Ora 3 dhe 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Si përhapet tingulli (2 orë)		Situata e të nxënit: kërcimi i orizit	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Hulumton se tingulli: a) përhapet nga një burim dhe dëgjohe kur arrin në veshin tonë. b) përhapet përmes një mjedisi lëndor. c) përhapet përmes materialeve të ndryshme lëndore. Shpjegon se tingulli prodhohet kur trupat dridhen në mjedis dhe shkakton ngjeshjen apo rrallimin e shtresave të mjedisit. Dallon tingujt e lartë nga tingujt e ulët. Dallon tingujt e fortë nga tingujt e butë. Shpjegon se dridhjet e vogla prodhojnë tinguj të butë. Krahason volumin e një tingulli me forcën e tingullit që e shkakton atë. Tregon se volumi i tingullit lidhet me fortësinë dhe butësinë e tingullit.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> një copë qese plastike, disa llastiqe, kokrra orizi, vazo qelqi bosh, tabaka metalike, lugë druri, laps</p>	
<b>Burimet e mjete:</b> gotë plastike		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art (Muzikë)	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**Këndojmë:** Ftohen nxënësit të këndojnë të gjithë një nga këngët e mësuara së fundmi. Udhëzohen që më parë që përgjatë këndimit të refrenit do të vendosin dorën në fyt. Pasi bëhet prova nxënësit do të tregojnë çfarë ndjenë? Ato dridhje që ndjenë në dorën e tyre ishin dridhjet e kordave të zërit të cilat dridhen dhe lëshojnë tinguj.

Tregohen raste kur mund ta shohin dridhjen dhe të dëgjojnë tingullin. Kështu në një gotë me ujë nëse kalojmë gishtin pak të lagur rreth buzëve të holla të gotës do të dëgjohet tingulli dhe valëzimet në ujë të gotës do të tregojë përhapjen e dridhjeve.

**Veprimtari:** Ftohen nxënësit të ndërtojnë një mjet nëpërmjet të cilit do të shohin dridhjet e tingullit. Nxënësit në dyshe do ta mbulojnë grykën e kavanozit me qesen plastike dhe ta fiksojnë atë me një llastik. Ata do të vendosin mbi të disa kokrra orizi, do ta godasin kavanozin anash me një laps dhe do të vëzhgojnë se ç'ndodh me kokrrat e orizit. Kur godasim tepsinë, ajo prodhon tinguj të cilët udhëtojnë nëpërmjet ajrit dhe bëjnë që qesja mbi kavanoz të dridhet. Këto dridhje bëjnë që edhe kokrrat e orizit të dridhen.

Pas kësaj nxënësit do të parashikojnë se çfarë ndikimi do të ketë tek kokrrat e orizit nëse përplasim duart afër kavanozit, dhe të shohin nëse parashikimet e tyre ishin të sakta.

Nxënësit do të vërejnë se kur ata e godasin kavanozin ose tundin tepsinë pranë tij, kokrrat e orizit mbi qese do të lëvizin ose do të dridhen. Shpjegohet se, kur tepsia tundet, prodhohen disa dridhje, të cilat lëvizin nëpërmjet ajrit duke bërë që edhe qesja në grykën e kavanozit të dridhet. Këto të fundit shkaktojnë edhe dridhjen e kokrrave të orizit.

**Hetim:** Si prodhohen tingujt nga dridhjet. Të ndarë në grupe nxënësit do të bëjnë provat e veprimtarive të përshkruara në fletën e aktivitetit 4.3. Udhëzohen nxënësit të veprojnë me llastikën si në figurë. Bëjnë provën dhe u japin përgjigje pyetjeve: *A prodhon llastiku tinguj kur dridhet? Kur llastikun e tërheq më fort çfarë ndodh me përmasat e dridhjeve? Çfarë ndodh me tingullin?* Nxënësit plotësojnë përfundimet në fletën e aktivitetit.

**Hetim:** *A prodhon vizorja tinguj kur dridhet?* Nxënësit do të shkaktojnë dridhje të vizores duke e fiksuar njërin krah të saj mbi bankë dhe duke lëkundur dhe lëshuar krahun tjetër të saj, i cili qëndron pezull në buzë të bankës. Bëhet prova. Shkurtohet gjatësia e vizores që qëndron në ajër. *Çfarë ndodh me përmasat e dridhjeve? Çfarë ndodh me tingullin?*

Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë përfundimet e nxjerra nga hetimet. Krahasohen përfundimet dhe argumentohen gjetjet.

**Përmbledhje:** *Si ishte niveli i tingullit që u prodhuan nga llastiku dhe nga vizorja kur dridhjet ishin më të vogla? Po kur dridhjet ishin më të mëdha si ndryshoi tingulli?*

Sillni ndër mend telefonin që bëtë me kutitë metalike. Cilat nga metalet u drodh kur përdorët telefonin? Si do të vepronit për të ndaluar përhapjen e tingullit në një telefon të përgatitur me kuti metalike?

Rikujtohet se kur dridhen objektet shkaktojnë tinguj. Dridhja është një lëvizje shumë e shpejtë para-mbrapa. Dridhjet përhapen përmes materialeve. Ne i dëgjojmë tingujt kur dridhjet na mbërrijnë në vesh.

**Vlerësimi:** Vlerësohen për përfshirjen dhe bashkëpunimin në realizimin e telefonit, si dhe mendimet e dhëna gjatë diskutimeve.

**Detyra:** Punimi i faqes 36 të Fletores së punës

*Shënim:*



## Ora 5 dhe 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Tingujt e fortë dhe tingujt e dobët (2 orë)		<b>Situata e të nxënët:</b> Tingujt që dëgjojmë	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b> Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme. Dallon tingujt e fortë nga tingujt e butë. Shpjegon se dridhjet e vogla prodhojnë tinguj të butë. Krahason volumin e një tingulli me forcën e tingullit që e shkakton atë. Tregon se volumi i tingullit lidhet me fortësinë dhe butësinë e tingullit.		<b>Fjalë kyçe:</b> i fortë, i dobët	
<b>Burimet e mjete:</b> tub kartoni i gjatë, burim tingulli.		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art (Muzikë), Teknologji	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Lojë:</b> Nxënësit të vendosur në dyshe do të zhvillojnë lojën: Njëri nxënës i thotë diçka në vesh tjetrit. Më pas po të njëjtën gjë ia thotë me zë. Pyeten nxënësit në <i>cilin rast tingulli ishte i butë dhe cilin rast i fortë</i> . Përsëritet loja duke ndërruar radhën. <i>A e kish dëgjuar saktë çfarë ishte thënë?</i> Ftohen nxënësit të shohin figurat në faqen 62 të librit. Përcaktojnë në tri figurat e dhëna se në cilin rast tingulli është i fortë apo i butë. <i>Çfarë e rrit fortësinë e tingullit?</i> Studiohet rruga që bën tingulli në rastin e vajzës që këndon. <b>Shpjegohet:</b> Këngëtarja këndon me mikrofon. Mikrofonit është i lidhur me një amplifikator, i cili e bën zërin më të fortë. Amplifikatori është i lidhur me një altoparlant, nga ku del dhe zëri. Mikrofonit, amplifikatori dhe altoparlanti së bashku formojnë një sistem zëri. Ai bën që tingujt e prodhuar nga të jenë më të fortë. Ne e përdorim sistemin e zërit në shumë raste (tek televizori ose aparati DVD). <b>Hulumtim:</b> Dëgjimi i tingullit përmes një tubi. Së bashku me klasën studiohet se çfarë ndodh me dy vajzat e paraqitura në figurë. Më pas nxënësit të organizuar në dyshe do të ndërtojnë pyetje për hetimin. Kur ata të kenë vendosur se cilat janë pyetjet që do të hetohen mund të planifikojnë hulumtimet e tyre. Secila dyshe prezanton pyetjet e saj. Nxënësit duhet të vendosin se çfarë do të matin në mënyrë që të sigurojnë prova. Ata duhet gjithashtu të propozojnë disa ide për paraqitjen e rezultateve dhe këto ide do t'ua shpjegojnë pjesës tjetër të klasës. Theksohet se për të patur një eksperiment të drejtë, faktorët, si largësia e nxënësve nga burimi i tingullit, duhet të mbeten të pandryshuar. Ata mund të vizatojnë në dyshe vija për të përcaktuar dhe ruajtur largësinë. Zhvillohen tre rastet e provave të hetimit. Përfundimet grupet dyshe do t'i paraqesin me tabelë ose grafikë.			

<p><b>Diskutohet rreth përfundimeve:</b> <i>Si ishte tingulli kur e larguat orën nga veshi, më i fortë apo më i dobët? Pse ndodhi kjo? A ishte më i fortë tingulli kur e dëgjuat nëpërmjet tubit? Pse?</i></p> <p><b>Veprimtari:</b> Planifikim dhe zhvillimi provave në lidhje me tingujt e fortë dhe të dobët të prodhuar me materiale nga jeta e përditshme.</p> <p><b>Prova 1:</b> Demonstronhet një stetoskop. Pyeten nxënësit nëse e kanë parë ndonjëherë më parë? <i>E dini kush e përdor? Pse?</i> Ftohen nxënësit siç janë në dyshe të ndërtojnë një stetoskop. Për këtë demonstronhet nga mësuesja dhe udhëzohen nxënësit në bërjen e një varianti shumë më të thjeshtë stetoskopi. Sqarohen nxënësit se stetoskopët e sotëm janë shumë më të sofistikuar por parimi është i njëjtë me atë që do të ndërtojmë së bashku. Ndjekim hapat e përshkruar në fletën e aktivitetit 4.4 a. Nxënësit mund të sugjerojnë mënyra se si ta testojnë stetoskopin p.sh.: Vendoseni njërin nga konet mbi veshin tuaj dhe tjetrin pranë orës që bën tik-tak. <i>A është tiktaku më i fortë?</i></p> <p>Kërkoni nga njëri prej shokëve të pëshpëritë brenda njërit kon ndërkohë që ju e dëgjoni në konin tjetër. A është pëshpërima më e fortë?</p> <p>Dëgjoni rrahjet e zemrës tuaj me anë të stetoskopit.</p> <p><b>Prova 2:</b> Sqarohen nxënësit se kjo është një veprimtari me zgjedhje që shërben për të treguar se si një tingull mund të bëhet më i fortë. Fryni një tullumbace dhe lidhjani fundin që të mos shfryhet. Trokitni mbi tullumbace me gishta. Sa i fortë është tingulli? Mbajeni tullumbacen pranë veshit. Trokisni lehtë me gishta në anën tjetër. Që eksperimenti të jetë i drejtë ju duhet të trokisni çdo herë me të njëjtën forcë mbi tullumbace. <i>Sa i fortë është tingulli? Në cilin rast ishte tingulli më i fortë?</i></p> <p>Pasi nxënësit japin përgjigjet e tyre, sqarohen se kur ju trokisni në fillim mbi tullumbace, tingulli është tepër i butë. Kur ju e afroni tullumbacen tek veshi dhe trokisni tingulli që dëgjoni është shumë më i fortë.</p> <p><b>Shpjegim:</b> Kur e fryjmë tullumbacen, grimcat e ajrit që gjenden brenda saj ngjishen me njëra-tjetrën. Grimcat që janë brenda e kanë të pamundur të shpërndahen, prandaj ato vazhdojnë të përplasen me njëra-tjetrën dhe të dridhen. Kur ju e godisni tullumbacen, lëvizja i bën grimcat e ajrit që të dridhen më shumë. Sa më shumë të dridhen ato aq më e fortë është zhurma e krijuar. Sa më afër me tullumbacen aq më të forta janë dridhjet.</p> <p>Ftohen nxënësit të shohin figurën e gramafonit të paraqitur në libër. Tregohet se ky model është nga llojet më të vjetra. Duke parë formën e tij, si mendoni pse tingujt dalin më të fortë nga gramafoni?</p> <p><b>Veprimtari:</b> Tingujt rreth nesh: Para fundit të mësimin organizohen nxënësit që me rregull të dalin rreth oborrit të shkollës. Gjatë kësaj shëtitje nxënësit do të dëgjojnë dhe mbajnë shënim tingujt e fortë dhe tingujt e butë që dëgjuan. Në klasë në grup do të diskutojnë rreth tingujve që dëgjuan dhe burimeve të tyre.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarive e diskutimeve.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i faqes 36 në Fletoren e punës</p>	<p><b>Refleksion:</b> Cila prej veprimtarive të pëlqeu më shumë? Tek cila mendon se mund të kishe punuar më mirë?</p>
<p><b>Shënim:</b> Diskutimi i përfundimeve mbi dallimin e tingujve të butë e të fortë gjatë shëtitjes rreth shkollës mund të zhvillohet në orën në vazhdim</p>	

## Ora 7

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Volumi i tingullit		<b>Situata e të nxënimit:</b> Si e matim volumin e tingullit?	
<p><b>Rezultatet e të nxënimit sipas temës:</b>            Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme.            Dallon tingujt e lartë nga tingujt e ulët.            Dallon tingujt e fortë nga tingujt e butë.            Shpjegon se dridhjet e vogla prodhojnë tinguj të butë.            Krahason volumin e një tingulli me forcën e tingullit që e shkakton atë.            Tregon se volumi i tingullit lidhet me fortësinë dhe butësinë e tingullit.            Mat nivelin e tingullit me njësinë matëse decibel (db).</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> volum, decibel, matës i nivelit të tingullit</p>	
<p><b>Burimet e mjete:</b> matës i nivelit të tingullit, mjete të ndryshme për të prodhuar tinguj</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><b>Ditari dypjesësh:</b> Rikujtohet veprimtaria e kryer në orën e mëparshme në lidhje me tingujt dhe burime e tyre gjatë shëtitjes rreth shkollës. Nxënësit organizohen në grupe dhe përgatisin një listë të përbashkët tingujt që dëgjuan. Organizojnë këto tinguj në një ditar dypjesësh duke klasifikuar prej listës tingujt e butë dhe tingujt e fortë. Më pas një përfaqësues i grupit prezanton klasifikimet që ka bërë grupi në ditarin dypjesësh.</p> <p><b>Lojë:</b> përplasim duart. Udhëzohen nxënësit që sipas komandës që do të jepet, ata do të përplasin duart. Përplasen duar fortë, pas disa përplasjeve u thuhet nxënësve që të bëjnë përplasje të dobët të duarve. Pas disa përplasjeve përsëritet përplasja e duarve me të dy format. Në përfundim pyeten nxënësit: <i>Çfarë ndjetë tek duart tuaja kur i përplasët fort? Po tingulli që ato lëshuan si ishte? Po në rastin e përplasjes së dobët të duarve si ishte tingulli që do të dalë?</i></p> <p><b>Shpjegim i përparuar:</b> Sqarohen nxënësit se tingujt mund të jenë të fortë ose të dobët. Sa më i fortë të jenë dridhjet e tingullit aq më i fortë është ai. Volumi i tingullit tregon se sa i fortë ose i dobët është ai.</p> <p>Ftohen nxënësit të shohin shembujt e dhënë në figurat e librit. Njihen me njësinë e matjes së volumit të tingullit Decibel(db). Diskutohet rreth volumit të tingujve që na rrethojnë në jetën tonë, të renditur në një bosht nga niveli më i ulët i volumit deri tek më të lartët. Njihen me aparatën e matjes së tingullit.</p> <p><b>Veprimtari:</b> Matja e tingujve. Nxënësit do të marrin shënim në fletore emërtimet e tingujve që do të krijohen: përplasja e duarve, fishkëllima, përplasja e derës, bisedat në klasë. Duke përdorur numrat nga 1 deri në 4 nxënësit do të përcaktojnë tingullin më të fortë 4 dhe më të dobët 1.</p> <p>Ftohen nxënësit të japin mendime <i>se si do të realizohet prova? Si do të veprohet që të sigurohemi se prova është e rregullt? Si do të paraqiten përfundimet, në tabelë apo grafik?</i></p> <p>Provat do të përsëriten disa herë dhe do të merret një mesatare e tyre.</p> <p><b>Pyetje përgjigje:</b> Prezantohen përfundimet: <i>Cili tingull ishte më i fortë? Po tingulli më i dobët? A ishte i saktë parashikimi? Shpjegoni pse disa tinguj janë të fortë dhe disa janë të dobët?</i></p>			

<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarive kërkimore dhe diskutimeve.	
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 37-38 të Fletores së punës	<b>Refleksion:</b> Në një ambient me muzikë, të pëlqejnë tingujt e fortë apo tingujt e dobët?
<i>Shënim:</i> Për zhvillimin e lojës nxënësit mund të shoqërojnë me duartrokitje “Marshin e Radeckit”	

## Ora 8

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Dobësimi i tingujve		<b>Situata e të nxënët:</b> Në kërkim të materialeve për dobësimin e tingullit	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b> Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme. Tregon se sa më e gjatë është kolona e ajrit aq më e ulët është lartësia e tingullit. Mat nivelin e tingullit me njësinë matëse decibel (db). Tregon përgjegjësi dhe kujdes për të ruajtur shqisën e dëgjimit nga tingujt e fortë dhe të lartë.		<b>Fjalë kyçe:</b> dobësoj, mbrojtëse, veshi, zhurmëmbytës	
<b>Burimet e mjete:</b> materiale të ndryshme, burim tingulli, kuti këpucësh me kapak, matës i nivelit të tingullit		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte, Matematikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <b>Bisedë:</b> <i>Çfarë bëjmë menjëherë kur dëgjojmë një tingull të fortë? Po nëse ky tingull i fortë vazhdon si veproni? Nxiten nxënësit të japin shembuj nga jeta e tyre.</i> Sqarohen nxënësit se reagimi ynë duke mbyllur veshët është një mënyrë për të dobësuar tingujt që vijnë në veshin tonë. <i>A njihni ju mënyra apo mjete se si veprohet për të zbutur tingujt e fortë?</i> <b>Lexim rishikim në dyshe:</b> Ftohen nxënësit të shohin dhe komentojnë figurat në faqen 66 të librit. <i>Çfarë pune bën? Kush është burimi i tingullit? Si i mbron veshët nga tingujt e fortë?</i> Nxënësit lexojnë dhe diskutojnë në dyshe paragrafët e informacionit të dhënë në faqen 66 të librit. <b>Veprimtari:</b> Në kërkim të materialeve të përshtatshme për dobësimin e tingullit. Nxënësit në grupe paraqesin mjetet për hetim. Ftohen që secili pjesëtar i grupit të ndërtojë pyetje për hetimin dhe përcaktojë parashikimet e tij. Këto pyetje dhe parashikime i prezantohen grupit. Përcaktojnë me vije një largësi rreth 1metër, largësi kjo ku do të pozicionohen për të dëgjuar tingujt që lëshon burimi i tingullit. Të drejtuar nga mësuesja nxënësit do të zhvillojnë provën. Udhëzohen nxënësit që provat të jenë sa më të rregullta të gjithë nxënësit e grupeve do të ruajnë qetësinë gjatë gjithë kohës. <b>Organizues grafik:</b> Pasi i kanë mbaruar provat nxënësit do t'i organizojë të dhënat e mbledhura në formën e një tablele. Secili përfaqësues i grupit bën prezantimin e procesit dhe përfundimeve. Nga përfundim të punës, grupet ndërtojnë një listë me materialet që shërbejnë për dobësimin e tingujve. <b>Diskutim:</b> <i>Cili nga materialet e dobësoi tingullin më shumë? Pse? A ishte i saktë parashikimi? A mund të quhet provë e rregullt? Shpjegoni pse. Si mendoni, pse është e rrezikshme të dëgjoni muzikë me kufje kur jeni duke i dhënë biçikletës?</i>			

<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë diskutimeve dhe bashkëpunimin në punën në grup.	
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 39 të Fletores së punës.	<b>Refleksion:</b> A është e rëndësishme për mua mbrojtja nga tingujt e fortë?
<i>Shënim:</i> Udhëzohen nxënësit se nëse kanë instrumente me tela, si p.sh kitarë t'i sjellin për demonstrim në orën në vazhdim.	

## Ora 9 dhe 10

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Tinguj të lartë dhe tinguj të ulët (2 orë)		<b>Situata e të nxënët:</b> Ndërtojmë instrumente me tela	
<p><b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b>            Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme.            Dallon tingujt e lartë nga tingujt e ulët.            Dallon tingujt e fortë nga tingujt e butë.            Shpjegon se dridhjet e vogla prodhojnë tinguj të butë.            Krahason volumin e një tingulli me forcën e tingullit që e shkakton atë.            Tregon se volumi i tingullit lidhet me fortësinë dhe butësinë e tingullit.            Tregon se sa më të shpejta janë dridhjet aq më i lartë është tingulli;            Shpjegon si ndryshon lartësia e tingullit kur ndryshon: a) gjatësia            b) trashësinë e telit c) tendosja e telit në instrument.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> i lartë, i ulët, lartësi, instrument me tela, tendos, akordoj, pickoj, faktor</p>	
<p><b>Burimet e mjete:</b> kitarë ose instrument tjetër me tela, kuti shkrepëse, llastiqe të vegjël, karton, pineska.</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>Dëgjim muzikor:</b> Nxënësit do të dëgjojnë një fragment muzikor. Udhëzohen që gjatë dëgjimit të dallojnë notat muzikore me ton të ulët dhe ato me ton të lartë. Bëhet dëgjimi muzikor. Më pas duke përdorur nxënësit karton me dy ngjyra, gjatë dëgjimit kur ata dëgjojnë tinguj me ton të lartë do të ngrenë kartonin e kuq, kur dëgjojnë tinguj me ton të ulët do të ngrenë karton blu. Udhëzohen nxënësit të përqendrohen në dëgjim dhe të mos ndikohen nga të tjerët. Zhvillohet përsëri dëgjimi muzikor. Gjatë këtij dëgjimi edhe mësuesja demonstroi me kartonë nivelin e tingullit që dallon.  <b>Bisedë:</b> A e patët të vështirë ta dallonit notën muzikore me ton të lartë ose me ton të ulët? Cili prej jush ka qenë në një koncert? A e keni vënë re çfarë bëjnë instrumentistët para se të fillojë koncerti? Si mendoni ju pse?</p>			

<p><b>Shpjegim i përparuar:</b> Dridhjet e ngadalta prodhojnë tinguj me lartësi të vogël, ndërsa dridhjet e shpejta prodhojnë tingull me lartësi të madhe. Kështu, kur i fryjmë bilbilit ai prodhon tingull me lartësi të madhe, ndërsa bubullima tingull me lartësi të vogël. <u>Tërhiqet vëmendja:</u> lartësia nuk është e njëjtë me volumin. Volumi tregon se sa i fortë ose i dobët është tingulli. P.sh. tingulli i bubullimës është i fortë ndërsa lartësinë e ka të vogël. Disa tinguj kanë lartësi shumë të madhe ose shumë të vogël, prandaj ne nuk mund t'i dëgjojmë.</p> <p>Ftohen nxënësit të shohin dhe komentojnë mbi figurat në libër. <i>Çfarë tingujsh lëshojnë elefantët? Cila është e veçanta e tingujve që lëshojnë lakuriqët e natës?</i></p> <p><b>Veprimtari:</b> Pyeten nxënësit nëse ndonjëri prej tyre ka sjellë një instrument muzikor me tela. I tregojnë para shokëve dhe nëse dinë të luajnë me to mund të interpretojnë.</p> <p>Gjatë demonstrimit të instrumentit p.sh. kitarës vëzhgohen pjesët përbërëse të saj. Tërhiqet vëmendja tek telat. Ftohen nxënësit t'i vëzhgojnë telat me vëmendje dhe të bëjnë dallimin ndërmjet tyre: disa tela janë më të trashë se të tjerët. Gjithashtu kitara ka çelësat të cilët shërbejnë për t'i tendosur ose liruar telat. Në këtë rast thuhet se vegla muzikore po akordohet. Gjatë akordimit ndryshohet lartësia e tingullit që prodhojnë telat.</p> <p>Prezantohet punimi i një kitare me kuti shkrepeje. Organizohen nxënësit të punojnë në dyshe. Bëjnë gati mjete dhe ndjekin hapat për ndërtimin e një kitare ashtu si në fletën e aktivitetit 4.7a. Gjatë punës në grupe dyshe nxënësit udhëzohen dhe ndihmohen.</p> <p>Pas ndërtimit të kitarës me kutinë e kartonit, ata do të bëjnë prova për t'u dhënë përgjigje pyetjeve në fletën e aktivitetit. Në përfundim diskutohen pyetjet dhe ekspozohen kitarat e ndërtuara nga nxënësit.</p> <p><b>Sfida:</b> Nxënësit vëzhgojnë dy figurat e muzikantëve. <i>Cili prej instrumenteve mendoni se do të prodhojë një tingull të thellë me ton të ulët?</i> Jepni arsyetimin tuaj.</p> <p><b>Veprimtari:</b> Prodhimi i tingujve me tone të ndryshëm. Nxënësit në dyshe do të provojnë rastet që jepen në fletën e aktivitetit 4.7b. Pas provave, përfundimet e situatave diskutohen fillimisht në grupe me nga dy ose tre nxënës dhe më pas grupet ndajnë përfundimet me gjithë klasën.</p> <p><b>Prova me instrumente:</b> Nxënësit që kanë sjellë instrumente me tela në klasë formojnë grupe me nxënësit e tjerë për të bërë prova dhe për të gjetur përgjigjet e pyetjeve të veprimtarisë së faqes 69 në libër.</p> <p><b>Pyetje- përgjigje:</b> Në fletore nxënësit i japin përgjigje pyetjeve të mësimit. Më pas përgjigjet e pyetjeve diskutohen së bashku.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë veprimtarive si dhe për përgjigjet e dhëna në pyetje-përgjigje.</p> <p>Nxënësit mund të vetvlerësojnë punën e tyre gjatë përfundimeve të veprimtarive.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i faqes 40 të Fletores së punës</p>	<p><b>Refleksion:</b> Cili instrument muzikor të pëlqen?</p>
<p><b>Shënim:</b> Në këtë orë mësimi mund të jenë të ftuar instrumentistë, mësuesja e muzikës së shkollës, ose nxënës që luajnë në instrumente, të cilët të tregojnë për instrumentet dhe tingujt që ato lëshojnë. Ftohen gjithashtu të interpretojnë muzikë para nxënësve të klasës. Udhëzohen nxënësit se nëse kanë instrumente me të cilët bëhet muzikë me anë të goditjes si p.sh. daulle e vogël ose dajre t'i sjellin për demonstrim orën në vazhdim.</p>	

## Ora 11

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Lartësia e tingullit në instrumentet me goditje		<b>Situata e të nxënit:</b> Instrumentet muzikore	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas temës:            Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme.            Dallon tingujt e lartë nga tingujt e ulët.            Dallon tingujt e fortë nga tingujt e butë.            Shpjegon se dridhjet e vogla prodhojnë tinguj të butë.            Krahason volumin e një tingulli me forcën e tingullit që e shkakton atë.            Tregon se volumi i tingullit lidhet me fortësinë dhe butësinë e tingullit.            Tregon se sa më të shpejta janë dridhjet aq më i lartë është tingulli;            Shpjegon si ndryshon lartësia e tingullit kur ndryshon: a) gjatësia b) trashësinë e telit c) tendosja e telit në instrument.</p>		Fjalë kyçe: Instrument me goditje	
Burimet e mjete: instrumente të ndryshme me goditje		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>Shikim/dëgjim muzikor regjistrimi:</b> Ftohen nxënësit të shohin dhe dëgjojnë një regjistrim të një pjese muzikore me instrumente me goditje. Pyeten nxënësit nëse i njohin emrat e këtyre instrumenteve, apo ju ka ndodhur t'i shohin nga afër? U tregohen nxënësve disa instrumente të ndryshëm dhe emërtimet e tyre, duke demonstruar mënyrën e nxjerrjes së tingullit. Nëse ndonjë nxënës ka dëshirë ta përdorë mund të tentojë të interpretojë tinguj të ndryshëm .            Ftohen nxënësit të shohin dhe komentojnë figurat dhe informacionin e dhënë në libër në lidhje me instrumentet me goditje.  <b>Përmbledhje:</b> Cilat prej këtyre instrumenteve muzikorë ishte i njohur prej jush? Cili ju bëri më shumë përshtypje? Si mendoni, çfarë madhësie duhet të kenë daullet prej çeliku që të prodhojnë tinguj me lartësi të madhe? Si mund ta ndryshojmë lartësinë e tingullit të një daulleje? Çfarë instrumentesh me goditje do të zgjidhnit për të formuar bandën tuaj muzikore?  <b>Sfidë:</b> Gjeni mënyra si mund të krijohet një instrument me goditje? Jepen shembuj: duke i rënë një tavoline, duke goditur me një laps, duke tundur kutinë e lapsave, duke tundur një shishe uji etj.  <b>Interpretim muzikor:</b> Ftohen nxënësit të interpretojnë vetëm për pak minuta me një instrument me goditje të krijuar nga vetë ata.</p>			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve.			
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 41 të Fletores së punës		<b>Refleksion:</b> A të pëlqeu të interpretoje me një instrument muzikor me goditje?	
<p><b>Shënim:</b> Për arsye të tingujve që mund të krijohen gjatë kësaj ore mësimore njoftohen klasat pranë për temën mësimore dhe interpretimet që do të kryhen.            Udhëzohen nxënësit se nëse kanë instrumente frymorë si p.sh. flauti, fyelli ti sjellin për demonstrim orën në vazhdim.</p>			

## Ora 12

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Argëtim me instrumentet frymorë.		<b>Situata e të nxënit:</b> Prodhojmë tinguj nëpërmjet fryrjes.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme. Dallon tingujt e lartë nga tingujt e ulët. Dallon tingujt e fortë nga tingujt e butë. Shpjegon se dridhjet e vogla prodhojnë tinguj të butë. Tregon se sa më e gjatë është kolona e ajrit aq më e ulët është lartësia e tingullit. Tregon përgjegjësi dhe kujdes për të ruajtur shqisën e dëgjimit nga tingujt e fortë dhe të lartë.		<b>Fjalë kyçe:</b> instrument frymor	
<b>Burime dhe mjete:</b> flaut, instrumente të tjerë frymorë, disa shishe me formë dhe madhësi të njëjtë, ujë, ngjyrosës ushqimor		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Shikim/dëgjim muzikor</b> regjistrimi: Ftohen nxënësit të shohin dhe dëgjojnë një regjistrim të një pjese muzikore me instrumente frymore. Pyeten nxënësit nëse i njohin emrat e këtyre instrumenteve, apo ju ka ndodhur t'i shohin nga afër. U tregohen nxënësve instrumente të ndryshëm dhe emërtimet e tyre, duke demonstruar mënyrën e nxjerrjes së tingullit. Nëse ka nxënës që kanë sjellë instrumente frymorë mund t'i tregojnë dhe të përshkruajnë se si funksionojnë. Do të ishte bukur nëse ata do të interpretonin për shokët e klasës. Ftohen nxënësit të shohin dhe komentojnë figurat dhe informacionin e dhënë në libër në lidhje me instrumentet frymorë. <b>Veprimtari:</b> Organizohen nxënësit në grupe për të zhvilluar veprimtarinë: Prodhimi i tingujve nëpërmjet fryrjes. Ndiqen hapat për zhvillimin e provës. <b>Përmbledhje:</b> Nxënësit plotësojnë fletën e aktivitetit 4.9 duke ju dhënë përgjigje tri rubrikave në të. <b>Diskutohen së bashku përfundimet.</b> Sa më i ulët niveli i ujit aq më e gjatë është kolona e ajrit brenda në shishe, aq më i ulët edhe tingulli. Sa më e gjatë të jetë kolonë e ajrit në shishe aq më të ngadalta janë dridhjet dhe aq më i ulët është toni i zërit. Me nxënësit me nivel më të lartë pritet të argumentojnë dhe se pse duhet që shisheet që përdorim të jenë në të njëjtën formë dhe madhësi: Në rast se ne do të kishim përdorur shishe me përmasa të ndryshme do të kishte qenë e vështirë të vlerësohej sasia e ajrit.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve.			
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 42 të Fletores së punës.		<b>Refleksion:</b> Cili instrument muzikor të pëlqen?	
<b>Shënim:</b> Këto orë mësimore mund të shoqërohen me një vizitë në sallë koncertesh ku bëhen prova apo ndjekja drejtpërdrejt e një koncerti me instrumente të ndryshme. Në varësi të mundësive prova mund të kryhet dhe me më pak se 8 shishe			



## Ora13

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Projekt “Tingujt e fortë dhe të lartë”		<b>Situata e të nxënët:</b> Po më tej ]farë?	
<p><b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b></p> <p>Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme.  Hulumton se tingulli: a) përhapet nga një burim dhe dëgjohe kur arrin në veshin tonë.  b) përhapet përmes një mjedisi lëndor.  c) përhapet përmes materialeve të ndryshme lëndore.  d) përhapet më mirë përmes trupave të ngurtë.  e) dëgjohe kur arrin në veshin tonë.  f) dobësohe kur largohemi nga burimi që e prodhon atë.</p> <p>Shpjegon se tingulli prodhohet kur trupat dridhen në mjedis dhe shkakton ngjeshjen apo rrallimin e shtresave të mjedisit.  Shpjegon se tingulli dëgjohe kur dridhjet arrijnë në veshin tonë.  Tregon se disa materiale nuk e lejojnë kalimin e tingullit përmes tyre.  Dallon tingujt e lartë nga tingujt e ulët.  Dallon tingujt e fortë nga tingujt e butë.  Shpjegon se dridhjet e vogla prodhojnë tinguj të butë.  Krahason volumin e një tingulli me forcën e tingullit që e shkakton atë.  Tregon se volumi i tingullit lidhet me fortësinë dhe butësinë e tingullit.  Tregon se sa më të shpejta janë dridhjet aq më i lartë është tingulli;  Shpjegon si ndryshon lartësia e tingullit kur ndryshon: a) gjatësia b) trashësinë e telit c) tendosja e telit në instrument.  Tregon se sa më e gjatë është kolona e ajrit aq më e ulët është lartësia e tingullit.  Mat nivelin e tingullit me njësinë matëse decibel (db).  Tregon përgjegjësi dhe kujdes për të ruajtur shqisën e dëgjimit nga tingujt e fortë dhe të lartë.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> tingull i fortë, tingull i butë, tingulli lartë, tingull i ulët, shqisa e dëgjimit</p>	
<p><b>Burime dhe mjete:</b> materialet e grumbulluara gjatë zhvillimit të këtyre grup temave në lidhje me tingullin, letër, lapsa, ngjyra.</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Biologji, Edukim shëndetësor</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p>Brainstorming: <i>Çfarë mësuam në lidhje me tingullin? Cilat janë përfundimet e vëzhgimeve që kemi kryer? A mund të tregoni burime tingulli? A mund të dalloni tingujt nga fortësia? A mund t'i dalloni tingujt nga lartësia? A ndeshemi ne me lloje të ndryshëm tingujsh në jetën tonë të përditshme? A është përherë tingulli i mirëpritur për veshin tonë? Si veprojmë nëse jo?</i></p>			

<p><b>Projekt:</b> Prezantohet tema e projektit “Tingujt e fortë dhe të lartë”. Sqarohen nxënësit se qëllimi i këtij projekti është që nxënësit të tregojnë çfarë kanë mësuar në lidhje me tingujt dhe si mund t’i përdorin ato në të mirë të vetes. Për shembull nxënësit mund të tregojnë për llojet e tingujve dhe gjetje në lidhje me tingujt e fortë, e të lartë në jetën e tyre. <i>Ku i hasin ato?</i> Si mund të veprojnë për të ruajtur shqisën e dëgjimit. Udhëzohen nxënësit se mund të intervistojnë dhe të rritur, si p.sh mjeken e shkollës apo një mjek të njohur, familjarë apo të shfletojnë enciklopedi etj.</p> <p>Kryhet ndarja e grupeve dhe brenda grupit nxënësit paraqesin mendimet e tyre në lidhje me materialin paraqesin në projekt dhe cilat janë mundësitë për t’i siguruar ato. Çdo pjesëtar i grupit do të ketë detyrën dhe rolin e tij. U bëhet e ditur nxënësve se gjatë prezantimit të projektit do të vlerësohen dhe për pjesëmarrjen dhe kryerjen me korrektësi të punëve brenda grupit.</p> <p><i>Afati i prezantimit të projektit është ora në vazhdim.</i></p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> vetëvlerësimi i nxënësve ndaj vetes dhe shokut gjatë dhënies së mendimeve dhe pjesëmarrjes në punën me projekt .</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i detyrave të caktuara nga grupi për përfundimin e projektit</p>	<p><b>Refleksion:</b> Si do të kontribuosh ti në dobësimin e tingujve të lartë e të fortë në ambientet e shkollës.</p>
<p><i>Shënim:</i></p>	

## Ora 13

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj (ora 1)		<b>Situata e të nxënët:</b> Unë di...	
<p><b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b> Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara. Prezanton me forma të ndryshme njohuritë e marra dhe aftësitë e qëndrimet e fituara.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> tingull i fortë, tingull i butë, tingulli lartë, tingull i ulët, shqisa e dëgjimit</p>	
<p><b>Burime dhe mjete:</b> enciklopedi, tabak letre, lapsa, ngjyra</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Kimi Biologji) Art</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Rikujtimi i qëllimit të projektit</b> “Tingujt e fortë dhe të lartë”. Udhëzohen nxënësit që para se të vazhdojnë me përfundimin e prezantimit të projektit të punojnë faqen 74 dhe 75 të librit <b>Punë e pavarur:</b> Ftohen nxënësit të punojnë individualisht. Pas plotësimit do t’i diskutojnë përfundimet në grup. Tërhiqet vëmendja që gjatë diskutimit në grup mund të gjejnë material plus për prezantimin e tyre. Përfundimi i punës në grupe për projektin. <b>Prezantim dhe diskutim</b> me gjithë klasën mbi prezantimet e grupeve të projektit: “Tingujt e fortë dhe të lartë”. Përfundime dhe reflektive. Pyetja: “Si do të kontribuosh ti në dobësimin e tingujve të lartë e të fortë në ambientet e shkollës” i drejtohet të gjithëve dhe secili ftohet të reflektojë.</p>			

<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për përfundimet e nxjerra në ushtrimet e librit. Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve duke përdorur fjalorin e përshtatshëm. Për komunikimin e ideve të tyre me të tjerët.	
<b>Detyra:</b> Pyetja e refleksionit mund të punohet me dëshirë në shtëpi.	<b>Refleksion:</b> Mendo dy gjëra që të pëlqyen nga puna e kryer gjatë këtyre temave dhe diçka që mendon se mund ta bëje më mirë.
<i>Shënim:</i> Në lidhje me detyrën e shtëpisë nxënësit sqarohen se zgjedhja e mënyrës së prezantimit mund të jetë sipas dëshirës.	

## Ora 14

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj (ora 2) Detyrë përmbledhëse / Test		<b>Situata e të nxënit:</b> Unë di...	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimëve dhe veprimtarive të punuara.		<b>Fjalë kyçe:</b> burim tingulli, tingull i fortë, tingull i butë, tingulli lartë, tingull i ulët, shqisa e dëgjimit	
<b>Burime dhe mjete:</b> enciklopedi, fleta e detyrës përmbledhëse, lapsa, ngjyra		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat (Kimi Biologji) Art	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Për pak minuta, nxënësit tregojnë për mbresat e tyre të punuara në detyrat e shtëpisë. <b>Punë e pavarur:</b> Plotësimi i detyrave përmbledhëse. <b>Prezantim dhe diskutim:</b> me gjithë klasën mbi prezantimet e grupeve të projektit: “Tingujt e fortë dhe të lartë”. Përfundime dhe reflektime.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për punimin e detyrës përmbledhëse / Testit.			
<b>Detyra:</b>		<b>Refleksion:</b>	
<i>Shënim:</i> Kjo orë mund të shfrytëzohet si testim ose si detyrë përmbledhëse e periudhës së dytë. - Ora e mësimit mund të fillojë me zhvillimin e testit/detyrës përmbledhëse dhe më pas me prezantimet dhe lojën. Fundi i kësaj ore mësimi mund të përdoret në varësi të kohës dhe prezantimeve të mbetura.			

## **Periudha e dytë**

### **Njohuritë/konceptet**

#### **Gjendjet e lëndës**

- Lëndët dhe vetitë e tyre
- Përzierjet e lëndëve
- Procesi i tretjes

#### ***Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës :***

- Identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta;
- Vëzhgon dhe krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre;
- Heton dhe përshkruan përzierjen e lëndëve të ndryshme dhe ndarjen e tyre;
- Heton dhe shpjegon tretjen e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në tretje.

### **Njohuritë/konceptet**

Ndryshimet e gjendjes së lëndëve

- Ndryshimet e lëndëve gjatë ngrohjes dhe ftohjes
- Proceset e shkrirjes, ngrirjes, avullimit dhe kondesimit

#### ***Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës :***

- Hulumton dhe përshkruan mënyrën se lëndët ndryshojnë kur nxehen dhe kur ftohen.
- Heton dhe përshkruan shndërrimin e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në to.
- Heton dhe vëzhgon proceset e shkrirjes dhe ngurtësimit;
- Heton dhe vëzhgon proceset e vlimit, avullimit dhe kondesimit të ujit

### **Njohuritë/konceptet**

#### **Tingulli**

- Burimet e tingullit
- Përhapja e tingullit
- Karakteristikat e tingullit

#### ***Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës :***

- Shpjegon se tingujt prodhohen nga burime të ndryshme.
- Hulumton se tingulli: a) përhapet nga një burim dhe dëgjohet kur arrin në veshin tonë.
- b) përhapet përmes një mjedisi lëndor.
- c) përhapet përmes materialeve të ndryshme lëndore.
- d) përhapet më mirë përmes trupave të ngurtë.
- e) dëgjohet kur arrin në veshin tonë.
- f) dobësohet kur largohemi nga burimi që e prodhon atë.
- Shpjegon se tingulli prodhohet kur trupat dridhen në mjedis dhe shkakton ngjeshjen apo rrallimin e shtresave të mjedisit.
- Shpjegon se tingulli dëgjohet kur dridhjet arrijnë në veshin tonë.
- Tregon se disa materiale nuk e lejojnë kalimin e tingullit përmes tyre.
- Dallon tingujt e lartë nga tingujt e ulët.
- Dallon tingujt e fortë nga tingujt e butë.
- Shpjegon se dridhjet e vogla prodhojnë tinguj të butë.

- Krahason volumin e një tingulli me forcën e tingullit që e shkakton atë.
- Tregon se volumi i tingullit lidhet me fortësinë dhe butësinë e tingullit.
- Tregon se sa më të shpejta janë dridhjet aq më i lartë është tingulli;
- Shpjegon si ndryshon lartësia e tingullit kur ndryshon: a) gjatësia
- b) trashësinë e telit c) tendosja e telit në instrument.
- Tregon se sa më e gjatë është kolona e ajrit aq më e ulët është lartësia e tingullit.
- Mat nivelin e tingullit me njësinë matëse decibel (db).
- Tregon përgjegjësi dhe kujdes për të ruajtur shqisën e dëgjimit nga tingujt e fortë dhe të lartë.

## **Periudha e dytë**

Emri \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

Klasa \_\_\_\_\_

### 1. Plotëso tabelën për të treguar nëpërmjet grimcave gjendjet e lëndës.

9 ( pikë)

Gjendja e lëndës	Vizato 5 grimca për çdo lëndë.	Grimcat lëvizin shpejt, pothuajse shpejt, nuk lëvizin fare?	Grimcat lëvizin veçmas, në largësi nga njëra- tjetra, apo lëkundën në të njëjtin vend?
Trup i ngurtë			
Lëng			
Gaz			

### 2. Plotëso duke përdorur fjalët.

9 ( pikë)

hkrin ngrin akull temperaturën gjendja të ngurtë

pika e shkrirjes

termometër pika e ngrirjes

Kur nxehet një trup i ngurtë \_\_\_\_\_ dhe ndryshon gjendjen nga e ngurtë në të lëngët.

Kur ftohet një lëng \_\_\_\_\_. Për shembull uji kthehet në \_\_\_\_\_. Kur

ngrin lënda kalon nga \_\_\_\_\_ e lëngët në gjendje \_\_\_\_\_. Ne mund të matim

\_\_\_\_\_ në të cilën një lëndë shkrin. Ajo quhet \_\_\_\_\_

. Ne mund të matim me \_\_\_\_\_ temperaturën në të cilën një lëndë ngrin.

Kjo quhet \_\_\_\_\_

### 3. Shkruaj dy burime tingulli.

2 ( pikë)

**4. Jepni një shembull të tingullit të fortë.**

2 ( pikë)

---

**Jepni një shembull të tingullit të ulët.**

---

**5. Lidh fjalën me kuptimin përkatës:**

6 ( pikë)

volumi	për t'i bërë tingujt më pak të lartë dhe më pak të qartë
dridhet	prej nga vijnë dridhjet
burimi	njësi për matjen e tingullit
dobësoj	sa i lartë ose sa i ulët është një tingull
lartësia	sa i fortë ose sa i dobët është një tingull
decibel	lëkundet shumë shpejt sa para mbrapa

**6. Jep mendimin tënd:**

2 ( pikë)

Përse dhe si duhet të kujdesemi për dëgjimin tonë?

---

---

---

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8- 11	12-15	16 -19	20- 23	24- 27	28- 30

**Suksese!**

## KAPITULLI 5

### Elektriciteti dhe magnetizmi

#### Ora 1 dhe 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Elektriciteti rrjedh në qarqe ( 2 orë)		<b>Situata e të nxënit:</b> Rryma elektrike dhe karamelat.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Shpjegon se elektriciteti rrjedh në qarqet elektrikë. Shpjegon se elektriciteti prodhohet nga pila/burimi ose bateritë. Identifikon pajisjet e thjeshta elektrike që punojnë me elektricitet Përshkruan elementët përbërës të një qarku të thjeshtë elektrik dhe rolin e secilit prej tyre.		<b>Fjalë kyçe:</b> pilë, elektricitet, rrjedh, rrymë elektrike, qark i mbyllur, burim, elektricitet, pol pozitiv, pol negativ, bateri	
<b>Burimet e mjete:</b> elektrik dore me pila, gota, etiketa, karamelat		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art, Edukim fizik	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Parashikim për njohuritë paraprake:</b> Ju tregohet nxënësve një elektrik dore. A e njihni se çfarë është? Nëse shtyp çelësin e tij çfarë do të ndodhë? Pas parashikimeve të nxënësve ndizet llamba e elektrikut të dorës. Më pas tregohet përsëri çelësi i elektrikut dhe pyeten nxënësit: Po tani nëse e shtyp çelësin çfarë do të ndodhë? Përsëri nxënësit japin mendimet. Shtypet çelësi dhe llamba fiket. Parashikimet e nxënësve dolën. <b>Mbajtja e strukturuar e shënimeve:</b> Ndahen nxënësit në grupe dyshe dhe çdo grup do të ketë nga një elektrik dore. Nxënësit bëjnë provën e ndezjes dhe fikjes së elektrikëve të dorës. Shpjegohet se elektriku i dorës punon sepse pilat e tij e shtyjnë elektricitetin. Kjo bën që llamba të ndizet. Vizatohet në dërrasë një skemë e ngjashme me atë të librit për t'u sqaruar nxënësve mënyrën se si rryma kalon nga njëri skaj i pilës në skajin tjetër, pastaj ajo kalon përmes pilës tjetër, përmes llambës dhe kthehet përsëri në pilë pa shkëputje. Ky quhet qark i mbyllur. Ftohen nxënësit që me kujdes duke parë demonstrimin e mësueses të hapin mbajtësen e pilave tek elektriku i dorës. Ata udhëzohen të shohin mënyrën e vendosjes së pilave: <i>Si janë të vendosura pilat?</i> Tregojnë se janë të vendosura njëra pas tjetrës. <i>Çfarë shenjash shihni të vizatuara në skajet e pilave?</i> A i vini re shënimet e vogla + dhe -? Ato janë poli pozitiv dhe poli negativ i pilës. <i>Pilat janë të vendosura njëra pas tjetrës, po polet e pilave si janë të vendosura?</i> Nxënësit do të zbulojnë se vendosja është poli pozitiv përkundrejt polit negativ. Sqarohen nxënësit se rryma rrjedh nga poli pozitiv i njërit pilë në polin negativ të tjetrës. Krahasohet me qarkun e vizatuar ( të paraqitur në fq. 77 të librit) dhe rishikohet mënyra e vendosjes së pilave në elektrikun e dorës dhe lidhja me llambën.			

<p><b>Veprimtari:</b> Modeli me karamete. Udhëzohen nxënësit për kryerjen e kësaj veprimtarie. Sqarohen se ky model shërben për të ilustruar qarkullimin e rrymës elektrike brenda një qarku. Formohet dhe vizatohet në tokë një rreth për të treguar telin në qark. Mësuesi cakton një fëmijë të qëndrojë përballë tij në rreth me etiketën “LLAMBA”, ndërsa vetë qëndron me etiketën “PILA”. Mësuesi mban energjinë në formën e karameles. Fëmijët do të sillen nëpër qark për të treguar mënyrën e qarkullimit të vazhduar të rrymës. Sa herë fëmija kalon te pila fut në gotën e tij një karamelë. Më pas kalon te llamba dhe e lë karamelen. Llamba merr energjinë nëpërmjet karameleve. Kur karamelet te pila mbarojnë, te llamba nuk shkon dot më energji nëpërmjet karameleve, kështu që llamba fiket, ndërsa pilës i ka mbaruar energjia, është shkarkuar.</p> <p><b>Rishikim në dyshe:</b> Pas zhvillimit të veprimtarisë rishikohet skema e vizatuar në dërrasë ose ajo e paraqitur në libër. Nxënësit do ta vizatojnë në fletoret e tyre dhe në dyshe do t’ia sqarojnë njëri tjetrit. Gjithashtu i japin përgjigje pyetjeve në libër.</p> <p><b>Përmbledhje:</b> Gjatë diskutimit të përfundimeve dhe përgjigjeve me gjithë klasën të tekstit nxënësit do të japin shembuj të aparaturave që njohin përdorin pila ose bateri.</p>	
<p>Vlerësimi: Vlerësohen për përfshirjen në bashkëpunimin si dhe mendimet e dhëna gjatë diskutimeve.</p>	
<p>Detyra: Punimi i faqes 44 të Fletores së punës.</p>	<p>Refleksion: Si u ndjetë gjatë veprimtarisë?</p>
<p><b>Shënim:</b> Për zhvillimin e veprimtarisë është i nevojshëm një shesh i madh, kështu që kjo veprimtari mund të zhvillohet në oborr ose në palestrën e shkollës.</p> <p>Porositen nxënësit për mjetet e nevojshme për orën në vazhdim: pilë, llambë e vendosur në një mbajtëse llambe, tela përçues, gërshërë ose pinca metalike, zhveshës telash, shirit ngjitës, kaçavidë</p>	

### Ora 3

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<p><b>Tema mësimore:</b> Elementët e qarkut elektrik të thjeshtë</p>		<p><b>Situata e të nxënët:</b> Ndërtimi i një qarku elektrik</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b>                      Shpjegon se elektriciteti rrjedh në qarqet elektrike.                      Shpjegon se elektriciteti prodhohet nga pila/burimi ose bateritë.                      Identifikon pajisjet e thjeshta elektrike që punojnë me elektricitet                      Përshkruan elementët përbërës të një qarku të thjeshtë elektrik dhe rolin e secilit prej tyre.                      Shpjegon se një pajisje elektrike nuk punon në qoftë se ka shkëputje në qark.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> element, shkëput</p>	
<p><b>Burimet e mjete:</b> pilë, llambë e vendosur në një mbajtëse llambe, tela përçues, gërshërë ose pinca metalike, zhveshës telash, shirit ngjitës, kaçavidë</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art</p>	



**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**Brainstorming:** tregohen para klasës dhe kërkohet që nxënësit t'i emërtojnë ato: pilë, llambë, portollambë, tela përçues. Rikujtohet qarku elektrik tek elektriku i dorës dhe sqarohen nxënësit se llamba dhe pila janë elementë të qarkut elektrik.

**Veprimtari:** Prezantohet para nxënësve se në këtë veprimtari është e rëndësishme që nxënësit të arrijnë të realizojnë një qark të thjeshtë elektrik. Për këtë secili nxënës do të ketë mjetet e veta dhe do të përpiqet që, bazuar në udhëzime, të arrijë të ndezë llambën. Gjatë kohës që punohet nxënësit ndjekin udhëzimet dhe demonstrimin e mësueses:

**Hapi 1:** Priteni telin me gërshërë duke e ndarë atë në dy pjesë me nga 15 cm.

**Hapi 2:** Priteni llastikun/kabllon në dy pjesët fundore të telit me anë të një brisku. Në rast se nuk keni brisk, përdorni një thikë të mprehtë. Priteni derisa ta keni zhveshur telin rreth 2 cm në secilën anë. Sigurohuni që të mos e dëmtoni telin kur i hiqni llastikun.

**Hapi 3:** Sigurojini anët e zhveshura të telit duke i fiksuar ato me ngjites në pikën ku njëra anë lidhet me polin pozitiv të njëres pilë dhe ana tjetër me polin negativ të pilës tjetër.

**Hapi 4:** Sigurojini anët e tjera të zhveshura të telave duke i lidhur ato tek portollamba. Këtu duhet që telat e zhveshur të përthyhen duke formuar me to ca rrathë të vegjël, të cilët duhet të vendosen mbi vendin e vidave, dhe me anë të një kaçavide të mbërtheni vidat. Kjo kërkon praktikë për t'u bërë shpejt dhe me përpikmëri, një arsye më shumë kjo pse secili nxënës duhet të ketë mundësinë ta ushtrojë këtë teknikë.

**Hapi 5:** Kur qarku të ketë përfunduar llamba duhet të ndizet.

**Hapi 6:** Ka raste kur llamba nuk ndizet, atëherë udhëzohen nxënësit të gjejnë gabimin dhe ta provojnë përsëri! Të kontrollojnë të gjitha lidhjet nëse ngjitësi që lidh telin me dy polet e pilës është vendosur siç duhet.

Me dritën e ndezur nxënësit i tregojnë njëri tjetrit rrugën që bën rryma elektrike: nga poli pozitiv nëpërmjet përcjellësit tek llamba (ajo ndizet) nga llamba tek poli negativ i pilës.

Drejtohet pyetja: *Çfarë ndodh me llambën nëse shkëputet qarku duke hequr shiritin ngjites dhe telin përçues nga njëri pol i pilës?* Pasi nxënësit bëjnë parashikimet, bëhet prova.

**Diskutim:** *Çfarë ndodh me llambën në qarkun e mbyllur?* Shpjegoni pse. *Çfarë ndodh me llambën kur shkëputim qarkun?* Shpjegoni pse. *Çfarë do të ndodhë nëse shtoni një llambë tjetër në qarkun që ndërtoat?*

**Vlerësimi:** Vlerësohet se sa arrijnë nxënësit t'i ndjekin udhëzimet. Vihet re nëse ka nxënës që nuk kanë vështirësi për ta zhvilluar atë apo të tjerë që kanë nevojë për më tepër përqendrim.

**Detjra:** Punimi i faqes 45 të Fletores së pune

**Refleksion:** Si u ndjetë kur u ndez drita e qarkut tuaj?

**Shënim:** Zhveshja e telit është një proces i vështirë për nxënësit dhe do kujdes, kështu ata mund të parapërgatiten nga mësuesja.

Më e mira është që kjo veprimtari të zhvillohet vetë nga secili nxënës, duke u ndihmuar në disa raste. Por nëse ka mungesë mjetesh nxënësit mund të punojnë në dyshe.

Porositen nxënësit për mjetet e nevojshme për orën në vazhdim: një pllakë druri e vogël, dy pineska metalike, tel përçues, kapëse letrash

## Ora 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Çelësat		<b>Situata e të nxënët:</b> Si të bëjmë një çelës.	
<p>Rezultatet e të nxënët sipas temës:            Shpjegon se elektriciteti rrjedh në qarqet elektrikë.            Shpjegon se elektriciteti prodhohet nga pila/burimi ose bateritë.            Identifikon pajisjet e thjeshta elektrike që punojnë me elektricitet            Përshkruan elementët përbërës të një qarku të thjeshtë elektrik dhe rolin e secilit prej tyre.            Shpjegon se llamba ndriçon ose jo, kur hapim apo mbyllim çelësin.</p>		<b>Fjalë kyçe:</b> çelës	
<p>Burimet e mjete: një pllakë druri e vogël, dy pineska metalike, tel përçues, thikë, kapëse letrash</p>		Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:            Diskutim: Ftoj një nxënës të ndezë/fikë dritën e klasës. Pyeten nxënësit: <i>Si veproi shoku/ shoqja për të ndezur/fikur dritën? Çfarë përdori?</i> Po nëse nuk do të kishte çelës drite si do ta fiknim/ndiznim llambën? Theksohet domosdoshmëria e të paturit një çelës për të hapur dhe mbyllur një qark. Kur mbyllet çelësi qarku shkëputet dhe llamba fiket. Çelësi është një tjetër element i qarkut elektrik. Ai e hap ose e mbyll qarkun. Në qarkun që ndërtuam në orën e kaluar, për ta shkëputur ju hoqët njërin prej telave përçues nga poli i pilës. Ndërkohë çelësi ju mundëson ta fikni apo ta ndizni llambën pa qenë nevoja të shkëpusni telin përçues.  <i>Veprimtari 1:</i> Si të bëjmë një çelës. Udhëzohen nxënësit që siç u veprua me veprimtarinë për ndërtimin e qarkut, dhe tek kjo veprimtari do të ndjekin hapat e udhëzimet për të ndërtuar një çelës. Nxënësit do t'i bashkojnë copat bashkë si në skemën e paraqitur në faqen 76 të librit. Ata duhet ta heqin veshjen plastike në pjesët fundore të të dy telave dhe ta mbështjellin njëri-anë të secilit tel tek gjilpëra me kokë, sipas skemës. Më pas ata duhet ta shtyjnë kapësen e letrave derisa ajo të prekë gjilpërën tjetër. Kjo do ta mbyllë qarkun. Për ta fikur qarkun mjafton ta tërhiqni kapësen e letrave prej gjilpërës. Kjo do ta hapë qarkun.  <i>Veprimtari 2:</i> Ndërtimi i një qarku me çelës. Nxënësit do të rindërtojnë qarkun si orën e mëparshme, por kësaj radhe duhet të shtojnë edhe një çelës. Për ta bërë këtë, nxënësve do t'u duhet edhe pjesa shtesë e telit e prerë përgjysmë dhe me fundin e zhveshur. Kur ta kenë përfunduar qarkun do ta provojnë atë duke mbyllur çelësin. Parashikoni se çfarë do të ndodhë kur të mbyllni çelësin. Mbyllni çelësin dhe shikoni llambën. Çfarë ndodh? Llamba duhet të ndizet. Nëse llamba nuk ndriçon kontrolloni përsëri të gjitha lidhjet e elementëve të qarkut. Provojeni përsëri. Nxënësit do të vizatojnë qarkun që ndërtuan në fletore dhe do të emërtojnë secilën pjesë të tij. Pas vizatimit ia prezantojnë skemën njëri tjetrit.  <b>Pyetje përgjigje:</b> Pse ndizet llamba kur ndizni çelësin? Çfarë duhet t'i bëni çelësit që qarku të shkëputet? Si mendoni pse duhet të kontrolloni çdo lidhje të qarkut nëse llamba nuk ndizet?</p>			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohet se sa arrijnë nxënësit t'i ndjekin udhëzimet. Nxënësit mund të vlerësojnë punën e njëri-tjetrit pasi të kenë përfunduar ndërrimin e qarkut dhe skemën.			
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 46 të Fletores së punës.		<b>Refleksion:</b> Ku i kanë të vendosur çelësat disa nga pajisjet elektrike që nje?	
<i>Shënim:</i>			

## Ora 5

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Qarqet elektrike me shumë elemente		<b>Situata e të nxënit:</b> Ndërtojmë qark me shumë elementë	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Shpjegon se elektriciteti rrjedh në qarqet elektrikë. Shpjegon se elektriciteti prodhohet nga pila/burimi ose bateritë. Përkshkruan elementët përbërës të një qarku të thjeshtë elektrik dhe rolin e secilit prej tyre. Shpjegon se llamba ndriçon ose jo, kur hapim apo mbyllim çelësin. Shpjegon se një pajisje elektrike nuk punon në qoftë se ka shkëputje në qark.		Fjalë kyçe: qark, elemente	
<b>Burimet e mjete:</b> dy pila, tri llamba në mbajtëse llambash, çelës, tel përçues, gërshërë, thikë, shirit ngjitës, llastik i hollë, shkop		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Diskutim për njohuritë paraprake:</b> <i>Çfarë e prodhon elektricitetin e një qarku? Çfarë e përçon elektricitetin nga një komponent tek tjetri? Si e hapim ose mbyllim ne qarkun?</i> <b>Veprimtari:</b> Prezantohet veprimtaria që do të zhvillojnë nxënësit: Do të ndërtojnë një qark me shumë elementë. Nxënësit do të punojnë me të njëjtin shok ose grup me të cilin punuan për veprimtaritë e kaluara. Ju tërhiqet vëmendja se duhet të ndjekin udhëzimet. Kërkohej nga nxënësit të parashikojnë se çdo të ndodhë, edhe në rastet nëse i bëhet një ndryshim qarkut, para se ata ta bëjnë ndryshimin. <b>Hapi 1:</b> Bashkujini dy pilat për të krijuar një bateri më të fuqishme. Kontrolloni që poli pozitiv dhe ai negativ të vijnë pas njëri-tjetrit. Për ta bërë lidhjen sa më të fortë, është e mira të prisni dy copa shkopiinjsh ose shkopa akulloresh në gjatësinë e dy pilave. Më pas ngjitini ato bashkë duke përdorur ngjitësen letër. <b>Hapi 2:</b> Priteni telin në copa me gjatësi 15 cm. Zhvishini pjesët fundore të telave. <b>Hapi 3:</b> Lidhni qarkun me tri llamba të vendosura mbi portollamba siç tregohet në figurën e paraqitur në faqen 85 të librit. <i>Çfarë do të ndodhë?</i> <b>Hapi 4:</b> Mbylleni çelësin. Vëzhgoni llambat. <i>A u realizua parashikimi?</i> <b>Hapi 6:</b> Hapeni çelësin. Hiqni një prej llambave nga portollamba në mënyrë që të mbeten dy llamba. <b>Hapi 7:</b> Lidhni përsëri qarkun. <i>Çfarë do të ndodhë?</i> Mbyllni çelësin. Vëzhgoni llambat. A u realizua parashikimi? Më pas nxënësit do të parashikojnë se çdo të ndodhë në rast se heqim edhe një llambë tjetër duke lënë një llambë të vetme. Ata do të mendojnë se llamba do të ndriçojë akoma më shumë, duke qenë se kjo ishte ajo çka ndodhi herën e fundit kur ata hoqën vetëm njëllambë. Në të vërtetë gjasat janë që llamba të digjet, pasi rryma elektrike që hyn në një llambë vetëm 1.5 V tani është 3 V. Për të shmangur humbjen e llambave do t'u këshillojmë që këtë veprimtari ta linit për në fund, dhe ta zhvillonit atë thjesht në formë demonstrimi.			

<p>Nxënësit do të vizatojnë qarkun që ndërtuan në fletore dhe do të emërtojnë secilën pjesë të tij. Pas vizatimit ia prezantojnë skemën njëri tjetrit duke treguar se si rrjedh rryma elektrike në qarkun që ndërtuan. Disa nxënës me dëshirë prezantojnë skemën dhe rrugën që bën rryma elektrike në qarkun e ndërtuar..</p> <p><b>Përfundime:</b> Nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve nxënësit do të tregojnë përfundimet e tyre mbi veprimtarinë e kryer: <i>Nga prova që bëtë çfarë vutë re? Si ndriçuan llambat kur u hoq një llambë nga qarku? Si mendoni, pse ndodhi kjo? Çfarë ndodhi kur në qark mbeti vetëm një llambë?</i> Shpjegoni pse.</p> <p>Mund të ndodhë që në një qark elektrik llambat të mos ndriçojnë. A e shpjegoni dot pse?</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mënyrën si ndjekin udhëzimet, punojnë me kujdes si dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i faqes 47 të Fletores s[ punës</p>	<p><b>Refleksion:</b> Si u ndjeve kur llambat e qarkut që ndërtove ndriçuan?</p>
<p><i>Shënim:</i></p>	

## Ora 6

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 4</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Qarqet me sinjalizues		<b>Situata e të nxënët:</b> Ndërtim i qarkut me sinjalizues	
<p><b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b>                      Shpjegon se elektriciteti rrjedh në qarqet elektrikë.                      Shpjegon se elektriciteti prodhohet nga pila/burimi ose bateritë.                      Përshkruan elementët përbërës të një qarku të thjeshtë elektrik dhe rolin e secilit prej tyre.                      Shpjegon se llamba ndriçon ose jo, kur hapim apo mbylлим çelësin.                      Shpjegon se një pajisje elektrike nuk punon në qoftë se ka shkëputje në qark.                      Shpjegon se llambat dhe zilet e lidhura në qark punojnë brenda një vlere të përcaktuar rryme.                      Tregon se burimi duhet të ketë një tension të mjaftueshëm që të gjitha elementët e qarkut të punojnë.                      Krahason qarkun e thjeshtë elektrik me qarkun më shumë elementë.                      Ndërton skemën e një qarku të thjeshtë elektrik në seri.                      Ndërton skemën e një qarku me zile elektrike.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> sinjalizues, tension, volt</p>	
<p><b>Burimet e mjete:</b> tri pila tensioni 1,5 V, çelës, tel përçues, gërshërë, shirit ngjitës, llastik i hollë, shkop</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>                      Diskutim për njohuritë paraprake: Diskutohen përfundimet e dala në detyrën e shtëpisë.  <i>Cilët janë elementët e qarkut që jepej në detyrë? Çfarë duhet të bënit që llambat të ndriçojnë? Çfarë ndodh nëse në qark shton dhe një llambë tjetër? Pse? Çfarë ndodh nëse në qark lë vetëm një llambë? Pse?</i></p>			

**Shpjegim i përparuar:** Nëse llamba në qark është djegur kjo ndodh sepse rryma që kaloi në të ishte më e madhe se ajo që duhej për një llambë. U tregohen nxënësve disa lloje pilash dhe baterish. Orientohen ata të shohin shënimet e stampuara mbi to të cilat tregojnë tensionin e burimit të rrymës. Njësia matëse e tensionit është V (volt). *Nga sa volt janë pilat ose bateritë tuaja? Sa bateri me nga 1.5V do të nevojiteshin për të vënë në punë një sirenë 3V ose një llambë 6 V?* Ftohen nxënësit të bëjnë llogaritjet.

Demonstrohet një sinjalizues dhe sqarohen nxënësit se edhe sinjalizuesi është një element i qarkut. Kështu sinjalizuesit i duhet një rrymë 3 volt për të punuar. *Sa bateri 1,5 V duhen në qark për të punuar sinjalizuesi?*

**Veprimtari:** Ndërtimi i një qarku me sinjalizues. Gjatë ndërtimit të qarkut nxënësve do t'u duhen të gjithë komponentët e qarkut që kanë përdorur më parë. Ata do të ndjekin hapat e veprimtarisë:

**Hapi 1:** Priteni telin 30cm përgjysmë me gërshërë. Zhvishini pjesët fundore duke përdorur një thikë me majë të mprehtë.

**Hapi 2:** Ndiqni udhëzimet e dhëna në faqen 85 të librit për ta lidhur sirenën me qarkun.

**Hapi 3:** Testojini qarqet e tyre. *A bën zhurmë sirena kur ata mbyllin çelësin?*

**Hapi 4:** Zëvendësojini dy pilat e ngjitura bashkë me një pilë të vetme. Parashikoni çfarë do të ndodhë. Provojeni qarkun përsëri. *A u vërtetua parashikimi juaj?*

**Hapi 5:** Shtojani dy pilat e ngjitura bashkë qarkut të tyre. Tani qarku ka tri pila. Parashikoni çfarë do të ndodhë? Provojeni qarkun përsëri. *A u vërtetua parashikimi juaj?*

*Si të veproni nëse sirena nuk ndizet? Kontrolloni të gjitha lidhjet, a i keni fiksuar mirë telat pas fundit të pilave me ngjitës? A janë pjesët fundore të pilave të ngjitura bashkë në mënyrë që të bëjnë kontakt?*

**Përmbledhje, pyetje-përgjigje:** *Si punoi qarku me tri pila? Si punoi qarku me një pilë? Pse duhet një burim me tension të paktën 3 volt, që sinjalizuesi të punojë? Ju dëshironi të vini në punë një lodër që ka tension 6 V. Pse nuk punon lodra kur përdorni një pilë 1,5V?*

**Vlerësimi:** Vlerësohen për mënyrën si ndjekin udhëzimet, punojnë me kujdes si dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

**Detyra:** Punimi i faqes 48 të Fletores së punës      **Refleksion:**

Shënim:

## Ora 7

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Qarqet me sinjalizues		<b>Situata e të nxënit:</b> Ndërtim i qarikut me sinjalizues	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas temës:            Shpjegon se elektriciteti rrjedh në qarqet elektrikë.            Shpjegon se elektriciteti prodhohet nga pila/burimi ose bateritë.            Përshkruan elementët përbërës të një qariku të thjeshtë elektrik dhe rolin e secilit prej tyre.            Shpjegon se llamba ndriçon ose jo, kur hapim apo mbyllim çelësin.            Shpjegon se një pajisje elektrike nuk punon në qoftë se ka shkëputje në qarq.            Shpjegon se llambat dhe zilet e lidhura në qarq punojnë brenda një vlere të përcaktuar rryme.            Tregon se burimi duhet të ketë një tension të mjaftueshëm që të gjitha elementët e qarikut të punojnë.            Krahason qarqun e thjeshtë elektrik me qarqun më shumë elementë.            Ndërton skemën e një qariku të thjeshtë elektrik në seri.            Ndërton skemën e një qariku me zile elektrike.</p>		<p>Fjalë kyçe: përçues, pila, sinjalizues, çelës, llamba, sinjalizues</p>	
<b>Burimet e mjete:</b> pilë, përçues, tel etj.		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>Parashikim me terma paraprakë:</b> Jepen fjalët: përçues, pila, sinjalizues, çelës, llamba ose sinjalizues. Bazuar në njohuritë e marra nxënësit ftohen të tregojnë në një paragraf duke përdorur këto fjalë.            Me dëshirë nxënësit lexojnë paragrafët e tyre.            Punë e pavarur: Udhëzohen nxënësit në punimin e Fletës së aktivitetit 5.5. Fillimisht do të punojnë individualisht dhe më pas do t'ia prezantojnë shokut zgjedhjet e bëra për plotësimin e rubrikave dhe ndërtimin e qarikut.            Prezantime: Në fund disa prej nxënësve do të prezantojnë punët e tyre.</p>			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për ndërtimin e qarikut dhe mendimet e dhëna dhe plotësimin në ushtrimin			
Detyra:		<b>Refleksion:</b> Si ndjehesh kur i prezanton shokut mendimet dhe argumentet e tua?	
<i>Shënim:</i>			

## Ora 8

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituria Natyre	<b>Klasa 4</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Elektriciteti i rrjetit		<b>Situata e të nxënësve:</b> Elektriciteti i nevojshëm, i rrezikshëm	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</b> Vlerëson rëndësinë e përdorimit të elektricitetit në jetën e përditshme. Tregon si zbatohen rregullat e sigurisë gjatë punës me pajisjet elektrike për t'u mbrojtur nga rreziqet e mundshme.		<b>Fjalë kyçe:</b> elektriciteti i rrjetit, pajisje elektrike, spinë, prizë, goditje elektrike, bakër, mbingarkoj	
<b>Burimet e mjete:</b> pajisje të ndryshme elektroshtëpiake		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte, Matematikë	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Diskutim për njohuritë paraprake:</b> Ju tregohen nxënësve disa pajisje elektrike që janë të njohura për ta, si një tharëse flokësh, magnetofon, etj. Drejtohet pyetja: <i>Si mund t'i përdorim këto pajisje?</i> Duhet vendosur në prizë. Diskutojmë për vendosjen e pajisjeve në një prizë elektrike në mur. Duke studiuar pajisjen vihet në dukje mundësia e hapjes ose mbylljes së çelësit. Tërhiqet vëmendja në shikimin e shënimit në pajisje në lidhje me tensionin e nevojshëm për të punuar kjo pajisje. Ju tregohet nxënësve se tensioni i rrjetit për vendin tonë është 220V. Nëse i krahasojmë me tensionin e pilave që kemi parë këto ditë çfarë mund të thoni? <b>Leximi i drejtuar:</b> Ftohen nxënësit të shohin në faqen 86 të librit dhe të diskutojnë për figurat në të. Çfarë të përbashkët kanë këto figura? Lexohen paragrafët dhe ngrihen pyetje përgjigje në lidhje me to: <i>Përse e përdorim elektricitetin e rrjetit? Sa është tensioni në rrjet? Përse këto pajisje elektrike mund të punojnë vetëm me energjinë e rrjetit?</i> Demonstronhet priza dhe spina. <i>Ku dallojnë nga njëra tjetra? Pse telat e bakrit kanë veshje plastike? Pse duhet të kemi kujdes nga rrymat elektrike? Cilat janë veprimet që kryejnë personazhet në figura? A janë ato veprime të drejta? Çfarë po ndodh në kuzhinën e shtëpisë në Jorkut?</i> Ftohen nxënësit në dyshe të mbledhin të dhënat mbi situatën e paraqitur në figurë dhe më pas t'i tregojnë njëri tjetrit çfarë nuk shkon mirë dhe pse. <i>Si duhet të veprojnë personazhet që të mos rrezikojnë?</i> Sqarohen nxënësit (të cilët mund të mendojnë se rrjeti elektrik vjen nga prizat që ndodhen në mur tek pajisjet) se kabllot vazhdojnë edhe pas prizës nëpër mur. U shpjegohet se edhe rrjeti elektrik funksionon gjithashtu me qarqe. Shtëpitë dhe ndërtesat e ndryshme janë të shtuara gjithandej me tela, në mënyrë që të gjithë telat të plotësojnë qarqe. Kësaj radhe, në vend të pilës që vë në lëvizje rrymën elektrike në qark, ka një gjenerator i cili është në gjendje të vërë në qarkullim një sasi shumë herë më të madhe energjie elektrike 220V në vend të një sasive prej 1.5V. <b>Prezantimi i rezultateve të hetimit të situatës në shtëpinë e Jorkut:</b> Nxënësit prezantojnë përfundimet të orientuar nga pyetjet e dhëna në libër. <b>Diskutohet rreth:</b> <i>A dini ndonjë rast ku përdorimi i elektricitetit mund të ketë qenë i rrezikshëm për jetën e përdoruesit?</i> Nxënësit mund të japin shembuj (të parë apo të dëgjuar) nga jeta e tyre. <b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet dhe gjetjet gjatë diskutimeve dhe bashkëpunimin në punën në grup.			
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 49 të Fletores së pune		Refleksion: Po ti tregon kujdes ndaj rrymës elektrike?	
Shënim:			

## Ora 9

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 4</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Projekt “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre”.		<b>Situata e të nxënimit:</b> Pajisjet elektrike	
<b>Rezultatet e të nxënimit sipas temës:</b> Vlerëson rëndësinë e përdorimit të elektricitetit në jetën e përditshme. Vërteton një hipotezë ose parashikim bazuar në njohuritë dhe kuptimin shkencor. Mbledh prova dhe paraqet rezultatet në tabela. Punon në grup projektin me temë: “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre”.		Fjalë kyçe: projekt	
<b>Burimet e mjete:</b> enciklopedi, manuale pajisjesh elektrike, mjete për projektin		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i><b>Bisedë:</b> Çfarë mendimi keni rreth përdorimit të pajisjeve elektrike në jetën tonë? A është i madh ky numër? A është e rëndësishme rryma elektrike në jetën tonë?</i> Prezantohet qëllimi i projektit, i cili është njohja me pajisje të ndryshme elektrike dhe rëndësia e tyre në jetën e përditshme. Udhëzohen nxënësit mbi mënyrat e grumbullimit të të dhënave. Në çfarë mënyrash mund të mbledhni informacion mbi sasinë dhe llojet e pajisjeve elektrike që përdoren? Si do të dalloni se cilat prej tyre janë më të përdorshmet? Si mund të gjeni informacion mbi përdorimin e tyre? A janë ato ekonomike në shpenzim dhe nuk e dëmtojnë natyrën? A janë pajisjet elektrike shumë të rëndësishme për jetën tonë? (Këto pyetje dhe të tjera që dalin gjatë bisedës, shkruhen në dërrasë që të shërbejnë si orientim për nxënësit) Theksohet se shumë të rëndësishme në projekt janë: prezantimi i të dhënave, analizimi i tyre me përfundimet, paraqitja e qëndrimeve të vetë pjesëtarëve të projektit. Ndahen nxënësit në grupe dhe secili prej tyre do të mendojë se si të veprojnë për mënyrat e mbledhjes së informacionit dhe organizimin e projektit, orientuar dhe nga pyetjet e dala gjatë bisedës. <i><b>Lapsa në mes:</b></i> Nxënësit me radhë tregojnë brenda grupit mendimet dhe idetë e tyre. Organizohet puna e grupit për projektin duke përcaktuar rrugët që do të ndiqen dhe mënyrat e prezantimit të projektit. Ndahen rolet dhe përcaktohen detyrat. Pjesëtarët e grupit bashkëpunojnë në ndërtimin e tabelave për mbledhjen e të dhënave, për hartimin e intervistave me familjarë etj. Sqarohen nxënësit se puna me projektin dhe prezantimet e tij do të jetë dhe në orën në vazhdim			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve.			
<b>Detyra:</b> Punimi i detyrave të caktuara nga grupi për përfundimin e projektit		<b>Refleksion:</b>	
<i>Shënim:</i> Nëse në klasë ka prind i cili punon me pajisjet elektrike mund të jetë i ftuar për të treguar rreth tyre.			



## Ora 10

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Projekt “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre”.		<b>Situata e të nxënit:</b> Pajisjet elektrike	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Vlerëson rëndësinë e përdorimit të elektricitetit në jetën e përditshme. Punon në grup projektin me temë: “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre”.		<b>Fjalë kyçe:</b> projekt	
<b>Burimet e mjete:</b> enciklopedi, manuale pajisjesh elektrike, mjete për projektin		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Arte	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i><b>Përgatitja për prezantim.</b></i> Në gjysmën e parë të orës nxënësit mbledhin materialet e grumbulluara për t’i organizuar në prezantim. Bisedohet rreth vështirësive që kanë hasur/hasin dhe zgjidhjet e tyre brenda grupit. Ritheksohet se një pjesë e rëndësishme projektit është: prezantimi i të dhënave, analizimi i tyre me përfundimet, paraqitja e qëndrimeve të vetë pjesëtarëve të projektit. <i><b>Prezantimi i projekteve:</b></i> në gjysmën e dytë të kohës grupet me përfaqësuesit e tyre prezantojnë projektet, përfundimet dhe qëndrimet e tyre. Pas prezantimeve nxënësve drejtohen pyetjet: <i>A ka rrezik në përdorimin e këtyre pajisjeve elektrike? Si duhet të kujdesemi?</i> Pas mendimeve të nxënësve ju prezantohet se në orën në vazhdim do të punohet me rregullat e sigurisë.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohet projekti në gjithë elementët e tij, vlerësohen punët e pjesëtarëve të grupit. Nxënësit vetëvlerësohen dhe vlerësojnë njëri-tjetrin për punën dhe kontributin në projekt.			
<b>Detyra:</b> Mblidh të dhëna mbi rregullat e sigurisë.		<b>Refleksion:</b>	
<i>Shënim:</i>			

## Ora 11

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Posteri “Rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitet”		<b>Situata e të nxënit:</b> Kujdes!	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Vlerëson rëndësinë e përdorimit të elektricitetit në jetën e përditshme. Tregon si zbatohen rregullat e sigurisë gjatë punës me pajisjet elektrike për t’u mbrojtur nga rreziqet e mundshme. Vërteton një hipotezë ose parashikim bazuar në njohuritë dhe kuptimin shkencor. Mbledh prova dhe paraqet rezultatet në tabela.		<b>Fjalë kyçe:</b> siguri	

<b>Burimet e mjete:</b> letër, ngjyra	<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p><b>Diskutim:</b> Ç'mund të thoni për pajisjet elektrike dhe kujdesin nga rryma elektrike me të cilën ato punojnë? A duhet të jemi të kujdesshëm me rrymën elektrike? Pse? Si duhet të veprojmë?</p> <p>Ftohen nxënësit sipas grupeve të mëparshme në projekt, të krijojnë një poster mbi “Rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitet”</p> <p>Udhëzohen nxënësit të përdorin dhe materialet e mbledhura si detyre prej tyre.</p> <p>Pas punës me posterat, nxënësit do të organizojnë prezantimin e tyre.</p> <p>Paraqitja dhe komente.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mendimet dhe për punën e kryer në poster. Nxënësit kanë mundësi të vetëvlerësohen dhe vlerësojnë njëri tjetrin.</p>	
<b>Detyra:</b>	<b>Refleksion:</b>
<p><b>Shënim:</b> Udhëzohen nxënësit për përgatitjen e ekspozitës në orën në vazhdim</p>	

## Ora 12

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
Tema mësimore: Ekspozitë “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe siguria”		Situata e të nxënësve: Ekspozitë	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</p> <p>Vlerëson rëndësinë e përdorimit të elektricitetit në jetën e përditshme.</p> <p>Tregon si zbatohen rregullat e sigurisë gjatë punës me pajisjet elektrike për t'u mbrojtur nga rreziqet e mundshme.</p> <p>Punon në grup për krijimin e një posteri që përmban rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitet dhe e prezanton atë.</p> <p>Punon në grup projektin me temë: “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre”.</p>		Fjalë kyçe:	
<p><b>Burimet e mjete:</b> qarqet e ndërtuar në orët e mëparshme, projektet e grupeve dhe posterat, letër, ngjyra, ngjitës,</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Përgatitja</i> dhe prezantimi në dy pjesë të galerisë. Një pjesë e ekspozitës do të prezantojë qarqet elektrike të punuara nga nxënësit gjatë temave mësimore. Pjesa tjetër e ekspozitës do të prezantojë projektet mbi “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre”.</p> <p>dhe posterat që përmbajnë rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitetin. Nxënësit të organizuar qëndrojnë pranë punimeve të tyre dhe bëjnë prezantimet e tyre tek vizitorët</p> <p><i>Turi i galerisë:</i> Vizitohet galeria e ekspozitës së punimeve të nxënësve.</p>			
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mendimet, për punën e kryer dhe prezantimin e tyre. Nxënësit kanë mundësi të vetëvlerësohen dhe vlerësojnë njëri tjetrin.</p>			
<b>Detyra:</b>		<b>Refleksion:</b> Si u ndjeve gjatë ekspozimit të punës tënde dhe të shokëve të tu?	

*Shënim:* Ftohen nxënës të klasave të tjera, prindër të vizitojnë ekspozimin e punimeve të nxënësve.

Për organizimin e ekspozitës mund të përdoren ambiente më të mëdha se klasa.

Për arsye kohe kjo orë mund të kombinohet dhe me orë të kurrikulës së lirë.

## Ora 13

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Përdorimi i magnetëve në jetën e përditshme		<b>Situata e të nxënit:</b> Kush është magnetike?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Identifikon polet e një magneti. Mëson se magnetet tërheqin disa prej metaleve por jo të gjitha metalet. Vërteton një hipotezë ose parashikim bazuar në njohuritë dhe kuptimin shkencor. Mbledh prova dhe paraqet rezultatet në tabela. Ndërton një eksperiment të drejtë ose të planifikojmë mbledhjen e provave të mjaftueshme. Zgjedh mjetet që do të përdorim dhe të vendosim çka do matim. Kryen vëzhgimet e nevojshme dhe të bëjmë krahasime.		Fjalë kyçe: magnet shufër, magnet patkua, të dhëna të dobishme, pllakëz mbrojtëse	
<b>Burime dhe mjete:</b> magnetë nga të tre llojet, materiale të ndryshme magnetike dhe jo magnetike		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Harta semantike:</b> Shkruhet në dërrasë fjala “Magnet“ dhe pyetjet nxënësit rreth: <i>Çfarë dini për magnetet? Tregohet një magnet: Çfarë është? Çfarë mund të bëjë një magnet?</i> <b>Demonstrim:</b> Në tavolinën e mësueses hidhen disa gjilpëra me kokë. Ftohet një nxënës që t’i mbledhë ato. <i>Si do të veprojnë ai?</i> Para se nxënësi të veprojë, nxënësit e tjerë japin mendimet e tyre rreth mënyrave se si mund të mblidhen gjilpërat e shpërndara mbi tavolinën. Shpërndahen tek nxënësit magnetë. Këshillohen nxënësit të mos i lëshojnë magnetet në tokë sepse kështu do t’i dëmtonin ato. Shohin llojet e ndryshme të magnetëve. Për orientim nxënësit mund të shohin dhe në faqen 88 të librit mbi llojet dhe emërtimet e magnetëve të ndryshëm. <b>Veprimtari:</b> Zbuloni cilat material janë magnetike. Ndahen nxënësit në grupe dhe secilit grup ka disa material të ndryshme për të dalluar në to materialet magnetike nga ato jo magnetike. Ftohen nxënësit të mendojnë një plan se si të veprojnë për të bërë dallimin e materialeve dhe se si do të organizojnë mbledhjen dhe hedhjen e të dhënave. Udhëzohen që para çdo prove të bëjnë një parashikim në lidhje me materialin nëse është apo jo magnetik. Nxënësit mund t’i hedhin të dhënat që mblidhen në ushtrimin 5.7. Gjatë matjeve ata do të hedhin të dhënat në mënyrë individuale. Më pas në organizohen në një prezantim të grupit. <b>Prezantime:</b> Secili grup prezanton procedurën e ndjekur për zhvillimin e eksperimenteve me materialet e ndryshme, duke i emërtuar ato. Paraqitja e organizuar në tabelën e të dhënave dhe përfundimet. I drejtohet pyetja pjesëtarëve të grupit: <i>Sa prej jush bënë parashikime të sakta? Sa prej jush kishin gabuar në parashikime?</i>			

<p><b>Bisedë:</b> Shumë objekte që përdorim në jetën e përditshme kanë magnet. Ndosht që magnetet të ndryshëm nuk veprojnë njësoj mbi të njëjtin objekt. Disa prej tyre e tërheqin objektin më fort se të tjerët.</p> <p><i>Si mendoni ju, përse mësuesi/ja ju këshilloi të mos i vendosnit në Tokë magnetet? Ndosht që magnetet dëmtohen. Për këtë është e rëndësishme të kujdeseni për mirëmbajtjen e tyre. Ruajini fundet e tyre me një pllakës mbrojtëse.</i></p> <p><b>Diskutim:</b> Emërtoni tri lloje magnetesh. Pse nuk duhet ta goditni një magnet? Cilat objekte që keni në shtëpi përmbajnë magnet?</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për mendime e dhëna gjatë diskutimeve.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i faqes 50 të Fletores së punës.</p>	<p><b>Refleksion:</b> A të pëlqen të luash me magnetet?</p>
<p><i>Shënim:</i></p>	

## Ora 14

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Polet magnetike		<b>Situata e të nxënësve:</b> Çfarë poli është?	
<p><b>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</b>                      Identifikon polet e një magneti.                      Vërteton një hipotezë ose parashikim bazuar në njohuritë dhe kuptimin shkencor.                      Zbulon forcat e pranishme midis magnetëve dhe të dimë se magnetet mund ta shtyjnë ose tërheqin njëri-tjetrin.                      Mbledh prova dhe tregon nëse ato i vërtetojnë ose jo parashikimet tona.                      Vërteton një hipotezë ose parashikim duke u bazuar tek njohuritë dhe kuptimi shkencor.                      Bën parashikime dhe t'i komunikojmë ato.                      Kryen vëzhgimet e nevojshme dhe të bëjmë krahasime.                      Gjykon mbi nevojën e përsëritjes së matjeve.</p>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> poli veri, poli jug, shtyj</p>	
<b>Burime dhe mjete:</b> dy magnetet shufër, fije, gërshërë		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>Brainstorming:</b> Ju paraqitet nxënësve një magnet shufër dhe drejtohen pyetjet: <i>Çfarë lloj magneti është? Si do të kujdeseni për të? Si mendoni se do të silllet magneti nëse e afrojmë atë me një magnet tjetër?</i>                      Rikujtohet se magnetet kanë pole magnetike, të cilat quhen poli veri dhe poli jug. Ftohen nxënësit të shohin figurat në faqen 90 të librit. Diskutohet rreth rasteve të paraqitura në to  <b>Pohim-mbështetje:</b> Nisur nga figurat dilet së bashku me nxënësit në dy pohime: magnetet me pole të njëjtë shtyhen. Magnetet me pole të kundërta tërhiqen.                      Organizohen nxënësit në dyshe për të kryer provën bazuar në përshkrimin e veprimtarisë: hulumtimi i magnetëve shufër.  <b>Hapi 1:</b> Ndajeni telin përgjysmë. Lidhni nga një copë tel në mes të secilës shufër magnetike. Kapini telat në fund me të dy duart dhe lëshojini poshtë në mënyrë që shufrat të lëkunden.  <b>Hapi 2:</b> Afroni dy magnetet me pole të kundërta/ skajet me dy ngjyra të ndryshme. Çfarë ndodh me magnetet?</p>			

**Hapi 3:** Parashikoni se çfarë do të ndodhë nëse magnetet me të njëjtët pole vendosen përballë njëri tjetrit. Afroni dy magnetet me pole të njëjta/ skajet me të njëjtën ngjyrë. *Çfarë ndodh me ta?*

Udhëzohen nxënësit të përsërisin disa herë provën dhe në të gjitha rastet të mbajë shënim provat dhe rezultatet.

**Diskutim i përfundimeve:** *Çfarë ndodhi kur u vendosën përballë njëri tjetri magnetet me të njëjtin pol? Çfarë ndodhi kur polet e magnetëve ishin të kundërt? A mendoni se këto prova i vërtetojnë pohime që formuluar në fillim?*

**Veprimtari:** Identifikimi i poleve në magnetin në formë patkoi. Kërkohet nga nxënësit që të planifikojnë se si do të përcaktojnë polet e njërit prej magnetëve kur magnetit tjetër ia njohin polet? Nxënësit do të shkruajnë planifikimin dhe parashikimin në fletore. Në dyshe zhvillojnë provën disa herë dhe përcaktojnë përfundimet. Vizatojnë magnetin në formë patkoi dhe shënojnë në skaje polet përkatëse. Shkruajnë përfundimet në fletore dhe i krahasojnë me parashikimet.

**Përfundime:** *Si e realizuat provën tuaj? Si e përcaktuat se cili nga polet është poli veri dhe cili është poli jug?*

Nxënësit duhet të mbajnë mend se polet e njëjta e shtyjnë njëri-tjetrin. Ata do t'i vendosin shufrat magnetike njëra mbi tjetrën.

**Vlerësimi:** vetëvlerësimi i nxënësve ndaj vetes dhe shokut gjatë dhënies së mendimeve dhe pjesëmarrjes në punën me projektin .

**Detyra:** Punimi i faqes 51 të Fletores së

**Refleksion:** Si mendoni, a janë të njëjta polet veri dhe jug të magnetit me polet Veri dhe Jug të Tokës?

*Shënim:* Njoftohen nxënësit të marrin me vete për orën tjetër këto mjete: një pjatë plastike, pak ujë, një tapë, një fletë A4, një shufër magneti, një gjilpërë e madhe, letër ngjitëse, kapëse letrash ose gjilpëra me kokë

## Ora 15

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Polet magnetike		<b>Situata e të nxënësve:</b> Ndërtoni një busull	
Rezultatet e të nxënësve sipas temës: Identifikon polet e një magneti. Vërteton një hipotezë ose parashikim bazuar në njohuritë dhe kuptimin shkencor. Zbulon forcat e pranishme midis magnetëve dhe të dimë se magnetet mund ta shtyjnë ose tërheqin njëri-tjetrin. Bën parashikime dhe t'i komunikojmë ato. Kryen vëzhgimet e nevojshme dhe të bëjmë krahasime. Gjykon mbi nevojën e përsëritjes së matjeve.		Fjalë kyçe: poli veri, poli jug	
<b>Burime dhe mjete:</b> një pjatë plastike, pak ujë, një tapë, një fletë A4, një shufër magneti, një gjilpërë e madhe, letër ngjitëse, kapëse letrash ose gjilpëra me kokë		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**Diskutim për njohuritë paraprake:** Diskutohen rubrikat e faqen 43 të Fletores së punës dhe përfundimet që dalin prej tyre: Polet e një magneti janë poli veri dhe poli jug.

Polet e njëjta shtyjnë njëri tjetrin.

Polet e kundërta shtyjnë njëri tjetrin.

Mësuesja demonstroi vendosjen e magnetëve sipas veprimtarisë 5.8a në ushtrimin. Ju drejtohet pyetja nxënësve: Si ndodh kjo? Ftohen nxënësit të japin mendime. Nëse nxënësit kanë vështirësi ata ndihmohen duke i theksuar faktin se polet e magnetëve që janë të vendosur njëri mbi tjetrin janë pole të njëjtë. Kjo është arsyeja që magnetet shtyjnë njëri tjetrin dhe qëndrojnë në atë formë. Drejtohet pyetja: *A e dini se çfarë është busulla? Përse shërben ajo? Çfarë tregon busulla?*

**Veprimtari:** Prezantohet veprimtaria që do të zhvillojnë nxënësit: Do të ndërtojnë në dyshe një busull në ushtrimin 5.8 b. I tërhiqet vëmendja se duhet të ndjekin udhëzimet. Kërkohet nga nxënësit të parashikojnë se çdo të ndodhë.

**Hapi 1:** Shënoni katër pikat e busullës mbi buzët e fletës A4. Vendoseni fletën mbi një sipërfaqe të sheshtë larg çdo sendi metalik.

**Hapi 2:** Vendosni pjatën me pak ujë në mes të fletës.

**Hapi 3:** Ngjiteni gjilpërën mbi bankë ose tavolinë me anë të një ngjitësi letër.

**Hapi 4:** Goditeni gjilpërën me njërin pol të shufrës magnetike. Ju mund të përdorni si polin e veriut ashtu edhe atë të jugut, por vazhdoni të përdorni të njëjtin pol. Godisni gjithnjë në të njëjtin drejtim dhe sigurohuni që në fund të çdo goditje të shkëputni mirë magnetin nga gjilpëra.

**Hapi 5:** Vazhdohet kështu dhe ndërkohë provohet nëse gjilpëra është magnetizuar ose jo duke u përpjekur të ngrini disa kapëse letrash.

**Hapi 6:** Nguleni gjilpërën në tapë dhe zhyteni bashkë në ujin e pjatës.

**Hapi 7:** Rrotullojeni pjatën derisa ajo të jetë orientuar veri-jug. Ju mund ta gjeni polin e veriut duke ditur se në cilin drejtim lind dhe perëndon dielli. Pra nëse qëndroni me krahët hapur anash dhe krahun e majtë drejtuar nga perëndimi dhe krahun e djathtë nga lindja, fytyra juaj do të jetë nga veriu.

**Hapi 8:** Tani shihni drejtimin që tregon gjilpëra e busullës suaj.

Ekspozimi i busullave dhe orientimit që tregon ajo.

**Vlerësimi:** Vlerësohen për mënyrën si ndjekin udhëzimet, punojnë me kujdes si dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

**Detyra:**

**Refleksion:** A jeni të kënaqur me busullën që ndërtuat? Çfarë do të donit të përmirësonit?

*Shënim:*

## Ora 16

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
<b>Tema mësimore:</b> Fuqia e magneteve		<b>Situata e të nxënimit:</b> Magnetet dhe fuqia e tyre	
<p><b>Rezultatet e të nxënimit sipas temës:</b>            Identifikon polet e një magneti.            Vërteton një hipotezë ose parashikim bazuar në njohuritë dhe kuptimin shkencor.            Zbulon forcat e pranishme midis magneteve dhe të dimë se magnetet mund ta shtyjnë ose tërheqin njëri-tjetrin.            Mbledh prova dhe tregon nëse ato i vërtetojnë ose jo parashikimet tona.            Vërteton një hipotezë ose parashikim duke u bazuar tek njohuritë dhe kuptimi shkencor.            Bën parashikime dhe t'i komunikojmë ato.            Kryen vëzhgimet e nevojshme dhe të bëjmë krahasime.            Gjykon mbi nevojën e përsëritjes së matjeve.</p>		<b>Fjalë kyçe:</b> magnet	
<b>Burime dhe mjete:</b> tri magnetet të ndryshme, kapëse letrë, vizore		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>Diskutim:</b> A kanë të njëjtën forcë magnetike të gjitha magnetet?            Udhëzohen nxënësit se për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje. Ata do të zhvillojnë së bashku disa veprimtari hetimorë. Gjatë këtyre veprimtarive nxënësit do të punojnë dhe me fletët e punës 5.9a dhe 5.9 b.            Veprimtari: Prova e forcës tërheqëse të magneteve. Udhëzohen nxënësit të vendosin polin verior të magnetit nr.1 në njërin skaj të vizores. Ata do ta lëvizin magnetin ngadalë në drejtim të kapëses së letrave dhe ta ndalin atë sapo magneti ta tërheqë dhe ta prekë kapësen e letrave. Nxënësit do të lexojnë distancën e shënuar në mm mbi vizore. Ky është leximi i parë. Tani ata duhet ta përsërisin veprimin për të parë leximin e dytë për polin verior të Magnetit nr.1. Pas kësaj ata do ta përsëritin veprimtarinë për polin jugor të magnetit nr.1. I theksohet nxënësve se është e rëndësishme që t'i përsëritin matjet disa herë për të patur rezultate sa më të sakta. Nxënësit mund të përdorin tabelën në ushtrimin 5.9a për të ruajtur rezultatet e tyre.            Më pas ata mund t'i paraqesin mesataret e rezultateve të tyre për secilin pol të secilit magnet në një grafik me shtylla duke u mbështetur në ushtrimin 5.9a. Mund të lind nevoja që të llogaritet së bashku me nxënësit mesatarja aritmetike e leximeve.            Veprimtari: Testoni fuqinë e magneteve me disa kapëse letrash. Udhëzohen nxënësit se në këtë veprimtari do të zhvillojnë një eksperiment të drejtë për të krahasuar fuqinë e dy magneteve. Për këtë do të ndjekin hapat dhe bëjnë plotësimet në ushtrimin 5.9 b. Me plotësimin e kësaj veprimtarie nxënësit do të diskutojnë me njëri tjetrin përfundimet e tyre.  <b>Përfundime:</b> A ishin të njëjta leximet e vizores për secilin pol të magnetit? A i tërheqin njësoj të dyja polet e magnetit? A kishin të njëjtën forcë tërheqëse të dy magnetet? Si mendoni, a bëjnë të rregullt provën tuaj hapat që ndoqët? Shpjegoni pse. Pse na duhen magnetet me forcë tërheqëse të ndryshme?</p>			

<b>Vlerësimi:</b>	
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 52-53 të Fletores së punës.	<b>Refleksion:</b>
<i>Shënim:</i> Njoftohen nxënësit të marrin me vete për orën tjetër këto mjete: një pjatë plastike, pak ujë, një tapë, një fletë A4, një shufër magneti, një gjilpërë e madhe, letër ngjitëse, kapëse letrash ose gjilpëra me kokë	

## Ora 17

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Fuqia e magneteve		<b>Situata e të nxënët:</b> Magnetet dhe fuqia e tyre	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b> Identifikon polet e një magneti. Vërteton një hipotezë ose parashikim bazuar në njohuritë dhe kuptimin shkencor. Mbledh prova dhe tregon nëse ato i vërtetojnë ose jo parashikimet tona. Vërteton një hipotezë ose parashikim duke u bazuar tek njohuritë dhe kuptimi shkencor. Bën parashikime dhe t'i komunikojmë ato. Kryen vëzhgimet e nevojshme dhe të bëjmë krahasime. Gjykon mbi nevojën e përsëritjes së matjeve.		<b>Fjalë kyçe:</b> magnet	
<b>Burime dhe mjete:</b> tre magnetet të ndryshme, kapëse letrë, vizore		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Diskutim:</b> A kanë të njëjtën forcë magnetike të gjitha magnetet? Udhëzohen nxënësit se për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje do të zhvillojnë së bashku disa veprimtari hetimore. Gjatë këtyre veprimtarive nxënësit do të punojnë dhe me ushtrimin 5.9a dhe 5.9 b. <b>Veprimtari:</b> Prova e forcës tërheqëse të magneteve. Udhëzohen nxënësit të vendosin polin verior të magnetit nr.1 në njërin skaj të vizores. Ata do ta lëvizin magnetin ngadalë në drejtim të kapëses së letrave dhe ta ndalin atë sapo magneti ta tërheqë dhe ta prekë kapësen e letrave. Nxënësit do të lexojnë distancën e shënuar në mm mbi vizore. Ky është leximi i parë. Tani ata duhet ta përsërisin veprimin për të parë leximin e dytë për polin verior të Magnetit nr.1. Pas kësaj ata do ta përsërisin veprimtarinë për polin jugor të magnetit nr.1. Ju theksohet nxënësve se është e rëndësishme që t'i përsëritni matjet disa herë për të patur rezultate sa më të sakta. Nxënësit mund të përdorin tabelën në ushtrimin 5.9a për të ruajtur rezultatet e tyre. Më pas ata mund t'i paraqesin mesataret e rezultateve të tyre për secilin pol të secilit magnet në një grafik me shtylla duke u mbështetur në ushtrimin 5.9a. Mund të lind nevoja që të llogaritet së bashku me nxënësit mesatarja aritmetike e leximeve. <b>Veprimtari:</b> Testoni fuqinë e magneteve me disa kapëse letrash. Udhëzohen nxënësit se në këtë veprimtari dom të zhvillojnë një eksperiment të drejtë për të krahasuar fuqinë e dy magneteve. Për këtë do të ndjekin hapat dhe bëjnë plotësimet në ushtrimin 5.9 b. Me plotësimin e kësaj veprimtarie nxënësit do të diskutojnë me njëri tjetrin përfundimet e tyre.			



<i>Përfundime: A ishin të njëjta leximet e vizores për secilin pol të magnetit? A i tërheqin njësoj të dyja polet e magnetit? A kishin të njëjtën forcë tërheqëse të dy magnetet? Si mendoni, a bëjnë të rregullt provën tuaj hapat që ndoqët? Shpjegoni pse. Pse na duhen magnetet me forcë tërheqëse të ndryshme?</i>	
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mënyrën si ndjekin udhëzimet, punojnë me kujdes si dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.	
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 52-53 të Fletore Pune	<b>Refleksion:</b>
<i>Shënim:</i>	

## Ora 18

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa</b> 4	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Cilat metale janë magnetike?		<b>Situata e të nxënit:</b> A janë magnetike të gjitha metalet?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Identifikon polet e një magneti. Vërteton një hipotezë ose parashikim bazuar në njohuritë dhe kuptimin shkencor. Mbledh prova dhe tregon nëse ato i vërtetojnë ose jo parashikimet tona. Vërteton një hipotezë ose parashikim duke u bazuar tek njohuritë dhe kuptimi shkencor. Bën parashikime dhe t'i komunikojmë ato. Kryen vëzhgimet e nevojshme dhe të bëjmë krahasime. Gjykon mbi nevojën e përsëritjes së matjeve.		<b>Fjalë kyçe:</b> argjend, çelik, aliazh	
<b>Burime dhe mjete:</b> magnet, objekte prej metalesh të ndryshme		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Nxënësve ju paraqiten materiale të ndryshme prej metali të ndryshme si fleta alumini, tel bakri, unazë floriri, një aksesor argjendi etj.. Emërtohet lloji i metalit me të cilin janë të përbëra. Tregohet një pirun dhe sqarohen nxënësit se është prej materialit të çelikut. Çeliku është një përzierje e hekurit me sasi më të vogla metalesh të tjera si manganezi ose kromi. Ftohen nxënësit të shohin figurat në fq. 94 në libër. Lexim rishikim në dyshe: Nxënësit lexojnë dhe diskutojnë me njëri tjetrin informacionin që jepet në paragrafë. Veprimtari: A janë magnetike të gjitha metalet? Për secilin material që do të marrin në provë nxënësit bëjnë parashikime, më pas provohen nëse janë ose jo magnetik. Të dhënat do t'i shënojnë në një tabelë. Përmbledhje: Përmendni dy metale magnetike. Përmendni dy metale jomagnetike. Jepni tre shembuj objektesh metalike që përdorni në shtëpi. Nga çfarë metalesh përbëhen ato? Janë magnetike apo jomagnetike? Si i veçon magneti hekurin dhe çelikon?			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për mendimet që japin gjatë diskutimeve.			
<b>Detyra:</b> Punimi i faqes 54 të Fletore së punës		<b>Refleksion:</b>	
<i>Shënim:</i>			

## Ora 19

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj (ora 1)		Situata e të nxënit: Unë di...	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara. Prezanton me forma të ndryshme njohuritë e marra dhe aftësitë e qëndrimet e fituara.		<b>Fjalë kyçe:</b> rrymë elektrike, qark elektrik, magnete, poli pozitiv, poli negativ	
<b>Burime dhe mjete:</b> enciklopedi, tabak letre, lapsa, ngjyra		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Art	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Diskutim:</b> Diskutohen së bashku përcaktimet e bëra për detyrë në Fletoren e punës, nëse materialet e treguara janë magnetike ose jo magnetike. <b>Punë e pavarur:</b> Ftohen nxënësit të punojnë individualisht. Pas plotësimit do t'i diskutojnë përfundimet në grup. Tërhiqet vëmendja që gjatë diskutimit në grup mund të gjejnë material plus për prezantimin e tyre. Përfundimi i punës në grupe për projektin. <b>Lojë:</b> Luhet me një top të vogël plastik. Ai që ka topin në dorë drejton një pyetje dhe më pas ia hedh një shoku. Ai që pret topin do të përgjigjet.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përfundimet e nxjerra në ushtrimet e librit. Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve duke përdorur fjalorin e përshtatshëm. Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre.			
<b>Detyra:</b>		Refleksion: Mendo dy gjëra që të pëlqyen nga puna e kryer gjatë këtyre temave dhe diçka që mendon se mund ta bëje më mirë.	
<i>Shënim:</i>			

## Ora 20

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 4	Data
Tema mësimore: Kontrolloni përparimin tuaj (ora 2)		Situata e të nxënit: Unë di...	
Detyrë përmbledhëse / Test			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara.		<b>Fjalë kyçe:</b> rrymë elektrike, qark elektrik, magnete, poli pozitiv, poli negativ	
<b>Burime dhe mjete:</b> enciklopedi, fleta e detyrës përmbledhëse, lapsa, ngjyra		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhët (Gjuhë Shqipe), Matematikë, Art	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <b>Prezantohet</b> detyra e ditës. Udhëzohen nxënësit në punën që do të kryejnë. <b>Punë e pavarur:</b> Plotësimi i detyrave përmbledhëse. <b>Bisedë</b> rreth mbresave pozitive gjatë këtyre temave mësimore. Përfundime dhe reflektive.			
<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për punimin e detyrës përmbledhëse / Testit.			
<b>Detyra:</b>			<b>Refleksion:</b>

*Shënim:* Kjo orë mund të shfrytëzohet si testim ose si detyrë përmbledhëse e periudhës së tretë.  
Fundi i kësaj ore mësimi mund të përdoret në varësi të kohës dhe prezantimeve të mbetura.

## **Periudha e tretë**

### **Njohuritë/konceptet**

#### **Qarku elektrik**

- Elementët përbërës të qarkut të thjeshtë elektrik
- Qarqet me shumë element
- Elektriciteti dhe përdorimet e tij
- Polet magnetike të një magneti
- Vetitë magnetike të metaleve

#### ***Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës :***

- Shpjegon se elektriciteti rrjedh në qarqet elektrikë.
- Shpjegon se elektriciteti prodhohet nga pila/burimi ose bateritë.
- Identifikon pajisjet e thjeshta elektrike që punojnë me elektricitet
- Përshkruan elementët përbërës të një qarku të thjeshtë elektrik dhe rolin e secilit prej tyre.
- Shpjegon se llamba ndriçon ose jo, kur hapim apo mbyllim çelësin.
- Shpjegon se një pajisje elektrike nuk punon në qoftë se ka shkëputje në qark.
- Shpjegon se llambat dhe zilet e lidhura në qark punojnë brenda një vlere të përcaktuar rryme.
- Tregon se burimi duhet të ketë një tension të mjaftueshëm që të gjitha elementët e qarkut të punojnë.
- Krahason qarkun e thjeshtë elektrik me qarkun më shumë elementë.
- Ndërton skemën e një qarku të thjeshtë elektrik në seri.
- Ndërton skemën e një qarku me zile elektrike.
- Dallon përcjellësit nga jopërcjellësit.
- Vlerëson rëndësinë e përdorimit të elektricitetit në jetën e përditshme.
- Tregon si zbatohen rregullat e sigurisë gjatë punës me pajisjet elektrike për t'u mbrojtur nga rreziqet e mundshme.
- Punon në grup për krijimin e një posteri që përmban rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitet dhe e prezanton atë.
- Punon në grup projektin me temë: “Pajisjet elektrike në shtëpitë tona dhe përdorimi i tyre”.
- Kupton se si funksionojnë busullat.
- Di shkakun e magnetizimit
- Identifikon polet e një magneti.
- Njeh fushën magnetike të Tokës.

**Periudha e tretë**


Emri \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

Klasa \_\_\_\_\_

**1. Vizato një qark të mbyllur me 4 elementë. Emërtoji elementet. 9 ( pikë)**

**2. Trego nëse sinjalizuesi do të punojë apo jo. Trego arsyen. 6 ( pikë)**



Qarku A

---

---

---

Qarku B

---

---

---

Qarku C

---

---

---

**3. Plotëso duke përdorur fjalët.**



7 ( pikë)

bateri i mbyllur rryma negative veri pozitiv jug

\_\_\_\_\_ rrjedh në një qark elektrik. Rryma rrjedh nga poli \_\_\_\_\_ në polin \_\_\_\_\_ . Disa pila të lidhura së bashku në një qark formojnë \_\_\_\_\_ . Në qark pa shkëputje quhet qark \_\_\_\_\_ . Polet e magnetit janë poli \_\_\_\_\_ dhe poli \_\_\_\_\_ .

**4. Trego se si do të lëvizin magnetet në secilin prej rasteve.**

4 ( pikë)

**5. Jep mendimin tënd:.**

4 ( pikë)

Përse duhet të mbrohemi nga elektriciteti i rrjetit? Shkruaj dy rregulla sigurie.

---



---



---



---



---

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8- 11	12-15	16 -19	20- 23	24- 27	28- 30

**Suksese!**

